



Programi studimor: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi – Magjistraturë

Tema:

“ORIENTALIZMAT NË LEKSIKUN E GJUHËS SHQIPE TE
LETËRSIA E BEJTEXHINJVE”

Studenti: Ziber Lata

Mentori: Prof. dr. Zeqir Kadriu

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
PARATHËNIE	4
HYRJE	5
1. PËRKUFIZIMI I TERMIT “ORIENTALIZËM”	7
1.1. VËSHTRIM ETIMOLOGJIK DHE ANALITIK FJALËS “ORIENTALIZËM”	7
1.2. PËRKUFIZIMI TERMINOLOGJIK I FJALËS “ORIENTALIZËM” NË LEKSIKUN E SHQIPES	8
2. DALLIMI I SHPREHJES <i>ORIENTALIZËM</i> NGA <i>TURQIZËM</i> , <i>ARABIZËM</i> DHE <i>PERSIZËM</i> NË FUSHËN E GJUHËSISË	9
2.1. PËRKUFIZIMI I NOCIONEVE QË PËRFSHIJNË ORIENTALIZMAT	9
2.2. PENGESAT E MOSNJOHJES SË THUKËT TË NOCIONEVE TË LARTPËRMENDURA.....	10
2.3. ÇKA NDIHMON NË QARTËSIMIN E TYRE?	12
3. GLOBALIZMI DHE GJUHËT	15
3.1. DEPËRTIMI I NGADALSHËM I HUAZIMEVE NË GJUHËN SHQIPE NË TË KALUARËN DHE PËRVETËSIMI I TYRE SOT.....	15
3.2. GLOBALIZMI, ARMIK I GJUHËVE.....	16
4. DUKURIA E MARRJES DHE E DHËNIES SË SHQIPES ME GJUHËT TJERA.....	19
4.1. GJUHA SHQIPE NË ROLIN DHËNËS - ALBANIZMAT.....	22
4.2. GJUHA SHQIPE NË ROLIN MARRËS - HUAZIMET	24
5. QËNDRIMET NDAJ HUAZIMEVE, ME THEKS TË VEÇANTË NDAJ ORIENTALIZMAVE	29
5.1. QËNDRIMET E SHKRIMTARËVE DHE FILOLOGËVE GJATË PERIUDHAVE LETRARE	30
5.2. PASTRIMI I TËRËSISHËM, SHKATËRRIM I GJUHËS	34
6. ORIENTALIZMAT DHE SHTRIRJA E TYRE NË SFERAT E GJUHËSISË.....	39
6.1. ELEMENTI ORIENTAL NË SISTEMIN GRAMATIKOR TË SHQIPES	39
6.2. ELEMENTI ORIENTAL NË LEKSIKUN E SHQIPES	40
6.3. CILA PJESË E LIGJËRATËS U PREK MË SHUMË?!	42
6.3. NJË PASQYRË E ORIENTALIZMAVE NËPËR FJALORË	43
7. ETAPAT NËPËR TË CILAT DEPËRTUAN ORIENTALIZMAT NË GJUHËN SHQIPE... 47	

7.1. PERIUDHA PARAOSMANE	47
7.2. PERIUDHA NËN PERANDORINË OSMANE	50
7.3. PERIUDHA PAS PERANDORISË OSMANE	52
8. FUSHAT E SHTRIRJES SË ORIENTALIZMAVE	59
8.1. ORIENTALIZMAT NË FUSHAT NJERËZORE	59
8.2. ORIENTALIZMAT NË ONOMASTIKËN SHQIPTARE	60
8.3. ISLAMIZMAT NË GJUHËN SHQIPE	62
9. RRUGËT DHE FAKTORËT QË MUNDËSUAN DEPËRTIMIN E ORIENTALIZMAVE NË LEKSIKUN E GJUHËS SHQIPE	64
9.1. RRUGËT E DEPËRTIMIT TË ORIENTALIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE	64
9.1.1. <i>Huazimet dyrrugëshe</i>	66
9.2. FAKTORËT DHE SHKAQET QË U HAPËN RRUGËN ORIENTALIZMAVE	67
9.2.1. <i>Tregtia, zanafillë e huazimeve orientale</i>	67
9.2.2. <i>Rënia e Shqipërisë nën qeverisjen osmane</i>	68
9.2.3. <i>Feja; islamizimi i shqiptarëve</i>	69
9.2.4. <i>Përdorimi i osmanishtes si gjuhë zyrtare</i>	70
9.2.5. <i>Shkollimi i shqiptarëve në Stamboll dhe Anadulli</i>	70
9.2.6. <i>Mungesa e alfabetit të gjuhës shqipe apo përdorimi i alfabetit osman</i>	71
10. MËNJANIMI I ORIENTALIZMAVE NGA GJUHA SHQIPE	73
10.1. SHKAQET QË SOLLËN NË REDUKTIMIN E ORIENTALIZMAVE	73
11. KUSH JANË BEJTEXHINJTË?	76
11.1. ZBËRTHIMI I FJALËS <i>BEJTEXHI</i> DHE I SIMOTRAVE TË SAJ	76
11.2. SHKRIMET E PARA DHE TË FUNDIT ME ALFABET ARAB	78
11.3. BEJTEXHINJTË SHKRUAN ME GRAFI ARABE PSE E DESHËN GJUHËN SHQIPE	80
12. LETËRSIA E BEJTEXHINJVE, DJEP I ORIENTALIZMAVE	82
12.1. PASQYRIMI I ORIENTALIZMAVE NË LETËRSINË E BEJTEXHINJVE	83
PËRFUNDIM	86
LITERATURA	89

PARATHËNIE

Orientalizmat në leksikun e gjuhës shqipe janë mjaft të pranishëm. Çdo shqipfolës e ka të pashmangshme përdorimin e orientalizmeve gjatë të folurit, të shkruarit, ligjërit, komunikimit etj. Megjithatë, shumica e njerëzve nuk mund t'i kuptojnë e nuk mund t'i dallojnë ato.

Edhe punimet paraprake që janë bërë në këtë fushë janë në numër shumë të vogël, madje edhe ajo që është lëvruar në këtë lëmi është bërë në përgjithësi dhe, vende-vende, me një sy jo të drejtë.

Pikërisht kjo më ngjalli kërkimin që t'i qasem një punimi të këtillë shkencor, duke studiuar orientalizmat në leksikun e gjuhës shqipe, në mënyrë të veçantë edhe në letërsinë e bejtexhinjve. Fillimisht kam nisur me tema të përgjithshme, por të rëndësishme, për studimin që do të jap në vazhdim. Këtu më shumë kam bërë një studim gjuhësor-analitik sesa një renditje në formë fjalori të orientalizmeve.

Gjatë këtij punimi kam përdorur metoda të njohura gjuhësore, me theks të veçantë metodën strukturore-dialektore, e cila më ka ndihmuar që t'i nxjerr disa fjalë dhe të bëj renditjen e temave të punuara. Gjithashtu, ndihmë të madhe më ka dhënë edhe metoda historike, sepse vetëm kur mësohen faktorët historikë mund të kuptohen shumë fshehtësi etimologjike të fjalëve të një gjuhe.

Një përkrahje të paparë më ka dhënë fjalori madhështor i kësaj fushe, "Fjalori i orientalizmeve" i Tahir Dizdarit.

Vërtet është vështirë të punosh një temë të tillë, sepse unë personalisht hasa në disa probleme, zgjidhja e të cilave kërkonte që të konsultoheshin edhe shumë libra të fushave të tjera, në veçanti të historisë dhe të leksikografisë, bile në shumë gjuhë të botës.

Gjatë punimit më është dashur të shfrytëzohet literaturë nga gjuha shqipe, maqedonase, serbe, kroate, angleze, turke, arabe etj.

Gjithashtu, shfrytëzohet rastin të falënderoj të gjithë ata që më ndihmuan në realizimin e këtij punimi: profesorin e lëndës (mentorin), i cili më përkrahu për ta punuar këtë temë, dhe të gjithë ata që më dhanë ndihmë me literaturë nga etimologjia gjuhësore dhe leksikologjia .

HYRJE

Në këtë punim më shumë jam ndalur në pjesën historike-analitike të orientalizmave në gjuhën shqipe. Këtu jam munduar që në mënyrë të barabartë të shfaq realitetin dhe pozitën që kanë pasur dhe që vazhdojnë të kenë ato në gjuhën shqipe.

Së pari, kam filluar me përkufizimet e termave: arabizëm, orientalizëm, persizëm dhe turqizëm, duke bërë edhe dallimin që ato kanë mes vete, në mënyrë që të mos keqkuptohen, sepse ka shumë njerëz që nuk mund t'i dallojnë, ose, thjesht, i ngatërrojnë. Duhet kuptuar se orientalizmat nuk njihen pa u mësuar gjuhët nga ku janë huazuar ato .

Pastaj, i jam qasur problemit të marrëdhënieve të gjuhëve. Asnjë gjuhë nuk mund të jetojë e pavarur nga simotrat e saj, por patjetër të marrë ose të japë diçka. Fund i fundit, ky është edhe sistemi jetësor - çdo gjë të ketë nevojë për tjetrën. Kam sqaruar dukurinë e marrëdhënies së shqipes me gjuhët orientale, me arabishten, persishten dhe me turqishten. Çka ndihmoi që ato të kenë dhënie dhe marrje mes vete? Si nisi kjo lidhje? Cilat ishin rrugët më të rëndësishme? etj.

Këtu kam potencuar dukurinë “globalizëm”, të mirat dhe të këqijat që u solli ajo gjuhëve. Gjithashtu, kam treguar se çka iu bëri globalizmi huazimeve orientale. Nuk është lënë pa punuar dhe këndi i raportit të gjuhës shqipe me gjuhët tjera orientale, si: hebraishtja, urdishtja, abramishtja etj.

Në vazhdim janë përpunuar fazat e depërtimit të orientalizmave në gjuhën shqipe. Cilët ishin faktorët e depërtimit të tyre, duke shpjeguar secilin një nga një. Pastaj u jam qasur fazave që ndoqën orientalizmat për të ardhur në gjuhën shqipe. Pra, faza para ardhjes së osmanlinjve, gjatë qeverisjes osmane dhe pas tyre. Për të tri fazat e depërtimit të tyre në gjuhën shqipe kam sjellë fakte shkencore dhe të vërteta historike. Në formë të detajuar janë punuar edhe faktet gjuhësore që i vërtetojnë këto tri faza, pa qenë i njëanshëm.

Gjithashtu, kam theksuar shtytësit që ndihmuan depërtimin e termave dhe shprehjeve orientale në mesin tonë: duke nisur prej faktorit tregtar, islamizimit të shqiptarëve, rënies së Shqipërisë nën qeverisjen osmane, mosekzistimit të alfabetit shqip, shkollimit të shqiptarëve në botën islame etj.

Gjatë shtjellimit në fjalë është bërë një studim edhe për qëndrimet e gjuhëtarëve dhe shkencëtarëve shqiptarë në periudhat e ndryshme historike dhe letrare.

Është trajtuar edhe ajo që në gjuhësi njihet si purizëm gjuhësor, pra tendenca për pastrimin e tërësishtëm të gjuhës shqipe nga fjalët orientale, sepse kishte, dhe ka, prej atyre që kanë qëndrime të këtilla. Pastaj është treguar dëmi që i vihet shqipes nëse pastrohet tërësisht prej huazimeve orientale.

Nuk është lënë pasdore edhe thirrja që fjalët orientale që kanë përgjegjëset e tyre në shqip të largohen dhe të merren ato të gurrës shqipe, kuptohet pa e dëmtuar shqipen dhe duke treguar se çka dëmton e çka jo (mos)ekzistenca e tyre.

Gjithashtu, jam munduar që t'i përmend shkaqet që ndihmuan në largimin e arabizmave. Siç janë: dobësimi i Perandorisë Osmane, lëvizja rilindëse, themelimi i alfabetit shqip, depërtimi i komunizmit në Shqipëri, dhënia përparësi toskërishtes në Kongresin e Drejtshkrimit, huazimet perëndimore etj.

Në pjesën e dytë të këtij punimi është lëvruar fusha më e mbjellë me farë orientale, letërsia e bejtexhinjve. Këtu janë trajtuar shkrimet e para shqipe me grafi arabe dhe autorët e tyre. Po ashtu, janë shtjelluar edhe punimet e fundit me grafi arabe në trojet shqiptare.

Pika më e rëndësishme që është hulumtuar në këtë lëmë është llogaritja e pranisë së orientalizmeve në gjuhën shqipe: Sa ato ishin në fillim të kësaj faze? Sa ishin në mes të letërsisë së bejtexhinjve? Dhe sa në fund të jetës së saj?

Gjithashtu, saktësisht janë treguar edhe përqindjet e orientalizmeve në leksikun e autorëve bejtexhinj. Cila ishte poezia më e pasur me orientalizma dhe cila më e varfër? Cili autor ishte për to dhe cili kundër?

Pra, këto ishin elementet themelore që janë shtjelluar në këtë hulumtim.

1. PËRKUFIZIMI I TERMIT “ORIENTALIZËM”

1.1. Vështrim etimologjik dhe analitik fjalës “orientalizëm”

Termi *orient* rrjedh nga shprehja latine *orientem*, d.m.th. “lindje”.¹ Nuk është fjalë njëkuptimore, por varësisht nga fusha ku përdoret merr dhe kuptimin . Kjo shprehje në gjuhën shqipe bën pjesë në fjalët polisemantike (shumëkuptimëshe). Për të mësuar kuptimin e duhur të këtij termi duhet të shikojmë shtrirjen e tij semantike në disa fusha:

- Në tradita dhe zakone, shprehja “orientalizëm” ndonjëherë përdoret për disa tradita dhe zakone që i kemi huazuar nga bota lindore, përkatësisht nga Lindja e Mesme, të cilat kanë qenë, ose janë, të pranishme edhe në mesin tonë.

- Në politikë, kuptojmë drejtimin politik me frymë orientale ose politikanin që përpiqet të veprojë me vizione lindore, përkatësisht aziatike. Politika që është zhvilluar në kohën kur Shqipëria ka qenë nën qeverisjen osmane emërtohet si “politikë me frymë orientale”, ngase është punuar sipas direktivave të Portës së Lartë (Sulltanit). Një politikë me frymë orientale shqiptarët ndoqën, afërsisht, pesëqind vjet, mirëpo gjatë gjithë qeverisjes osmane, veçanërisht kah fundi, kishte edhe të atillë që ndiqnin Oksidentin. Synim i periudhës së Rilindjes Kombëtare ishte Perëndimi, madje edhe ata që jetonin në vendet orientale (në Stamboll e gjatë) sytë i kishin kah Oksidenti. P.sh. Sami Frashëri në veprën e tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë” thotë: *“Jo, kemi edhe miq, jan’ edhe shumë që na duanë edhe mund të na ndihinë, po të duamë vetë. Gjithë kombet’ e Evropësë, francezëtë, itajlanëtë, alemanëtë, ingjilizëtë e të tjerë, gjithë e duan e e nderojnë kombinë tënë.”*

- Në fe, përdorimi i shprehjes orientalizëm apo të ngjashme me të për mësimet, ritet dhe praktikën fetare islame është një veprim i gabuar, sepse Islami nuk është i Lindjes, por i çdokujt që e beson dhe e praktikon atë. Madje, shpeshherë bëhen gabime, duke u munduar që mësimet dhe ritet fetare të etiketohen si “vizione orientale”, “ide arabe”, “edukatë aziatike”, “mentalitet anadollak” etj.

Ndodh edhe e kundërta e kësaj që thamë. Fatkeqësisht, dikush, me apo pa vetëdije, përpiqet që kulturën orientale ta paraqet si pjesë të fesë islame. Kështu që, për të pasur një

¹ John Ayto, *Word origins* (London, A&C Black, 2005), f. 360.

botëkuptim më të drejtë dhe për të dalluar atë që është orientale nga ajo fetare-islame, duhet të njihet kultura, tradita, zakoni dhe forma e jetesës orientale dhe parimet e mësimet fetare-islame.

- Në muzikë, kuptojmë muzikën me ngjyime orientale, e cila zakonisht cilësohet me vegla muzikore të veçanta, si p.sh. *neji* (lloj fyelli i gjatë aziatik), *sharkia* etj. Thuhet: “kam dëgjuar muzikë orientale”, “më pëlqen melodia orientale”, “muzika orientale është më frymëzuese për shpirtat” etj.

Nga sqarimet e mësipërme përfundojmë se shprehja “orientalizëm” në vete ngërthen: “çdo element lindor-aziatik që është, apo ka qenë, i pranishëm në mesin tonë!”

1.2. Përkufizimi terminologjik i fjalës “orientalizëm” në leksikun e shqipes

Në shtjellimin e mëparshëm kuptuam domethënien e përgjithshme gjuhësore dhe përdorimin e fjalës “orientalizëm”. Tani do të ndalemi në përkufizimin terminologjik që ka kjo shprehje në leksikologjinë e gjuhës shqipe.

“Fjalët apo shprehjet orientale, të cilat përdoren, apo janë përdorur në një periudhë kohore të caktuar në një gjuhë (pa marrë parasysh, në gjuhën e shkruar apo në të folmet e krahinave të ndryshme), i quajmë *orientalizma*.”

Në vazhdim do të përmendim një numër orientalizmash, p.sh.: *sahat, sahan, tenxhere, dyqan, hasret, sevap, gjynah, çorap, jemek, jeshil, mavi, algjebër, hambar, inat, alkool, hendek, serrat, derdimen, batall, hallkë, hall, dynja, daulle, malukat, mall, minare, çallëm, çallëk, sharki, tamërr, tek, çift, vakëf, vaki, xhenet* etj.

2. DALLIMI I SHPREHJES *ORIENTALIZËM* NGA *TURQIZËM*, *ARABIZËM* DHE *PERSIZËM* NË FUSHËN E GJUHËSISË

2.1. Përkufizimi i nocioneve që përfshijnë orientalizmat

Lëvruesit në disiplinën e leksikologjisë gjatë studimit të huazimeve orientale dhe shfletuesit e këtij punimi duan të kenë një pasqyrë më të pastër për shprehjet *orientalizëm*, *turqizëm*, *persizëm* dhe *arabizëm*. Sigurisht, që mes këtyre ka dallime shumë të theksuara dhe të vlefshme.

Meqë studimi i orientalizmave dita-ditës zhvillohet, për hir të saktësisë shkencore dhe të rëndësisë së lëvrimin në fushën e gjuhësisë do të bëjmë dallimin më të thukët mes këtyre nocioneve, të cilat në vete mbajnë fjalët e burimit oriental. Në vazhdim do t'i shtjellojmë këta tre terma: arabizëm, turqizëm dhe persizëm.

- *Arabizëm* do të thotë: “Fjalë a shprehje arabe, që ka hyrë në gjuhën tonë ose në një gjuhë tjetër”. P.sh.:

marifet “vajzë me marifet”;

mana “ç’është manaja e kësaj pune”;

mahsher “dita e mahsherit është afër”;

qitap “mos u ul mbi qitap”;

kalem “atë s’e zë kalemi”;

firar “plagosi një njeri e duel firar”;

sahan “nuk i del një sahan me groshë”;

xhevahir, *xherrah*, *mutlak*, *fëstëk* etj.

- *Turqizëm* quajmë: “Fjalën a shprehjen turke që ka hyrë në gjuhën tonë ose në një gjuhë tjetër”.² P.sh.:
anadollak “se ç’asht një anadollak ai!”, “kjo që bën ti është sjellje anadollake”;
hoshgjeldën “hoshgjeldën kur të dush!”, “hoshgjeldën, o burrë”;
kandigjibek “u ngopën me kandigjibek”, “kandigjibeku i nanës plakë asht ma i mirë”;
kapak “i vunë kapakun”, “vetëm kapaku e di se ç’ka tenxherja brenda”;
leblebi “hëngrën shumë leblebi”, “plaku s’i ha leblebitë” etj;
- *Persizëm* quajmë: “Fjalën a shprehjen perse që ka hyrë në gjuhën tonë ose në një gjuhë tjetër.” Por, për persizmat kushtëzohet që të mos jetë fjalë që i përket gjuhëve indoevropiane, sepse atëherë bëhet fjalë për elemente të përbashkëta të dy gjuhëve të një familjeje gjuhësore e jo për huazime. Në vijim do të japim disa shembuj për persizmat. P.sh.:
çare “s’ia gjen dot çaren kësaj pune”, “s’ka çare, duhet ta bësh!”;
çengel “anija hodhi çengelat në liman”;
derdimen “se ç’është një derdimen ky djalë” etj.³

2.2. Pengesat e mosnjohjes së thukët të nocioneve të lartpërmendura

Nga përkufizimet e mëparshme kuptohet se dallimi mes këtyre shprehjeve është i dukshëm, edhe pse në mesin tonë shpeshherë bëhen gabime në përdorimin e tyre, madje edhe prej profesionistëve dhe letrarëve.

Nga shprehjet e lartpërmendura, fjalori i gjuhës shqipe për huazimet orientale njih vetëm termin “turqizëm” apo “turqizma”. Ndoshta kjo është edhe arsyeja që në punimet gjuhësore ka zënë vend ky term.

Arsye tjetër për mospërdorimin e nocioneve të tjera është edhe mosnjohja e gjuhëve orientale nga studiuesit e leksikut të shqipes, pra pamundësia e dallimit të njërës nga

² Androkli Kostallari dhe të tjerë, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1980), f. 2043.

³ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe* (Tiranë, AICT, 2005).

tjetra. Edhe atyre pak lëvruesve që ishin të thirrur për këtë punë nuk u ishin mundësuar kushte të përshtatshme për studim, sepse ishin vështruar si figura orientale-fetare dhe kinse kanë paraqitur rrezik për ish-sistemin. P.sh. studiuesi më i dalluar në fushën e orientalizmave, Tahir Dizdari, gjithë punën e tij për përpilimin e Fjalorit e bëri vetë dhe jo në kuadrin e ndonjë institucioni shkencor. Madje, vepra e tij “Orientalizmat në gjuhën shqipe” mbeti dorëshkrim deri në rënien e ish-sistemit komunist, sepse ai shpeshherë citonte thënie të rilindësve shqiptarë, të cilët për atë kohë ishin të ndaluar, si p.sh. Gjergj Fishta, dhe e luftonte idenë ateiste, gjë që shihet në sqarimin e terminologjisë islame.

Më të përdorura, a më të njohura në mesin tonë janë shprehjet *orientalizëm* dhe *turqizëm*, kurse për *arabizëm* dhe *persizëm* shumë pak është dëgjuar. Madje, edhe nëse është shkruar diçka, është trajtuar nën shkrimet apo trajtesat e orientalizmave. Pra, deri kur pa dritën fjalori madhështor i orientalizmave i Tahir Dizdarit, shprehjet arabizëm dhe persizëm kanë qenë nën hije. Është shënuar nëpër studimet e leksikologëve se shqipja ka huazuar nga arabishtja, persishtja dhe osmanishtja, por jo të bëhet ndonjë studim serioz për të dalluar njëren prej tjetrës.

Faktin se leksikologët e gjuhës shqipe shumë pak kanë bërë dallimin e huazimeve orientale, duke i futur ato të gjitha në një thes, të quajtura si *turqizma*, e pranon edhe studiuesi i njohur i gjuhës shqipe Shaban Demiraj dhe thotë: “Para se të ndalem në disa dukuri paralele të lashta midis shqipes dhe iranishtes, dëshiroj të theksoj se studimi i persishtes, e cila bën pjesë në grupin e gjuhëve iraniane, paraqet një interes të veçantë edhe për të kuptuar më mirë burimin e mirëfilltë të një numri të konsiderueshëm të fjalëve shqipe, që mbahen si huazime nga turqishtja, por që në të vërtetë janë fjalë persishte, të cilat kanë hyrë në shqipe nëpërmjet turqishtes. Të tilla janë, ndër të tjera: *aferim, aheng, araba, barabar, baxha, behar* etj.”⁴

E njëjta situatë është edhe me arabizmat. Kanë hyrë përmes turqishtes, të cilat ne i njohim si turqizma, por në të vërtetë ato janë arabizma, p.sh. *qitap, kalem, hasret, gaflet, gajret, hizmet, dynja, hair, sherr, synet, xhami, muftak, minder, dyqan, ahur, sevda, myhir* etj. Këtë gabim e bëjnë ata që nga gjuhët orientale njohin vetëm turqishten, sepse vërtet

⁴ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe – probleme dhe disa figura të shquara të saj* (Tiranë, Globus R, 2003), f. 120-121.

këto fjalë i gjen në fjalorët e gjuhës turke, mirëpo ata harrojnë se këto edhe në gjuhën turke janë fjalë të huazuara nga gjuha arabe.

2.3. Çka ndihmon në qartësimin e tyre?

Për të dalluar secilin prej përkufizimeve të lartpërmendura, në nismë, duhet përvetësuar shkathtësitë e gjuhës shqipe, njohjen e leksikut të gjuhës amë, sepse nuk ka rezultat të suksesshëm kur studiuesi që merret me etimologjinë e fjalëve është i huaj me gjuhën shqipe dhe nuk ka jetuar në mesin e shqiptarëve. Kjo na qartësohet edhe më shumë kur i shohim disa kundërshtime që Eqrem Çabej ia bën Gustav Mayerit, ku duket qartë se janë gabime si rezultat i mosnjohjes dhe mosmishërimit të tij me shqiptarët.

Kjo që thamë vlen për etimologët në përgjithësi, kurse për ata që do të përcaktohen për gjetjen e fjalëve me burim oriental do t'u duhet t'i kenë parasysh edhe këto dy porosi:

- Sajimi secili për vete i këtyre orientalizmeve të këto gjuhë, sepse arabishtja, turqishtja dhe persishtja nuk janë gjuhë të një familjeje. "...turqishtja si një gjuhë e familjes ural-altaike, ndryshon shumë nga arabishtja (si gjuhë e familjes semite) dhe nga persishtja (si gjuhë e familjes indoevropiane), si për nga sistemi fonetik, ashtu dhe për nga struktura gramatikore."⁵ Pra, vetë fakti se gjuhët orientale, nga ku ka huazuar gjuha shqipe, nuk janë të një familje, tregon se kemi të bëjmë me sisteme të ndryshme gjuhësh dhe me struktura gramatikore-fonetike të largëta njëra prej tjetrës.
- Gjithashtu, për një qasje serioze në fushën e orientalizmeve, përveç njohjes burimore të secilës fjalë, është e nevojshme të vështrohet shtrirja e të njëjtave huazime në gjuhët tjera fqinje-ballkanike. Profesori Emil Lafe thotë: "Orientalizmat e shqipes ende nuk janë vështruar sistematikisht në përjasje me gjuhët fqinje ballkanike dhe me vetë gjuhën burimore për të hetuar si modifikimet fonetiko-gramatikore, ashtu edhe lëvizjet semantike (zgjerim e ngushtim kuptimi)."⁶ Në vazhdim do të përmendim disa huazime orientale që i kemi të përbashkëta me gjuhët sllave

⁵ Shaban Demiraj, "Rreth fjalorit të orientalizmeve në gjuhën shqipe të Tahir N. Dizdarit" në: Gjuha jonë XXVI 1-4 (Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 2006), f. 187.

⁶ Emil Lafe, "Persizmat në gjuhën shqipe - Trajtimi i tyre në veprën e Tahir N. Dizdarit "Fjalori i orientalizmeve në gjuhën shqipe", në: Perla XII 1-44 (Tiranë, fondacioni kulturor "Saadi Shirazi", 2007), f. 165.

ballkanike, p.sh.: *haber/aber, kalif/halif, kadaif, derman, sherbet, dynja, mashallah, ibrik, divan* etj., kurse në vazhdim do të japim disa shembuj të orientalizmeve me shtrirje të njëjtë semantike në disa prej gjuhët ballkanike, p.sh.: *абдал* “абдал еден!” (maqedonisht), *avdall* “kalë avdall” (shqip)⁷, *abdal*⁸ (serbo-kroatisht).

Sot është vështirë që në gjuhët e një familjeje të sajohen elementet e përbashkëta të tyre, sepse çdo gjuhë pëson ndryshime të mëdha nga globalizmi dhe sfidat asimiluese të kohës, prandaj do të ishte shumë me vend që secilës fjalë të huazuar nga gjuhët orientale t’i dihet saktësisht gjuha e parë burimore nga ku është huazuar, pastaj duke pasur parasysh edhe rrugëtimin e saj, që zakonisht ka shkuar përmes turqishtes, do të lehtësonte shumë punën e zbërthimit të fjalës si nga shtrirja semantike, ashtu dhe nga përbërja fonetike e gramatikore.

Nga shtjellimi i deritanishëm konstatojmë se shprehjet *turqizëm, arabizëm* dhe *persizëm* janë më specifike, sepse kanë të bëjnë me një kulturë, me një gjuhë dhe një popull të veçantë. Ndërkaq, *orientalizëm* është më i përgjithshëm, nuk ka të caktuar një popull, një gjuhë apo një kulturë të veçantë, por Lindjen në përgjithësi.

Përdorimin e shprehjes orientalizëm e pëlqen edhe studiuesi Mehdi Polisi, i cili ndër të tjera thotë: “Termi turqizëm arsyetohet me faktin se pjesa dërrmuese e tyre kanë hyrë në gjuhën shqipe përmes turqishtes, kurse termi orientalizëm arsyetohet me faktin se, pavarësisht nga rruga e depërtimit të tyre, gati më se gjysma e këtyre huazimeve të shqipes janë fjalë të burimit arab dhe persian. Mendoj se termi orientalizëm është më i përshtatshëm jo vetëm sepse gjysma e tyre janë fjalë arabe dhe persiane, po edhe për faktin se një numër i tyre, si *kalif, kalifat, kallf, admiral, zenit*, etj. kanë hyrë nëpërmjet gjuhëve evropiane, ose trajta themel, trajtë më e përgjithshme se *temel*, ka hyrë përmes greqishtes, *perdhe* (për perde), po ashtu nga greqishtja etj.”⁹ Pra, mendimi se duhet përdorur termin turqizëm, sepse orientalizmat kanë hyrë përmes turqishtes, nuk është shumë i qëlluar, ngase kemi arabizma ose persizma që nuk e kanë shfrytëzuar turqishten.

⁷ A.Kostallari dhe të tjerë, vep. e cit. f. 76.

⁸ Adullah Skajliç, *Turcizmi u srbskohrvatskom jeziku* (Sarajevo, “Svjetlost” izdavacko preduzece, 1966), f. 66.

⁹ Mehdi Polisi, “Leksiku islam, pjesë përbërëse e leksikut të shqipes”, në: *Edukata islame* nr. 78 (Prishtinë, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2005), f. 116.

Po ashtu, kur kemi parasysh faktin se studiuesi më i dalluar i orientalizmave, Tahir Dizdari, ka përdorur termin orientalizëm, atëherë, duke marrë parasysh edhe faktet tjera, ia vlen që termi më i përdorshëm dhe më i thirrur për këtë lëmë të jetë *orientalizëm/ma*.

Thënë shkurt, çdo turqizëm, persizëm dhe arabizëm është orientalizëm, kurse çdo orientalizëm nuk është turqizëm, persizëm apo arabizëm.

Përsëri, ndoshta do të ishte më e udhës që kjo tufë huazimesh të emërtohet si *osmanizma*, sepse fjala *orientalizëm* përfshin tërë botën lindore, edhe pse më shumë kuptohet Lindja e Mesme, kurse osmanishtja ishte një gjuhë që përbëhej prej këtyre tri gjuhëve që i theksuam (turqishtes, arabishtes dhe persishtes). Pra, meqë edhe huazimet janë fiks prej këtyre tri gjuhëve, atëherë ndoshta nocioni *osmanizëm* do të ishte më i përshtatshëm dhe më i thukët për këtë emërtim. Po ashtu, të mos e harrojmë të vërtetën se, fundi i fundit, shumica e këtyre fjalëve në gjuhën shqipe u huazuan në periudhën e Perandorisë Osmane dhe nga vetë gjuha osmane.

3. GLOBALIZMI DHE GJUHËT

3.1. Depërtimi i ngadalshëm i huazimeve në gjuhën shqipe në të kaluarën dhe përvetësimi i tyre sot

Depërtimet e huazimeve nëpër gjuhë, në të kaluarën, kanë qenë shumë më të ngadalëta se sot dhe janë bërë në rrugë të ndryshme.

Huazimet mes gjuhëve në të kaluarën janë bërë përmes pushtimeve, kolonive dhe tregtive të ndërsjella, d.m.th. një popull ka huazuar nga tjetri vetëm atëherë kur pushtoj, kur bënte tregti apo kur bëhej koloni e dikujt. Kurse sot është më ndryshe, ky fenomen ndjek hapa të ndryshëm prej atyre klasikë. Jo që ata nuk vlejné, por janë shumë pak të pranishëm, të paktën nëse i krahasojmë me rrjedhën bashkëkohore që ndjekin huazimet.

Shumica e gjuhëve të vjetra janë zhdukur ose kanë mbetur si gjuhë të vdekura vetëm si pasojë e huazimeve të shumta që kanë depërtuar tek ato, fillimisht, e pastaj edhe pushtimet që u janë bërë nga të tjerët.

Një gjë e tillë nuk ndodhi me shqipen, sepse shqiptarët çdoherë ishin të kujdesshëm me të tjerët dhe nuk kishin shumë kontakte.

Se si u ruajt gjuha shqipe nga huazimet dhe nga shkatërrimi e humbja, ashtu si u humbën motrat e saj, këtë më së mirë na e tregon rilindësi dhe filologu ynë Sami Frashëri: *“Shqiptarët e kanë mbajturë gjuhën’ e kombin’ e tyre jo me shkronja, as me dituri, as me qytetëri, por vetëm me dliri, me të, me të qënë gjithnjë vetëm e më vetëhe, me të mos përzjerë me të tjerë e me të mos kalluarë të huaj në vëndit të tyre. Të qëndruarëtë lark nga gjithë bota, nga dituritë, nga qytetëria, nga tregëria, me një fjalë, të rojturitë si të egërë nëpër malet u ka ruajturë e shpëtuarë shqipëtarevet gjuhën’ e kombërinë.”*¹⁰ Nga fjalët e mësipërme të Samiut kuptojmë se gjuha shqipe është ruajtur përmes ikjes së kontaktit me popujt tjerë. Megjithatë, shqiptarët ditën ta mbanin gjuhën e tyre, sepse ata edhe gjatë sundimit të Perandorisë Osmane u përkujdesën për gjuhën e tyre.

¹⁰ Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë* (Shkup, Logos-A, 2004), f. 36-37.

Ngadalësia e depërtimit të huazimeve në gjuhën shqipe në të kaluarën argumentohet edhe përmes këtij fakti, se në gjuhën shqipe apo në të folmet shqipe kanë depërtuar shumë fjalë angleze për një kohë shumë të shkurtër. Në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XX (por, edhe në fillim të shekullit XXI) leksiku i shqipes përjetoi një lëvizje të brendshme në disa shtresa të tij, u zbeh disi kujdesi për ruajtjen e pastërtisë së tij dhe për mbrojtjen e fjalës shqipe, saqë ka filluar të hetohet një dallim mes gjuhës së folur dhe asaj të shkruar. Pra, për një kohë shumë të shkurtër depërtuan shumë fjalë të burimit perëndimor (oksidentalizma), p.sh.: *bekraund, bebisitër, bodigard, bord, draft, killer, lidership, luk, menaxher, non-stop, okej, shou, uikend* etj.,¹¹ kurse për depërtimin e orientalizmeve u deshën, afërsisht, 600 vjet.

Popujt e mëhershëm huazonin nga njëri-tjetri vetëm si pasojë e nevojave apo imponimit fizik që u bëhej, kurse në të shumtën e rasteve qëllimet e sundimtarëve të vjetër nuk kanë qenë vetëm pushtimi i një tërësie territoriale të caktuar dhe administrimi i saj, por tentohej që populli i sunduar të zhvishet tërësisht nga identiteti i vet fetar, kombëtar etj. Për ta kuptuar më mirë këtë, duhet përmendur se asimilimi ishte shumë më i pranishëm se huazimi, mirëpo kështu nuk ngjau me shqiptarët.

Prallë ka ndodhur që një popull i vogël t'u mbijetojë të gjitha këtyre sfidave asimiluese gjatë historisë.

3.2. Globalizmi, armik i gjuhëve

Sot bota përparon me hapa shumë të shpejtë në sajë të globalizmit dhe të të arriturave teknologjike. Globalizmi nuk i solli vetëm mirësi njerëzimit, por edhe të këqija të shumta.

Ajo që na intereson neve është fusha e gjuhësisë. Në këtë fushë globalizmi dhe të arriturat teknologjike sollën shumë të mira: lehtësimin e komunikimit të popujve, duke studiuar dhe mësuar gjuhët e njëri-tjetrit, përpilimin e programeve të avancuara që mundësojnë mësimin dhe njohjen më të lehtë të gjuhëve dhe sistemet e tyre gramatikore etj. Gjithashtu, komunikimi dhe kontakti i njerëzve me njëri-tjetrin u bë shumë i lehtë, saqë disa mendimtarë kanë thënë se bota me globalizmin u bë si një *fshat i vogël*. Përveç kësaj, ka edhe anët negative, ngase mundëson depërtimin më të lehtë të huazimeve, apo

¹¹ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe* (Tiranë, Libri Universitar, 2002), f. 226-227.

ndikimin e gjuhëve të mëdha ndaj të voglave. Kur lidhjet janë më të mëdha, edhe marrëdhëniet janë më të theksuara.

Kur jemi te huazimet gjuhësore, bota sot (me globalizmin) është bërë një panair, në të cilin mund të vështrosh të gjitha fjalët si në tavolinë, ku gjuhët e vogla, edhe pse janë të pranishme, janë në një qoshe.

Të arriturat teknologjike dhe globalizmi na mundësojnë që të kemi afër çdo gjë që ndodh, që shpiket ose që qarkullon nëpër botë. Dhe, kur ne të ballafaqohemi me këto risi, atëherë duhet të përpiqemi t'u gjejmë fjalën e duhur në gjuhën tonë, ose në të kundërtën të huazojmë fjalën që kanë përdorur ata që e kanë shpikur atë veprim apo arritje.

Kjo është një dukuri të cilën e pësojnë popujt e vegjël dhe ata që janë më pak të zhvilluar. Edhe pse bota e moderuar sot thërret në demokratizim dhe të drejtën e fjalës, ajo në mënyrë të tërthortë, përmes globalizmit, i nxjerr jashtë loje të vegjëlit. Profesori malajzian Mahatir Muhamed thotë: *“Bota e globalizuar nuk do të jetë botë aq e demokratizuar. Bota e globalizuar do t'u takojë të fuqishmve, shteteve dominuese. Ato do të imponojnë vullnetin e tyre ndaj të tjerëve. Ndërsa të tjerët nuk do të jetojnë më mirë se sa që kanë jetuar atëherë kur ishin koloni të të pasurve.”*¹² Një dukuri e tillë ndodh edhe me gjuhët, sepse derisa i madhi dominon të voglin, atëherë nuk pritet që ky i madh të jetë aq i mëshirshëm ndaj gjuhës së të voglit, jo pse nuk e do, por pse nuk e heton praninë dhe ekzistencën e tij. Bota është bërë fushëbetëje e të mëdhenjve, ndërsa të vegjëllve u ka mbetur vetëm të jenë në anën e një të madhi.

Edhe në gjuhën shqipe kemi elemente dhe fjalë të huazuara nga gjuhët e popujve më të zhvilluar. Gjë që gjuhën shqipe, për nga fusha e huazimeve, nuk e çon në rrugë më të mirë se ç'ishte në Perandorinë Osmane, veçse sot kemi një gjuhë më të konsoliduar. Në vazhdim do të përmendim disa oksidentalizma të cilat globalizmi i ka shpërndarë në çdo cep të botës, ndër to edhe në gjuhën shqipe, p.sh.: *kompjuter, kozmologji, timon, bankë, kamion, tren, ideologji, televizor, telefon, internet, biznes, biznesmen, fondacion, sport, teletekst, vapor, matematikë, printer* etj., të cilat nuk kemi si i zëvendësojmë me fjalë të gjuhës sonë. Ndërkaq, e keqja më e madhe është se ne përdorim një numër bukur të mirë oksidentalizmash, për të cilat kemi fjalë të bukura të shqipes; p.sh.: *abuzoj* – keqpërdorj;

¹² Mahatir Muhamed, *Globalizmi dhe realitetet e reja* (Shkup, Furkan ISM, 2010), f. 254.

aderoj – anëtarësohem; *adresoj* – dërgoj (me postë), i drejtohem dikujt; *afishoj* – shpall, paraqes, parashtroj; *akcent* – theks; *aks rrugor* – rrugë; *akomodim* – rregullim, përshtatje, ujdije, strehim, pajisje; *i animuar* – i vizatuar, *anonçoj* – shpall; *aplikant* – kandidat, lutës; *asistencë* – prani, ndihmë; *atak* – sulm; *bankrot* – dështim, falimentim; *bord* – drejtori, udhëheqje.

Këto dhe shumë huazime bashkëkohore duhet shikuar dhe mënjanuar para se të bëhen pjesë e kulturës sonë, sepse si të bëjnë një jetëgjatësi në gjuhën tonë, atëherë bëhen pjesë e kulturës dhe saherë që të preket në to, humbet një thesar kulturor i ynë. Këtë e shohim nga e kaluara; ato huazime orientale që në gjuhën tonë jetuan me shekuj, kur tentuan që t'i pastrojnë tërësisht, u humb një pjesë e kulturës kombëtare.

Ky fenomen tregon dominimin e më të fortit ndaj më të dobët, apo zhdukjen e tij.

4. DUKURIA E MARRJES DHE E DHËNIES SË SHQIPES ME GJUHËT TJERA

Lidhja e gjuhëve me njëra-tjetrën është një dukuri që ka ngjarë që prej mijëra vjetësh më parë, madje qëkur ka filluar historia e njerëzimit, ose më saktë qëkur njerëzit filluan të flisnin më shumë se një gjuhë. Ajo mund të ketë ngjarë 100.000 ose 200.000 vjet më parë, ose edhe shumë më herët.¹³

Kur njerëzimi ka folur një gjuhë, dukuria e huazimit apo e marrëdhënies së gjuhëve nuk ka qenë e pranishme, sepse ka pasur vetëm një gjuhë. Formimi i gjuhës së dytë mbi faqen e dheut, solli mundësinë për vrojtimin e elementeve të përbashkëta mes tyre. Dukuria e huazimit të gjuhëve më të hershme ka pasur një dyndje më të madhe, aq më shumë kur e dimë se gjuhët janë formuar nga njëra-tjetra; e dyta nga e para, e treta nga dy të parat, e kështu me radhë.

Shtjellimi i mëparshëm na jep të kuptojmë se sa më të përbashkët ta ketë jetesën një popull me një tjetër, aq më shumë do të kenë edhe ngjashmëri gjuhësore. Thënë shkurt, sa më shumë të ketë marrëdhënie një popull me një tjetër, aq më shumë do të ketë edhe ngjashmëri. Pra, për të studiuar një gjuhë, veçanërisht leksikun e saj, duhet të shikohet rrugëtimi i asaj gjuhe dhe i popullit të saj nëpër histori; marrëdhëniet me të tjerët, raportet me fqinjët, vendndodhja gjeografike, feja e tyre (edhe në të kaluarën, edhe tash, sepse më herët mund të ketë pasur një fe tjetër, e tash një tjetër) etj.

Për këtë rrjedhë Edvard Sapir ka thënë: *“Gjuhët, sikurse qytetërimet, rrallëherë i mjaftojnë vetvetes. Takimet e detyruara sjellin në kontakt direkt ose indirekt një popull me një tjetër që flet gjuhë të afërt ose gjuhë të një qytetërimi më të evoluar. Takimi mund të jetë miqësor ose armiqësor; ai mund të ketë si rezultat këmbime të drejtpërdrejta në tregti dhe në punë të tjera afariste, ose këmbime shpirtërore në fushën e artit, shkencës ose religjionit. Nuk do të ishte lehtë të cekësh një gjuhë ose një dialekt tërësisht të izoluar, ndërsa fakti do të ishte edhe më i rrallë ndër popuj primitivë”*.¹⁴

¹³ Sarah G. Thomason, *Language contact – an introduction* (Edinburgh, Edinburgh University Press, 1988), f. 6.

¹⁴ Edvard Sapir, *Le langage* (Paris, 1970), f. 189.

Nga fjalët e cituara më lart të Edvard Sapirit nxjerrim disa elemente të rëndësishme që ndërlidhen me fenomenin e huazimeve në tërësi:

- *Të gjitha gjuhët e botës huazojnë nga njëra-tjetra.* Pavarësisht prestigjit të tyre, ato janë të lidhura dhe huazojnë nga njëra-tjetra. Ndonëse, ndokund mund të jetë më pak e theksuar, por jo pa të. Edhe ajo gjuhë që duket se nuk ka shumë huazime, është si rezultat i pamundësisë sonë për t'iu qasur asaj, apo për arsye të tjera. P.sh. gjuha latine nuk është gjuha e parë mbi faqen e dheut, mirëpo nga pamundësia për ta studiuar prejardhjen e leksikut të saj, ne ngecim aty. Megjithatë, kjo ngecje nuk do të thotë se ajo është krejt e pavarur nga simotrat e saj të mëparshme.

Ashtu sikur gjuhët, edhe kulturat dhe qytetërimet janë të ndërlidhura mes vete. Nuk ka qytetërim në botë që çdo gjë ta ketë nisur nga fillimi, duke mos huazuar nga qytetërimet e mëhershme! Kur kemi parasysh realitetin se njëri ndër faktorët kyç në formimin e një gjuhe është kultura dhe qytetërimi, kuptojmë se edhe gjuhët nuk mund të krijohen a të formohen nga vetvetja.

- *Takimi i një gjuhe me një tjetër bëhet direkt dhe indirekt.* Huazimi direkt ngjet atëherë kur një gjuhë merr drejtpërdrejt nga një tjetër. P.sh. rasti i turqizimeve në gjuhën tonë. Turqizmat kanë depërtuar drejtpërdrejt në gjuhën shqipe, sepse dëshmohet historikisht se shqiptarët dhe turqit historia i lidh për shumë gjëra, për të mirë e për të keq.

Huazimi indirekt vjen në shprehje atëherë kur popujt e të dy gjuhëve, asaj që huazon dhe asaj nga e cila huazohet, nuk kanë pasur mundësinë e takimit direkt me njëri-tjetrin, por në huazimet e tilla ka ndërmjetësuar një gjuhë ose një faktor i tretë. P.sh. në gjuhën shqipe huazime gjuhësore indirekte kemi nga gjuha arabe, perse, hebraike, angleze etj.

Për mënyrën e depërtimit të orientalizimeve në gjuhën shqipe do të flasim gjerësisht më andej.

- *Gjuha mund të huazojë nga një simotër e saj kur ato janë të përafërta ose kur gjuha prej së cilës huazojmë përdoret nga një qytetërim shumë më i zhvilluar.* Këto janë dy mundësitë e vetme të huazimit të gjuhëve. Në këto dy pika përfshihen edhe shumë nënpika të tjera.

Në gjuhën shqipe kemi huazime nga të dy rastet: edhe për shkak të afërsisë, siç është rasti me gjuhët tjera indoevropiane, por edhe për shkak të kontaktit me gjuhët e popujve të qytetërimeve më të zhvilluara, p.sh. me osmanishten, anglishten, frëngjishten etj.

- *Takimi i dy gjuhëve mund të bëhej në raste miqësie dhe armiqësie të dy popujve.* Nëse dy gjuhë takohen në kohë paqe, atëherë fjalët e huazuara do të zgjedhen nga populli që huazon. E, nëse takimi është armiqësor, atëherë për fjalët që do të huazohen më shumë do të kujdeset sundimtari, sepse ai do të instalojë administratën, pushtetin, arsimin dhe çdo gjë në gjuhën e vet.
- *Gjithashtu, takimi i dy gjuhëve mund të ndodhë në dy sfera: në tregti ose afarizëm,* gjë që përfshin vlerat materiale të një populli, dhe në trashëgimitë kulturore, ku përfshihen vlerat shpirtërore, si p.sh. në shkencë, traditë, fe etj.

Për të huazuar fjalë nga sfera e të mirave materiale të një populli, patjetër duhet që mes atyre dy popujve të ketë takim të drejtpërdrejtë, kurse sa u përket fjalëve nga sfera e vlerave shpirtërore, këtu nuk kushtëzohet takimi i drejtpërdrejtë i dy popujve.

- Sa më i izoluar të jetë një popull, aq do të mund ta ruajë edhe pastërtinë e gjuhës nga huazimet.

Shqiptarët, deri atëherë kur nuk pranuan të përzihen me popujt e tjerë, e ruajtën gjuhën e pastër shqipe nga ndikimet e të huajve. Atëherë kur filluan përzjerjet e shqiptarëve me popujt tjerë, filluan të depërtojnë edhe fjalët e huaja në leksikun e gjuhës shqipe.

Fqinjësia që populli shqiptar ka pasur gjatë historisë me sllavët, grekët, rumunët, turqit etj; marrëdhëniet ekonomike, politike, tregtare dhe shumë faktorë tjerë, kanë bërë që këto gjuhë të pësojnë apo të huazojnë nga njëra-tjetra.

Është e njohur thënia se gjuha e një populli pasqyron rrugën që ka përshkuar ai popull gjatë historisë së tij. Këtë pohim e dëshmon edhe gjuha shqipe me marrëdhëniet e saj të ndërsjella me një varg gjuhësh, që nga kohët më të lashta deri në ditët tona. Fryt i këtyre marrëdhënieve historike janë shtresat e fjalëve me burim nga gjuhët me të cilat shqipja ka pasur takime të dendura e të gjata. Ndër këto shtresa një vend të veçantë zë shtresa e orientalizmeve, qoftë nga rrethanat që e sollën atë në gjuhën shqipe, qoftë nga

vendi që zë ajo në strukturën leksikore të shqipes dhe nga qëndrimi që është mbajtur ndaj saj. Orientalizmat janë dukuri e përgjithshme për gjuhët e Ballkanit.¹⁵ Gjuha shqipe nuk është gjuha e vetme që u prek prej orientalizmeve, as nuk është gjuha që përvetësoi më shumë huazime orientale se gjuhët tjera. Përkundrazi, edhe pse populli shqiptar qëndroi më gjatë se të gjithë popujt tjerë të Ballkanit nën Perandorinë Osmane, ai huazoi më pak orientalizma. Këtë të vërtetë e thotë vetë studiuesi shqiptar më serioz në fushën e orientalizmeve, Tahir Dizdari: “Kam bindjen, - vëren ai, - se në shqipen tonë kanë hy aso huazimesh turke, që ma së forti emërtonin gjana e rasa (me kuptim konkret e abstrakt), që nuk njiheshin në popull ma parë e rrallë për të formua sinonime a për të shprehë a trajtue një gjasend që përfshihesh në thesarin e gjuhës sonë... nuk kanë depërtue fjalë të rëndomta e të thjeshta, që e kanë ekuivalentin, si ç’asht: *djepi, luga, ufulla, ura* etj. si këto, si ç’ka nga me ndonjë gjuhë tjetër të Ballkanit (sh. Bakotiq – 1936: *beshika, kashika, quprija, sirqe*)”¹⁶. Pra, shqipja huazoi ato që huazuan të gjithë, që nuk kishte fjalë shqipe për dukuritë dhe gjërat që vinin prej botës lindore dhe u iku të gjitha elementeve leksikore që në gjuhën tonë kishin barasvlerat e veta.

4.1. Gjuha shqipe në rolin dhënës - albanizmat

Gjuha shqipe, ashtu si dhe gjuhët tjera botërore, gjatë marrëdhënieve të gjata historike me gjuhët fqinje, ka njohur dy dukuri shumë të rëndësishme për historinë e saj: dukurinë e rolit marrës, nga njëra anë, dhe atë të rolit dhënës, nga ana tjetër,¹⁷ por çdoherë duke pasur parasysh se ajo që ishte shumë e theksuar është roli marrës, kurse ai dhënës, më pak i dukshëm.

Profesor Eqrem Çabej thotë: “Krahas me elementet e huazuara të shqipes, duhet pasur parasysh edhe elementet e shqipes në gjuhët e tjera të Evropës Juglindore, e veçanërisht të Ballkanit. Kontributi i shqipes, si një nga gjuhët e lashta të kësaj treve, në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike është një nga temat që meritojnë të studiohen më

¹⁵ Emil Lafe, “Orientalizmat si verb poetik te Sadiu shqip” në: Perla XII 1-44 (Tiranë, fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2007), f. 31-32.

¹⁶ Tahir Dizdari. “Disa vëzhgime mbi turqizmat në shqipe”, në: “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 15 – 21 nëndor 1962”. Universiteti Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë, 1965), f. 407.

¹⁷ Safet Hoxha, *Elementet leksikore të gjuhës shqipe në gjuhët sllave ballkanike* (Tiranë, 2003), f. 25.

në thellësi e me një frymë objektive në të ardhmen.”¹⁸ Edhe më i rëndësishëm bëhet studimi i rolit dhënës të shqipes kur të bie në mend pozita gjeografike e shqiptarëve, sepse ata ishin urë lidhëse për një pjesë të orientalizmeve në gjuhët e Ballkanit. Pra, është shumë e logjikshme që huazimet orientale fillimisht të jenë përvetësuar nga shqiptarët. Këtu vërehet një ndikim jo i fuqishëm i shqipes në gjuhët e Ballkanit, sepse jepte vetëm atë që merrte prej të tjerëve, mirëpo kjo nuk e mohon faktin se shqipja ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë, edhe pse jo të madh, në gjuhët e Ballkanit.

Është vërtetuar gjithashtu se edhe shqipja ka ndikuar nga ana e saj mbi greqishten. Në greqishten e re gjenden rreth 70 fjalë të burimit shqip.¹⁹ Pra, elementet e para të shqipes duhet të kenë qenë në gjuhën greke, sepse disa elemente që sot i ka greqishtja e re, të trashëguara nga greqishtja e vjetër, gjejnë shpjegim vetëm në gjuhën shqipe, p.sh. *rentai* “rend, vrapoj”, *suton* “shytë”, *dhasos* “dash”, *metubaris* “vend moçalik”, *skouli* “shkul”, *kaciki* “kec”, *maleoi* “mal”, *depas* “djep” etj.

Gjatë periudhës së gjatë historike të marrëdhënieve gjuha “nënë” e shqipes, ilirishtja, i ka dhënë disa elemente leksikore edhe latinishtes, njëres nga gjuhët më të mëdha të kohës. Këto elemente leksikore, që ndeshen edhe në disa dialekte romane të Italisë, sot shpjegohen vetëm me shqipen dhe ky është një argument që dëshmon për burimin historik të tyre. Disa prej këtyre elementeve janë edhe këto: *bardia* (equa *bardia*) “barëse”; *burdo* (*burdo* – *burdonis*) “burdhë”; *baro* (*baro* – *baronis*) “bari”; *lama* “lëmë”; *brisa* “bërsi”; *manus* “kalë i vogël”; *baltea* “topth i vogël prej balte” etj.²⁰

Sa i përket shqipes në rolin dhënës, ajo u ka dhënë gjuhëve ballkanike mjaft elemente të saj në të gjitha rrafshet gjuhësore (që më i theksuar është në leksik), p.sh. në fjalorin e gjuhës maqedonase mund të gjesh 150 albanizma, kurse, nëse i llogarisim edhe ato që përdoren në të folmet maqedonase, sillen prej 350 gjer më 400 sosh, përfshi këtu edhe albanizmat lokalë...²¹ Në vazhdim do t’i përmendim vetëm disa albanizma që kanë një dyndje më të madhe te maqedonasit, p.sh.: *aqm* “aft”; *бapз* “emër lope a dhije e

¹⁸ Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes* (Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1982), vëll.I. f. 115.

¹⁹ J.Thomai, vep. e cit. f. 232.

²⁰ S.Hoxha, vep. e cit. f. 28.

²¹ Olivera Jashar-Nasteva, *Turskite leksicki elementi vo makedonskiot jazik* (Shkup, Krste Misirkov, 2001), f. 40.

bardhë” dhe *барзив,-а* “i bardhë”; *буза* “buzë”; *бур* “djalë”; *врапит* “i shpjetë”...²² Gjithashtu, prej ndikimeve të këtilla të shqipes në gjuhët ballkanike do të përmendim modelet dhe gjedhet gramatikore që kanë hyrë në to (sepse, kur ka ndikime sintaksore, atëherë ndikimi është shumë më i madh), p.sh. konstruktet perfektive me foljen *kam* në maqedonishte, si *imam videno, imam pojdeno* – rrjedhur prej shqipes *kam parë, kam shkuar*...²³

Ndikimi i gjuhës shqipe në gjuhën serbe nuk ka qenë i vogël, përkatësisht në të folmen serbe të Kosovës. Disa albanologë, ndër ta edhe prof. Idriz Ajeti, thonë se Glisha Elezoviç në fjalorin e së folmes serbe të Kosovës ka shënuar afërsisht 300 fjalë me prejardhje shqipe, edhe pse ai për shumicën e tyre ka heshtur dhe i ka lënë të papërkufizuara. Ndër to janë: *bazdore* “lloj buke nga brumi i thatë i elbit”; *balo* “kalë i bardhë”; *dalta* “daltë” etj.²⁴

Ky ndikim i gjuhës shqipe në gjuhët sllave dhe anasjelltas, nuk është vetëm si rezultat i fqinjësisë së vonë me ta, por një marrëdhënie e shqiptarëve me popujt sllavë njihet shumë më herët, madje qëkur kanë ardhur në tokat ballkanike, sepse qysh atëherë tokat ilire u tkurrën nga pushtuesit sllavë. Gjithashtu, një rol të veçantë këtu ka luajtur sundimi bullgar, që zgjati afërsisht deri në shekullin X.

Për ndikimin e gjuhës shqipe në gjuhët orientale nuk kemi ndonjë të dhënë, edhe pse disa e pohojnë një gjë të tillë.

Në gjuhën turke, arabe dhe persiane roli dhënës është pothuajse jo i pranishëm, përveç disa përjashtimeve të vogla në gjuhën turke.

Roli dhënës, më i theksuar, është në gjuhët fqinje sllave, greke, etj.

4.2. Gjuha shqipe në rolin marrës - huazimet

Roli marrës është shumë më i theksuar në gjuhën tonë sesa ai dhënës.

²² Haki Ymeri, “Elemente leksikore shqipe në fjalorin e gjuhës maqedonase I, II, III”, në: Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë (Konferencë shkencore, Tiranë, 2005), f. 320.

²³ Qemal Murati, “Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e studimeve ballkanologjike” në: Gjurmime albanologjike, XX (Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1990), f. 263.

²⁴ Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes I* (Prishtinë, Rilindja, 1982), f. 54-62.

Popujt që sunduan dhe që ishin me popullsi më të madhe, më pak huazuan nga të tjerët, sepse është e ditur se ai që sundon imponon, kurse ai që sundohet detyrohet të pranojë çdo gjë. Andaj, shqiptarët ishin popull i vogël në krahasim me ata që i sunduan, ashtu që u detyruan të ndryshonin shumë gjëra. Megjithatë, sundimi nuk ishte shkaku i vetëm që shqiptarët huazuan nga të tjerët, por kishte edhe shtytës të tjerë, të cilët do t'i shtjellojmë në një kre të veçantë.

Popujt dhe gjuhët nga ku huazuan shqiptarët janë disa dhe lidhen shumë ngushtë me rrethanat historike. Në gjuhën tonë ka edhe shumë fjalë nga gjuhët indoevropiane, por ato nuk konsiderohen huazime, sepse gjuha shqipe është gjuhë e asaj familjeje, p.sh.: *drekë, kohë, shteg, natë, mjekër, punë, emër, djeg, dal, qaj, gjarpër, zog, dem, veri, i butë, i ligë, çel* etj. Në vazhdim do të flasim për disa gjuhë nga ku ka huazuar gjuha jonë:

- Elementi grek. Fjalët greke në gjuhën shqipe hynë që nga shek. VIII para epokës sonë, kur kolonë greke erdhën dhe u vendosën në trojet ilire. Fjalët greke në gjuhën shqipe gjejnë një shtrirje bukur të mirë, p.sh.: *fier, qershi, pjepër, presh, mokër, lakër, lajm, fis, pronë, flamur, trastë, avlli, trëndafil, i pastër, tipar, stolis, mëndafsh* etj. Një pjesë e madhe e huazimeve leksikore nga greqishtja kanë mbetur në të folme anësore si krahinorizma. Një pjesë tjetër kanë ose po dalin nga përdorimi si fjalë të vjetëruara.²⁵
- Elementi latin. Gjithashtu, edhe elementi latin në gjuhën shqipe është shumë i theksuar, sepse edhe romanët sunduan trojet shqiptare rreth 500 vjet-edhe para epokës sonë, edhe pas saj. Disa huazime latine në gjuhën shqipe janë këto: *mjek, qytet, shkurt, mars, prill, maj, ulli, lëvdoj, pagëzgj, shpirt, flok, mëkat, këngë, li, pyll, furrë, e martë, e mërkurë, faqe, këmbë, pushtet, mbret, shok, meshë, prift, qepë, fqinj, letër, kunat, ungj, krushk, mashkull, femër, pulë*. Fjalë nga gjuha latine në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe prej frëngjishtes dhe italishtes.
- Elementi oriental (pers, arab dhe turk). Huazimet orientale po ashtu kanë një shtrirje shumë të gjerë në leksikun e shqipes. Më imtësisht flitet në krerët tjerë, mirëpo në vijim do të përmendim një pjesë të tyre, p.sh.:

²⁵ J.Thomai, vep. e cit. f. 232-233.

a) arabizma: *ifade, iflas, mahsus, bukur, qeder, qefil, qebap, rezil, revani, firak, gani, galiba, hyxhere, imza, mahsher, mahsus, mashallah, sabij, salltanet, ders, derexhe, sabër, gaflet, sahat, qibrit, iftira.*

Kur flitet për ndikimin e gjuhës arabe, ajo nuk ishte e pranishme vetëm në gjuhën tonë, por në shumë gjuhë të botës, saqë studiuesi i njohur botëror Eduart Sapir atë e rendit në pesë gjuhët më me ndikim në botë, andaj thotë: “Janë vetëm pesë gjuhë që kanë pasur një rëndësi të jashtëzakonshme në kulturën botërore. Ato janë: gjuha e vjetër kineze, sanskritishtja, arabishtja, greqishtja (e vjetër) dhe latinishtja.”²⁶ Madje, arabishtja është gjuhë që ende vazhdon të ketë ndikim nëpër botë, ndoshta sepse mësimet themelore islame janë në atë gjuhë, ku çdo studiues serioz i fesë e ka patjetër që ta mësojë atë. Kur dihet se numri i muslimanëve dita-ditës rritet, atëherë edhe numri i atyre që i përvetësojnë shprehjet fetare arabe është më i madh, shprehje të cilat pastaj emërtohen si *profesionalizma*.

b) turqizma: *mais, iqidebir, içkala, karabina, katik, olli, revani, majasil, shishman, çubuk, jatak, penxhere, kapixhik, borxhli, bosh, bojë, jashmak, pembe, shilte, shishane, çapkën, çakmak, shkembe, jastëk;*

c) persizma: *hysref, rustem, ruspi, jasemin, çullha, badihava, baft, shirë, jahni, ferjan, dyrys, junan, penç, perishan, bostan, ballsam, peshqesh, peshqir, qilim, qofte, derbeder, sallname, revani, dizap.*

Kur jemi te huazimet orientale, duhet theksuar se gjuha jonë në mënyrë të tërthortë ka huazuar edhe nga gjuhë më të hershme orientale, kuptohet përmes këtyre tri gjuhëve kryesore. Sa për ilustrim do të theksoj disa shembuj nga gjuhët hebraike, të cilat ne i kemi huazuar si arabizma apo turqizma. Do të veçoja disa antroponime hebraike, sepse fjalëve që kanë karakter të përgjithshëm është shumë vështirë t’ua gjesh gjuhën e parë, ngase edhe arabishtja edhe hebraishtja janë gjuhë semite, p.sh.: *Ibrahim, Ismail, Jakup, Junus, Jusuf, Sulejman, Musa, Harun, Isa etj.*²⁷

²⁶ Edward Sapir, *Language – an introduction to the study of speech* (New York, Harcourt, Brace and Company, 1921), f. 207.

²⁷ Këto janë disa antroponime të cilat ne i përdorim në onomastikën shqiptare, madje kanë një shtrirje shumë të gjerë në mesin e popullit, veçanërisht te muslimanët, por që janë emra të pejgamberëve të dërguar te Ben Israilitë (hebrenjtë e hershëm), prandaj nuk mund të themi se janë arabizma.

- Elementi sllav. Eqrem Çabej në “Studime etimologjike në fushë të shqipës” trajton rreth 612 sllavizma të shqipës, 165 prej të cilave sillen për herë të parë. Po sjellim disa nga huazimet më të përhapura sllave në gjuhën shqipe: emrat *strehë, pod, prag, grazhd, stol, oborr, kosh, kovë, koritë, sitë, brazdë, sanë, rrepë, kastravec, govedar, stopan, zhabë, sokol, ezh, piavicë, mrezhë, opingë/opangë, zakon, porotë, rob, plaçkë, carinë, porez, gjobë, pobratim, koskë, vërsnik*; foljet *vadit, prashit, vozit, darovit, godit, çudit* etj.²⁸ Kuptohet, pjesa më e madhe e tyre ka gjetur vend në të folmet krahinore që kanë qenë afër popujve sllavë.
- Elementi oksidental (nga gjuhët perëndimore: anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja, spanjishtja etj). Elementi oksidental është i pranishëm në leksikun e gjuhës shqipe, mirëpo duhet pasur kujdes, ka një tufë fjalësh që ne i kemi huazuar nga gjuha latine, e të mos mendojmë se ato janë fjalë italiane ose frënge. Një pjesë e mirë e këtyre oksidentalizmave mund të quhen edhe ndërkombëtarizma, sepse kanë gjetur shtrirje në shumë gjuhë të botës.

Në vijim do të përmendim një sërë oksidentalizmash, të cilave nuk do t’ua shpjegojmë gjuhën nga ku i ka huazuar gjuha shqipe, sepse për këtë do të nevojitej një punim i tërë. Gjithashtu, nuk do t’u kushtohet vëmendje se ato të njëjtat a kanë fjalë të barasvlershme në gjuhën tonë ose jo. P.sh.: *abort, agjitacion, divizion, fleksibil, dirigjoj, fortifikoj, impotencë, kamerë, kosto, kufje, involvoj, prononcoj, suprimoj, konspiroj, konvoj, staf, akses, fiskal, fiasko, balotazh, okular, independent, konstitutiv, liferoj, marinca, konsensus, inkludim, privoj, participim, monitoring, stacion, transparencë* etj.

Gjithashtu, kemi një numër të konsiderueshëm fjalësh të huaja të cilat dita-ditës depërtojnë në gjuhën tonë. Ato janë fjalë të profesioneve të ndryshme. Përderisa disiplinat shkencore vazhdojnë ta ndërtojnë veten shumë e më shumë, atëherë kuptohet se fjalët profesionale të fushave të ndryshme do të shtohen nëpër të gjitha gjuhët e botës. Këto me një fjalë mund t’i quajmë *profesionalizma*. Ndër profesionalizmat orientale kemi fjalët: *algjebër, kimi, zero, admiral* etj.

²⁸ Asllan Hamiti, “Ndihma e profesor Eqrem Çabejt në studimin e marrëdhënieve të shqipës me gjuhët sllave”, në: “Eqrem Çabej, figura që shkëlqeu në studimet albanologjike” – Konferenca IV Ndërkombëtare për Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, 19-20 dhjetor (Tetovë, 2008), f. 126.

Shqiptarët në kohën kur u sunduan nga të tjerët, përkatësisht nga osmanlinjtë, nuk kishin një thesar të konsiderueshëm të gjuhës së shkruar, madje nuk kishin alfabetin e tyre, por shfrytëzonin alfabetet e huaja. Kurse gjuhët e sundimtarëve ishin të zhvilluara dhe të konsoliduara mirë. Pra, fenomeni i huazimeve zakonisht është një fenomen reciprok mes dy gjuhëve, por në rastin e gjuhës shqipe kemi të bëjmë me disa gjuhë të prestigjit më të lartë nga shqipja, të paktën për atë kohë.

5. QËNDRIMET NDAJ HUAZIMEVE, ME THEKS TË VEÇANTË NDAJ ORIENTALIZMAVE

Dukuria e huazimeve nuk është një punë krejt e papranuar, sepse përmes huazimeve janë formuar gjuhët, por as krejt e pranuar, sepse me to edhe janë shkatërruar gjuhët. Prandaj, ato duhet shikuar në dy kënde: *huazime, pasurim për gjuhët dhe huazime, shkatërrim për gjuhët*. Pra, dukuria e huazimit nuk do të mund të ndalet asnjëherë. Çdo përpjekje për një gjë të tillë është dështim. Por, çdoherë duhet menduar se çfarë, kur dhe sa të huazojmë.

Duke ecur në hullinë e punës së rilindësve, sipas parimit që pasurimi dhe zhvillimi i gjuhës letrare shqipe duhet të bëhet në përputhje me natyrën e saj, prof. A. Xhuvani e sheh të natyrshëm edhe huazimin e fjalëve të huaja si burim plotësues për pasurimin e gjuhës kur thotë: *“Asnjë gjuhë nuk mund t’i reshtet ndikimit të gjuhëve të tjera dhe të jetë e pastër nga çdo gjë e huaj.”*²⁹

Qëndrim të njëjtë mbajnë edhe disa albanologë të tjerë, ndër ta edhe studiuesi i mirënjohur Rexhep Qosja kur thotë: *“Mund të thuhet se përdorimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhët e popujve të tjerë, është i domosdoshëm. Purizmi, që bazohet në parimin e përjashtimit prej gjuhës kombëtare të të gjitha fjalëve të huaja, është i dëmshëm, siç është i dëmshëm edhe përdorimi i tyre, natyrisht në rastet kur nuk janë, vërtet, të domosdoshme.”*³⁰ Këtu na bëhet me dije se gjuhë tërësisht të pavarur nga një simotër e saj nuk ka, sepse të gjitha gjuhët e botës kanë marrë nga gjuhët tjera. Andaj, edhe gjuha shqipe, sigurisht, ka huazuar nga gjuhët e popujve të tjerë.

Pastrimi i tërësishëm është i pamundur, ashtu sikurse që nuk është i lejueshëm edhe përdorimi i panevojshëm i fjalëve të huaja duke pasur fjalën e bukur shqipe (kur i mbulon të gjitha kuptimet që ajo mund t’i ketë). Babai i gjuhës shqipe, Naim Frashëri, në poezinë e tij “Gjuha shqipe” për pastrimin e gjuhës thotë: *“Ju shkëmbinj e ju male / Ju brinja e*

²⁹ Hëna Pasho, “Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe”, në: Studime filologjike 1-2 (Tiranë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1999), f. 87.

³⁰ Rexhep Qosja, *Nocione të reja albanologjike* (Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1983), f. 73.

*bregore / Dhe ju lumënj nga dale / Ju fusha gjelbërrore / Shqip të flisni për herë / Fjesht' e të pa përzierë/.*³¹

5.1. Qëndrimet e shkrimtarëve dhe filologëve gjatë periudhave letrare

Për të kuptuar qëndrimet e letrarëve dhe gjuhëtarëve shqiptarë, më mirë do të ishte që ato t'i paraqesim sipas periudhave letrare dhe kohës kur ata kanë jetuar. Paraqitja e disa mendimeve të tyre për dukurinë e orientalizmave, do të na japë edhe një pasqyrë të mirëfilltë për mendimin e përgjithshëm të asaj periudhe për huazimet orientale. Pra, përmes qëndrimeve të shkrimtarëve nuk synojmë të mbërrijmë në një përfundim se a duhet apo nuk duhet hequr huazimet orientale, por thjesht të shohim se si ka qenë qëndrimi i përgjithshëm nëpër periudha letrare. Në vazhdim do të paraqesim disa qëndrime të shkrimtarëve shqiptarë në secilën prej periudhave letrare. Për secilën periudhë letrare do ta marrim mendimin e një shkrimtari të dalluar, ose mendimin e përgjithshëm të asaj kohe:

- Letërsia e vjetër (para bejtexhinje³²) është periudha letrare gjatë së cilës huazimet orientale kanë qenë jo fort të theksuara. Është shumë normale, pra, që gjatë kësaj periudhe të jetë bërë një përpjekje për të ndaluar vrullin oriental që vërshonte Ballkanin, përfshi dhe tokat shqiptare. Ndonjë qëndrim të drejtpërdrejtë të shkrimtarëve të letërsisë së vjetër për huazimet orientale nuk kemi, sepse ajo kuptohet prej shprehjeve të përgjithshme kundër Perandorisë Osmane. Ishte shumë e natyrshme që ata të luftonin me ngulm ndaj orientalizmave, sepse asokohe shqiptarët nuk i lidhte asgjë me turqit, madje, në masë të madhe, as feja.

Frang Bardhi, themeluesi i leksikografisë shqipe, duke parë ndikimin e vërshimit osman në tokën dhe gjuhën tonë ka thënë: *"Ta ruajmë gjuhën, të mos bdaret e të mos bastardhohet."* Për këtë autori *"ka qitunë mbë dritë me djersë të mëdha shumë fjalë plaka e të harrueme"*, siç do të shprehej Pjetër Bogdani.³³ Pra, ajo që kërkohet ishte

³¹ Naim Frashëri, *Vepra* (Prishtinë, Rilindja, 1986), vëll.II. f. 129.

³² Në historinë e letërsisë shqipe, bejtexhinjtë janë mësuar nën hijen e letërsisë së vjetër, mirëpo kohëve të fundit një pjesë e mirë e studiuesve të letërsisë, ata i rendisin në një periudhë të veçantë, secila me veçoritë e veta.

³³ Jani Stefi, *Leksikologjia shqipe* (Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, 1970), f. 93.

të ndalej depërtimi i fjalëve orientale në gjuhën shqipe, sepse hyrja e orientalizmave në gjuhën shqipe tashmë kishte filluar të bëhej tufë-tufë. Gjithashtu, vetë dëshira për të përpiluar një fjalor, siç veproi Bardhi, tregon nismën për mbrojtjen e gjuhës shqipe nga fjalët orientale.

- Letërsia e bejtexhinjve konsiderohet periudha kohore në të cilën gjuha shqipe u ngjesh me orientalizma. Ishte shumë e natyrshme që të ndodhte kjo, sepse trojet shqiptare ishin islamizuar, shqiptarët kishin filluar të shkolloheshin nëpër qendrat universitare të Perandorisë Osmane dhe të botës arabe, marrëdhëniet tregtare ishin shpeshtuar, ishin hapur mejtepe dhe medrese, ishin ndërtuar bezistene dhe xhami dhe, mbi të gjitha, gjuha osmane ishte gjuhë e administratës, e jetës publike.

Ashtu si sot që kemi një depërtim të shpejtë të fjalëve oksidentale - ngase gjithë popujt synojnë Perëndimin - ashtu edhe shqiptarët atëherë synonin Lindjen, sepse asokohe qytetërimi i Lindjes dominonte botën. Në dallim prej kësaj që ndodh sot me gjuhën shqipe, e cila është e konsoliduar, huazimet orientale konsideroheshin fjalë shqipe në të shumtën e rasteve, sepse shqiptarët nuk kishin një leksikografi dhe një gjuhë të standardizuar që të mund ta peshonin fjalën e huaj që kërkonte vend në gjuhën tonë.

Nezim Frakulla, një nga shkrimtarët e dalluar të periudhës së bejtexhinjve, në fillim të *Divanit* të tij thotë se vjershën e ka shkruar shqip:

“Këtë divan e zuna në shqip,
Inshall-llah na vjen në tertip.”³⁴

Vërtet periudha e bejtexhinjve ishte e ngjeshur me orientalizma, mirëpo jo të gjithë krijuesit ishin të një mendimi në lidhje me këtë. Kishte dy rryma: njëra që mendonte se gjuha poetike e veprës duhet mbushur me barbarizma, kinse ajo është kërkesë e poetikës letrare orientale, dhe tjetra që mendonte se gjuha poetike duhej pastruar sa më tepër nga barbarizmat dhe të vihej mbi bazat e gjuhës popullore, pas së cilës qëndronte Sulejman Naibi. Ky i fundit madje polemizoi poetikisht me Nezim Frakullën, duke e kritikuar mësuesin e tij për përdorim të tepruar të barbarizmave. Të

³⁴ Abullah Hamiti, *Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip* (Shkup, Logos-A, 2008), f. 156.

afërt me rrymën e dytë janë edhe Hasan Z. Kamberi, Zenel Bastari etj. Megjithëse edhe këta të fundit nuk i qëndrojnë aq besnik purizmit të S.Naibit.³⁵

- Romantizmi. Naim Frashëri i qorton rëndë autorët e periudhës së bejtexhinjve se kanë bërë “faj që s’faletë e mëkat që s’ndjehetë”, kanë përzier gjuhën e bukur shqipe me fjalë të huaja. “Gjuha jonë, - porosit Naimi, - duhetë shkruarë fjeshtë shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë.”³⁶ Në kohën e Rilindjes lufta për mënjanimin e turqizmeve nga shqipja letrare ishte pjesë e luftës për pavarësi, për shkëputje nga Perandoria Osmane. Rilindësit deshën të tregonin dhe treguan se shqiptarët janë një popull më vete, që mund dhe duhet të kenë shtetin e tyre, kulturën e tyre kombëtare, të shprehur përmes gjuhës shqipe.

Ndryshe nga letërsia romantike e Rilindjes, autorët e letërsisë realiste, që u zhvillua më pas, nuk u treguan aq të rreptë ndaj orientalizmeve. Te *Fjalori* i Tahir Dizdarit shembujt e nxjerrë nga veprat e Gjergj Fishtës dhe nga përkthimet e Fan S. Nolit janë me dhjetëra. S’ka dyshim që veprimi i rilindësve ishte i dobishëm e i mbarë për letërsinë shqipe dhe për gjuhën tonë letrare në përgjithësi. Orientimi kulturor i Rilindjes drejt qytetërimit të përparuar evropian bëri që një varg orientalizmesh e greqizmesh të mënjanoheshin nga gjuha e shkrimit; kështu p.sh. *qitapi* dhe *vivlla* përfundimisht ia lanë vendin *librit*.³⁷

- Letërsia e pavarësisë. Mendimi i shkrimtarëve shqiptarë për orientalizmat në këtë periudhë paksa u zbut. Faik Konica mendonte që të mos zëvendësoheshin turqizmat e fushës së administratës që i njihte gjithë populli, ngase në këtë fushë nuk ka mbetur asgjë nga terminologjia e vjetër. F. Konica në një artikull në “Dielli” (16 shtator 1922) u kujtonte shqiptarëve se spanjollët gjykatësit i thonë *Alcade* nga arabishtja *el kadi* dhe se në spanjishte ka qindra fjalë të fushës së administratës me burim nga arabishtja.³⁸ Konica ishte një gjuhëtar i mprehtë, e dinte se gjuhët patjetër e kishin të huazonin nga njëra-tjetra, megjithatë, ai përsëri mendonte se gjuha duhet të pastrohet

³⁵ Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare* (Shkup, Logos-A, 2000), vëll.I. f. 233.

³⁶ “Iliadhë e Omirit, Këngë e parë”, kthyerë prej Naim Frashërit (Bukuresht, 1896), f. 13.

³⁷ Emil Lefe, “Orientalizmat si verb poetik te Sadiu shqip” në: Perla XII 1-44 (Tiranë, fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2007), f. 35.

³⁸ Faik Konica, *Vepra* (Tiranë, 2001) vëll. 3, f. 237.

nga huazimet e tepërta dhe të panevojshme (në veçanti, nga orientalizmat) për të cilat kemi gjegjëset e gjuhës sonë, prandaj ai shprehej kështu: “*Gjuha të jetë e qëruar: pa ato fjalë që na i kanë mbjellë magjitë e të huajve*”;³⁹

- Letërsia e realizmit socialist. Të gjitha qëndrimet e asaj periudhe janë të njëjta, “të flakim gjithçka që është orientale”. Të paktën kështu u paraqitën, ndoshta, sepse mendimi ndryshe ishte i kufizuar, për të mos thënë i ndaluar, ose sepse Lindja përthithte shumë parime islame. Pamundësia për ta njohur mendimin e shkrintarit në lidhje me këtë lëmë bëri që të mos paraqitet asnjë qëndrim i tyre.

Në një fjalë të urtë populli thotë: “Sa më shumë që ta frysh prushin për ta shuar, aq më shumë ai ndizet”. Edhe pse periudha komuniste ishte koha kur më shumë se çdoherë luftoheshin orientalizmat, pikërisht në atë kohë studiuesi më i dalluar i fjalëve orientale Tahir Dizdari e përpiloi fjalorin e orientalizmave në gjuhën shqipe, vepër që vështirë se vjen ndonjëherë.

Jo çdoherë pastrimi i gjuhës shqipe nga orientalizmat ka qenë i qëlluar, sepse ndonjëherë ato janë hequr edhe me pa të drejtë. Vendimi që mori sistemi monist shqiptar ndaj botëkuptimit fetar, me theks të veçantë ndaj atij Islam, nuk e la pa e dëmtuar edhe leksikun e gjuhës shqipe. Fillimisht, i bëri Shqipërisë një shkëputje të tërësishme nga Lindja. Pastaj, në Kongresin e Drejtshkrimit (1972), shumë lejoi që të merret si bazë leksiku i toskëve, i cili ishte i shumë më i pasur me orientalizma se ai i toskëve. Edhe ato orientalizma që u shënuan në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” nuk u theksuan me semantikën e tyre të duhur, por ajo bëhej sipas bindjes marksiste-leniniste. Këtë e vërteton fakti se pas shpalljes së lirisë së besimit me kushtetutë, një pjesë e orientalizmave e sferës së fesë në këtë vepër janë riaktivizuar e janë rigjallëruar me të drejtë, ashtu siç janë përdorur edhe më parë ose ashtu siç përdoren edhe në gjuhët tjera, për të shënuar sende e dukuri të besimit islam; prandaj, ato janë pasqyruar e përkufizuar në Fjalorin e ripunuar të shqipes së sotme (2002) pa asnjë ngjyrim e shpjegim plotësues, jo ashtu siç ishte vepruar në “Fjalorin e shqipes së sotme” (1980-84), ku për fjalë të tilla si *myderiz*, *myezin*, *Allah*, *hoxhë*, *myfti* etj. hartuesit kanë qenë të detyruar të shtojnë në kllapa formulimin “në vendet ku vepron feja muslimane” ose “në të kaluarën edhe në

³⁹ Jup Kastrati, *Faik Konica – Monografi* (New York, Gjonlekaj Publishing Company, 1995), f. 20.

Shqipëri”.⁴⁰ Një shpjegim i duhur i profesionalizmave fetare dhe i disa orientalizmave ende vazhdon të jetë jo mirë i shpjeguar dhe i trajtuar në fjalorët e paskomunizmit të gjuhës shqipe.

5.2. Pastrimi i tërësishëm, shkatërrim i gjuhës

Në krerët e mëparshëm theksuam se çdo gjuhë në botë është e lidhur me gjuhët tjera, edhe atë për shkaqe të ndryshme. Duke pasur parasysh këtë të vërtetë, kuptohet se pastrimi i tërësishëm i cilësdo gjuhë qoftë nga huazimet është një veprim i pavend dhe i parealizueshëm. Me fjalë të tjera, duhet bërë një vështrim historik, nëpërmjet të cilit mund të nxjerrim si përfundim se qëndrimi ndaj fjalëve me burim të huaj nuk mund të jetë i njëjtë.⁴¹ Për një veprim të tillë shumë bukur shprehet leksikologu më i dalluar i gjuhës shqipe, profesor Eqrem Çabej, i cili ndër të tjera thotë: “Një ndër parimet kryesore të zëvendësimit të fjalëve të huaja do të jetë matura. Nuk duhet aty të kalohet në ekstrem. Ka rasa – kryesisht në punime të specializuara – ku përdorimi i një fjale a termi të huaj paraqitet i domosdoshëm: aty për hir të saktësisë shkencore, të stilit, a për një tjetër arsye, do të përdoret.”⁴² Pra, edhe zëvendësimi i një fjale të huaj me gurrën shqipe gjithnjë duhet të bëhet mbi këto rregulla dhe parime.

Në vazhdim do të shohim disa lidhje të gjuhës shqipe me orientalizmat dhe arsyet që na e bëjnë të pamundur flakjen e tërësishme të huazimeve orientale:

- *Dëmtim i drejtpërdrejtë i gjuhës.* Orientalizmat zënë vend në gjuhën shqipe që në dokumentet e para të saj, p.sh. në fjalorin e Arnold fon Harffit, i cili e përdor fjalën *këmishë*, pastaj edhe në veprat e shkrimtarëve të parë shqiptarë. Pra, një tentim për çrrënjosjen e tërësishme të orientalizmave nënkupton dëmtimin e drejtpërdrejtë të gjuhës, sepse ato janë të vjetra aq sa është edhe gjuha jonë e shkruar. Tentimi për t'i ndryshuar faktet e para të ekzistencës, do të thotë përpjekje për të ndryshuar identitetin e përgjithshëm të gjuhës, ani që nuk ka pasur ndonjë periudhë që në shqipen e shkruar aspak të mos jenë përdorur huazimet orientale, të paktën aq sa është dokumentuar.

⁴⁰ Miço Samara, “Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe – Parathënie” (Tiranë, AICT 2005), f. vii.

⁴¹ Gjovalin Shkurtaj, *Kahë dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe* (Tiranë, Kristalina-KH, 2003), f. 127.

⁴² Eqrem Çabej, “Për pastërtinë e gjuhës”, në: *Gjuha shqipe III* (Prishtinë, 1984), f. 11.

- *Varfërim i traditës dhe i letërsisë gojore.* Tendanca për eliminimin e orientalizmeve nga gjuha shqipe bën që gjeneratat e reja të ndjehen të huaja dhe të mos e kuptojnë thesarin popullor që ka pasur populli shqiptar. Si do të kuptoheshin këngët lirike dhe epike nëse nuk do të njiheshin mirë huazimet orientale?! Edhe pse gjuha standarde ka bërë një pastrim të konsiderueshëm të orientalizmeve, në popull dhe në të folmet krahinore elementi oriental ende është i bollshëm. Gjithashtu, të mos harrojmë se një pjesë e konsiderueshme e letërsisë gojore edhe sot e gjithë ditën fillin e vet e ka në periudhën kur shqiptarët përdornin më shumë orientalizma, në Perandorinë Osmane. Një pjesë e mirë e tyre, veçanërisht kënga epike shqipe, është e ndërtuar mbi themelet e kundërshtimit të Portës së Lartë, mirëpo kjo nuk bëri që prania e huazimeve orientale të jetë e reduktuar. P.sh.

“*Mamut Pasha në at Deshat*

Na ka çitun një *bidat*

Mledh *milet e ustallarë*

Thëjri *teqe e agallarë*

Jeniçerë ene spahillarë

Sazexhi ene kajkatarë”.⁴³

- *Vështirësi për të kuptuar fenë islame nga muslimanët.* Nëse do të zbatohet mendimi i atyre që dëshirojnë ta pastrojnë gjuhën shqipe tërësisht nga orientalizmat ose siç tentojnë disa hoxhallarë që çdo termi fetar t’i gjejnë barasvlerën e tij në shqip, atëherë shqiptarëve muslimanë do t’u vështirësohej kuptimi esencial i porosisë hyjnore, pos në rastet që fjala e barasvlefshme shqipe e mbulon tërësisht atë orientale. Si do ta kuptonim *namazin, haxhin, zeqatin, sadakanë, rahmetin, bereqetin, selametin, xhenetin, kiametin, tabutin*⁴⁴, *sexhden, reqatin, tavafin, kalifatin* etj. nëse nuk i përdorim këta terma, në kohën kur secili prej tyre ka një definicion të gjerë?! P.sh. si do ta zëvendësoje fjalën *xhuma* në fjalinë në vazhdim: “*O bir, eja të falim namazin e xhumasë!*” Në këtë rast nuk mund të zëvendësohet fjala *xhuma* me fjalën e premtje, sepse *e premtja* është shumë më e përgjithshme, pra, nëse do të

⁴³ Petrit Fetahu, *Epika historike dibrane* (Dibër, 2004), f. 82.

⁴⁴ Nuk është *arkivol*, sepse fjala *tabut* përdoret për arkivolin e hapur. Pastaj, edhe fjala *arkivol* nuk është shqip.

thuhej: “O bir, eja të falim namazin e së premtes!” , do të ishte e paqartë, sepse e *premtja* nuk përfshin vetëm një namaz, por janë pesë, ashtu siç janë për çdo ditë. Ose, p.sh. shprehja *zeqat*, si do të zëvendësohej në fjalinë në vazhdim: “*Zeqati është një nga pesë shtyllat e fesë islame.*” Nëse në fjalinë që theksuam fjalën *zeqat* do ta zëvendësonim me fjalën *lëmoshë*, do të shkaktohej një gabim dhe largim nga kuptimi themelor që ka në mësimet islame, sepse *lëmosha* (sadakaja) përfshin dhënien vullnetare dhe vend-dhënien e papërcaktuar të saj, kurse *zeqati* ka të bëjë me “*pastrim të caktuar të pasurisë (dhënie) kur plotësohet sasia e paracaktuar dhe me destinacion të caktuar nga Krijuesi.*” Të kësaj natyre janë të gjitha termat e fushës së islamistikës, të cilat edhe mund t’i kategorizojmë në *orientalizma profesionalë*.

- *Humbje të vlerave stilistike.* Pra, në gjuhën shqipe kemi një varg orientalizmesh me vlera stilistike, që përbëjnë një pasuri mjetesh shprehëse për shkrimtarët dhe përkthyesit. Për funksionin stilistik të këtyre fjalëve në poezinë shqipe prej kohësh vëmendjen e ka tërhequr albanologia ruse A. V. Desnickaja në një artikull të botuar në vitin 1963. Ajo kishte vënë re se orientalizmat ndesheshin pak ose aspak në poezinë shqipe të atëhershme (ka parasysh poetët si Llazar Siliqi, Mark Gurakuqi, Ismail Kadare), por disa përkthyes të njohur si Lasgush Poradeci e Skënder Luarasi i kanë përdorur me guxim turqizmat si mjete stilistike ose metrike.⁴⁵ Në vijim do t’u hedhim një vështrim disa krijimeve letrare, në të cilat orientalizmat kanë zënë vend të rëndësishëm në shprehjen dhe pasqyrimin e asaj që ka dashur shkrimtari.

Po të largoheshin orientalizmat, do të varfërohej letërsia dhe stilistika shqipe. Si do të kuptoheshin poezitë satirike të Fan Nolit pa i njohur orientalizmat me të cilat shprehet satirizmi në poezinë e tij?! P.sh. te “Kënga e Salep-Sulltanit”:

Një *mexhli* të math na çeli

Pandeli Jano Vangjeli

Me *Sulltan-llokum* na veli

Si kofini pas të vjeli.

Se ç’ u çporr *xhumhurieti*,

⁴⁵ Emil Lafe, “Orientalizmat si verb poetik te Sadiu shqip” në: Perla XII 1-44 (Tiranë, fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2007), f. 36.

Se ç'u *rahatos mileti*,
Se *Sulltanin* prap' e gjeti,
Se, qëkur e humbi, s'fjeti!

Pasurimi i veprës së Faik Konicës “Doktor Gjilpëra” me orientalizma, bën që kjo vepër të jetë e dalluar, sepse përmes leksikut dhe onomastikës së huazuar orientale shprehet një art i vërtetë satirik dhe humoristik. Sa për ilustrim do të përmendim patronimet dhe llogaret orientale që pa përdorur Faik Konica në veprën “Doktor Gjilpëra”, me të cilat ka pasuruar satirizmin e veprës së vet. P.sh.: *Salembosa* (ministri i Punëve të Brendshme; emri i tij, një kompozitë nga Salep-Boza, përfaqëson Ahmet Zogun); *Ibn-el-Kelb - Ibni Qelbi* (agjenti nr. 5 i sektorit të kamorrës,⁴⁶ nga vetë emri i të cilit nënkuptohet dredhia famëkeqe, sepse në gjuhën shqipe fjala *Ibn-Kelb* do të thotë “biri i qenit”, pastaj prej kësaj vjen edhe fjala *qelb*; *Abyl Katili* (ku fjala *Abdyl*, një patronim oriental, cilësohet me mbiemrin *Katil* – vrasës, e cila gjithashtu është fjalë arabe) etj.

Stilet artistike dhe letrare të shkrimtarëve shqiptarë, shpeshherë, janë të lidhura ngushtë me shprehje orientale, të cilat nuk ka si i thua ndryshe, jo se nuk ka fjalë gjegjëse në gjuhën tonë, por ngase i humbet kuptimi dhe nuk bëhet forma stilistike e dëshiruar, p.sh. *katil* përkthehet “vrasës”, mirëpo me këtë nuk e kemi përfshirë tërësisht atë që kuptojnë shqiptarët me atë fjalë, sepse ajo ka një semantikë më të gjerë në popull. *Katil* është vrasësi, ai që vret dikë në mënyrë mizore, vrasës i pamëshirshëm, kriminel; ai që nuk ngopet duke e munduar dikë, duke i bërë keq dikujt;⁴⁷ ai që nuk ndjehet keq kur shikon ndonjë krim, etj.

Ato janë përmendur në kontekste të veçanta ose në përbërje të njësive frazeologjike për diferencime në stil, për të bërë shaka ose humor, si p.sh. *kasap* (për “kirurg i paaftë”), *allishverish* (për “marrëveshje e fshehtë e interesa të ngushta fitimi”), *s'gjej karar a derman* (në opozicion stilistik me “nuk gjej qetësinë e duhur”)⁴⁸ etj.

⁴⁶ J.Kastrati, vep. e cit. f. 373.

⁴⁷ A.Kostallari dhe të tjerë, vep. e cit. f. 800.

⁴⁸ Miço Samara, “Fjalori i orientalizmeve në gjuhën shqipe – Parathënie” (Tiranë, AIICT, 2005), f. vii.

Me këtë shtjellim të deritanishëm që realizuam nuk do të thotë se ne duhet ta mbushim gjuhën shqipe plot orientalizma dhe të bëjmë një gjuhë orientale, jo, ne duam që aty ku shqipja humb diçka me largimin e orientalizmave, ato t'i mbajë, por aty ku fjala gjegjëse e gjuhës shqipe është e pranishme dhe e zëvendëson fjalën orientale në të gjitha pozicionet e saj, atëherë të mbetet fjala e gurrës shqipe. Shkurt thënë, të mos hiqemi si orientale ose oksidentale duke e dëmtuar gjuhën shqipe, siç veprojnë sot shumë shqipfolës tanë nga ata të radhës së shkollës, që e heqin veten si përmbi intelektualë, për t'u dukur si më të përparuar e më të moderuar, ngarendin të krijojnë fjalë e fjali sipas gjedhave e kallëpeve të huaja, të cilat dukën e kanë kukull (shqipe), por brendinë (sintaksën) e kanë sukull (të huaj).⁴⁹

Së fundi, as të mos heqim, por as të mos marrim, atë që na prish dëlirësinë e gjuhës sonë. Një popull mund të ketë një qytetërim të mirëfilltë vetëm nëse zhvillon një gjuhë të bukur burimore të vet, siç thotë Lajbnici: “m’epni gjuhë të bukurë, t’u jap qytetëri të mbaruarë”.⁵⁰

⁴⁹ Qemal Murati, *Për shqipen standarde* (Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2009), f. 108.

⁵⁰ Jorgo Bullo, *Magjia dhe magjistarët e fjalës* (Tiranë, Dituria, 1998), f. 17.

6. ORIENTALIZMAT DHE SHTRIRJA E TYRE NË SFERAT E GJUHËSISË

Për të kuptuar ndikimin e një gjuhe në tjetrën shumë me rëndësi është të dihet fusha apo sfera gjuhësore ku është bërë ndikimi. Kriteri i parë i vlerësimit të ndikimit të një gjuhe në tjetrën do të ishte njohja e fushës gramatikore në të cilën është ndikuar, pastaj sasia e ndikimit.

6.1. Elementi oriental në sistemin gramatikor të shqipes

Në një masë shumë të vogël, megjithatë i pranishëm, është edhe ndikimi i elementeve orientale në strukturën gramatikore të gjuhës shqipe.

Nëse ndikimi është në sintaksë, morfologji etj., atëherë bëhet fjalë për ndikim të drejtpërdrejtë në strukturën dhe shtyllën e gjuhës, e kjo është shumë më vështirë të evitohet, prandaj rëndësi të madhe ka fusha e ndikimit. Vështirë është të hiqen qafe prapashtesat fjalëformuese që burojnë nga gjuhët orientale, p.sh. *-llëk: njerëzillëk, dynjallëk, fodullëk, gomarllëk, rahatllëk; -(l)li: vendali, pareli, sheherli; - xhi: vorraxhi, samarxhi, plehraxhi, hekuraxhi>hekraxhi, sharraxhi; -oll* (zakonisht përdoret te patronimet): *Agolli nga Agaj, Basholli nga Basha, Begolli nga Begu, Musolli nga Musa, etj.*

Një kohë të gjatë u përpoqën shumë puristë që elementi oriental të mos ekzistonte aspak në gjuhën shqipe, por kjo nuk qëndroi si e tillë. Pastaj, edhe sot e kësaj dite ka tendenca që shqipja të pastrohet tërësisht prej elementit oriental, por kjo është e pamundur, sepse ndikimi oriental është i pranishëm edhe në strukturën e gjuhës.

Këto prapashtesa fjalëformuese janë pjesë e pandarë e morfologjisë së shqipes, sepse ato nuk përdoren vetëm me rrënjë orientale, por edhe me fjalët që kanë rrënjën e pastër shqipe. Me theks të veçantë janë të pranishme në të folmet krahinore gege, p.sh. *shakaxhi, magarllëk, zorraxhi, plehraxhi* etj.

Ky ndikim nuk është i pranishëm vetëm në gjuhën shqipe, por në të gjitha gjuhët ballkanike. Pra, edhe pse gjuha shqipe nuk është e të njëjtës familje me gjuhët tjera

ballkanike, ajo ka të përbashkët vetëm huazimet morfologjike dhe sintaksore orientale me to.

6.2. Elementi oriental në leksikun e shqipes

Fusha më e gjerë ku mund të ndikojë një gjuhë në tjetrën është leksiku. Nëse ndikimi është në leksik, atëherë fjalëve të huaja shumë më lehtë mund t'u gjendet një sinonim i tyre dhe me kalimin e kohës fjala e huazuar zhduket. Nuk qe shumë e vështirë që disa fjalë orientale t'i zëvendësojmë me fjalët e barasvlershme në gjuhën shqipe, p.sh.: *afërim* > *të lumtë*; *aksham* > *mbrëmje*; *alet* > *vegël*, *mjet pune*; *ballgam* > *këlbazë*; *belqim* > *mbase*, *ndoshta*; *bitis* > *përfundon*; *dushman* > *armik*; *erz* > *nder*; *esmer* > *zeshkan*; *fukarallëk* > *vobektësi*, *skamje*; *gjezdis* > *shëtis*; *gjyzlyk* > *syze*; *haber* > *lajm*; *karshi* > *përballë*; *sebeq* > *shkak*; *bela* > *fatkeqësi*, *problem* etj.⁵¹

Ndikimi i një gjuhe në tjetrën mund të shprehet në leksik, në sintaksë, në fonologji dhe në morfologji. Leksiku është pjesë e gjuhës që pranon dhe përfaqon shumë më lehtë se elementet e tjera gjuhësore,⁵² prandaj gjuha shqipe huazimet më të dendura i kishte, dhe i ka, në leksikun e saj.

“Ndikimi më i thjeshtë që pëson një gjuhë, shprehet me huazimin e fjalëve; kur sjellim cilësi kulturore prej një gjuhe në një tjetër, ekzistojnë gjasat që fjalët që përcjellin këto cilësi të jenë të përngjitura.”⁵³

Në përgjithësi, ndikimi i gjuhëve të huaja në strukturën gramatikore të shqipes, siç është thënë me të drejtë nga studiues të ndryshëm që janë marrë me shqipen, ose është i barabartë me zero, ose ai ka prekur vetëm ndonjë element të veçantë të saj,⁵⁴ kurse elementi leksikor është bukur mirë i pranishëm, madje ai oriental i rrënjosur dhe shumë i theksuar, veçanërisht në të folmet krahinore dhe në folklor.

⁵¹ Shaqir Berani, Haxhi Birinxhiu, *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj* (Prishtinë, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Sociale Autonome të Kosovës, 1989).

⁵² Uriel Weinreich, *Languages in contact* (New York, Publications of the Linguistic Circle of New York, 1953), f. 44.

⁵³ E.Sapir, vep. e cit. f. 190.

⁵⁴ Enver Hysa, “Elemente turke në strukturën e fjalës në gjuhën shqipe”, në: *Studime filologjike 3-4*. (Tiranë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1998), f. 150.

Pra, ashtu siç është më lehtë zhdukja e fjalëve që merren nga një gjuhë tjetër, ashtu është lehtë edhe depërtimi i tyre.

Tani do të ndalemi më konkretisht të shohim ndikimin e gjuhëve orientale në gjuhën shqipe, si në atë të shkruar, ashtu edhe në trashëgiminë popullore.

Nuk ka dyshim se studiuesi më i dalluar dhe më i denjë i etimologjisë së fjalës shqipe është i ndjeri profesor Eqrem Çabej, mirëpo kur janë në pyetje orientalizmat, “Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe” i Tahir Dizdarit mbetet libri bazë, të cilit duhet t’i kthehet çdo studiues i kësaj fushe.

Tahir Dizdari në fjalorin e vet ka përfshirë afërsisht 4.406 orientalizma, prej të cilave rreth 1.500 janë arabizma, rreth 500 persizma dhe rreth 1.700 turqizma. I përmenda këto të dhëna që të kemi një pasqyrë të përgjithshme për numrin e orientalizmave në gjuhën shqipe. Kjo nuk mbetet shifra përfundimtare, sepse nga studimet e mëvonshme del që numri i orientalizmave është rritur.

Për dukurinë e persizmave një fjalor të ri ka përgatitur leksikologu Emil Lafe, ku ka përfshirë 600 rrënjë fjalësh me prejardhje perse. Ndërkaq, fjalë të prejardhura, që mund të nxirren nga këto 600 fjalë rrënjësore, dalin afërsisht 2.000 (si p.sh. *pambuk*, *i pambuktë*, *pambukje*, *pambukor* etj.).⁵⁵

Arabizmat, njësoj si persizmat, kanë një shtrirje më të madhe në gjuhën shqipe. Në studimet e mia personale që kam bërë deri tani kam hasur se ka edhe një numër të mirë fjalësh me prejardhje arabe, të cilat nuk janë evidentuar në fjalorin e Tahir Dizdarit. Sipas asaj që kam tubuar deri tani, numri i arabizmave në gjuhën shqipe, bashkë me arabizmat e T. Dizdarit, mbërrin në rreth 1.700 fjalë rrënjësore, ndërkaq nëse llogariten edhe fjalët e prejardhura, nuk janë më pak se 3.000. Në vazhdim do të paraqesim disa arabizma që nuk janë në fjalorin e Tahir Dizdarit, p.sh.: *istima*, *makhurë*, *meta*, *ehlulvera*, *ehludynja*, *tefvid*, *firag*, *arif*, *teshrif*, *irth*, *xhebel*, *kevnejn*, *ta’lim*, *te’lif* etj. Këto janë vetëm disa arabizma që i kam shkëputur nga *Divani* i Nezim Frakullës, por që nuk janë në fjalorin e Tahir Dizdarit. Një pjesë e arabizmave, veçanërisht në letërsinë e bejtexhinjve, janë përdorur me të madhe dhe më nuk janë dukur në gjuhën shqipe. Megjithatë, kemi edhe

⁵⁵ Naim Zoto, “Persizmat në gjuhën shqipe në një fjalor të ri – intervistë me prof. Emil Lafe” në: Perla XIV 3-54 (Tiranë, fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2009), f. 11.

arabizma të cilat në disa krahina dhe në disa të folme shqipe kanë një shtrirje shumë të madhe e që ai nuk ka mbërritur që t'i shënonte.

Situata pothuajse është e njëjtë edhe me turqizmat: numri i tyre arrin në rreth 2.000 fjalë rrënjësore, ndërsa fjalët e prejardhura kalojnë shifrën 3.500.

Sipas Nahtigalit e Oshtirit, leksiku i shqipes përmban 22 % elemente prej turqishtes.⁵⁶

Orientalizmat që kanë pasur dyndje më të madhe në periudhën e bejtexhinjve, disa prej të cilave nuk janë përpunuar ende sot e kësaj dite, më gjerësisht do t'i trajtojmë në një kapitull të veçantë.

6.3. Cila pjesë e ligjëratës u prek më shumë?!

Megjithatë, edhe elementet leksikore nuk janë të një natyre: nga punimet e deritanishme del qartë se në gjuhën shqipe nëpërmjet turqishtes më fort kanë depërtuar fjalë emra dhe më pak mbiemra, folje dhe pjesë të pandryshueshme të ligjëratës. Një gjë e këtillë nuk është e papritur, sepse është e natyrshme që nëpërmjet kontakteve të përditshme folësit e një gjuhe të huazojnë nga gjuhë të tjera, në radhë të parë fjalë që emërtojnë sende konkrete dhe më pak fjalë që emërtojnë sende abstrakte, cilësi, veprime etj.⁵⁷ Kjo pastaj ka ndikuar që, një pjesë e tyre, shpejt të dalin prej gjuhës shqipe.

Çdoherë ajo që është abstrakte është më e vështirë për t'u imponuar, por edhe më vështirë për t'u larguar. Edhe fëmija në fillim të jetës së vet, fillimisht, mëson emra, sepse ato janë më të lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u mbajtur mend, kurse folja dhe pjesët tjera të ligjëratës janë të ngarkuara me kuptime, ose janë të varura prej fjalëve të tjera.

Këtu pamë se sa dhe ku ndikuan gjuhët orientale në gjuhën shqipe. Ato nuk patën fatin të ndikonin në sistemin foljor të shqipes, përveç pak, sepse folja është elementi më i qëndrueshëm në çdo gjuhë, aq më shumë kur e dimë se gjuhët orientale janë më shumë gjuhë foljore.

⁵⁶ E.Çabej, vep. e cit. f. 113.

⁵⁷ Shefkije Islamaj, "Rreth 'Fjalorit të orientalizmeve në gjuhën shqipe' të Tahir Dizdarit", në: Gjuha Jonë XXVI 1-4 (Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006), f. 185.

6.3. Një pasqyrë e orientalizmave nëpër fjalorë

Gjuha është njësia parësore me të cilën njerëzit i shprehin dëshirat, pëlqimet, hidhërimet, kundërshtimet etj. Jetëgjatësia e gjuhës, zakonisht, është e lidhur me dukurinë se sa ajo gjuhë është e shkruar. Sa më shumë që të shkruhet një gjuhë, aq më gjatë do të jetojë, sepse shumë vështirë është që të hiqet qafe realiteti i shkruar.

Më të thella dhe më të shëndosha i ka rrënjët një gjuhë që ka përpiluar edhe fjalorët e vet, andaj kur fjalët e një gjuhe janë tubuar në fjalor, gjuha është e konsoliduar. Sa më i pasur të jetë fjalori (leksiku) i një gjuhe, aq më i qëndrueshëm do të jetë edhe uniteti i asaj gjuhe.

Kur themi se një gjuhë ka dorë në leksikun e gjuhës tjetër, atëherë nënkuptojmë që kultura dhe qytetërimi i atyre popujve kanë pasur (ose kanë) të përbashkët diçka, gjë që nuk është objekt i studimit tonë. Ajo që do t'i kushtojmë rëndësi në këtë shtjellim është prania e elementit oriental në leksikografinë shqipe, sa huazimet orientale kanë zënë vend nëpër fjalorët e shqipes, qofshin ata njëgjuhësorë, dygjuhësorë etj.

- (XV) Fjalori, në të vërtetë fjalorthi më i vjetër i gjuhës shqipe është ai i Arnold fon Harffit, i cili edhe pse nuk është fjalor nga ata të konsoliduarit mirë (sepse, janë vetëm disa fjalë), ai përsëri zë një vend të rëndësishëm në leksikografinë e gjuhës shqipe. Huazimi oriental më i vjetër në leksikografinë e gjuhës shqipe është fjala *këmishë*, të cilën udhëpërshkruesi gjerman e paraqiti në mesin e fjalëve shqipe që kishte dëgjuar gjatë kthimit të tij nga Toka e Shenjtë në vitin 1497⁵⁸ dhe me këtë u mbyll shekulli XV.
- (XVI) Në shekullin XVI nuk është evidentuar që të jetë përpiluar ndonjë fjalor, megjithatë veprat e natyrave të ndryshme që janë shkruar tregojnë se orientalizmat kanë qenë të pranishme, p.sh. në veprën “Meshari” të Gjon Buzikut, të kryer në vitin 1555, gjejmë rreth 5 orientalizma, dhe atë: *haram*, *kallauz*, *dollamë*, *tekë* dhe *tepsi*.⁵⁹
- (XVII) Fjalori më i vjetër, i vitit 1635, “Fjalori latinisht-shqip” i Frang Bardhit, përmban 73 orientalizma; në vitin 1678 Leo Cittadela në fjalorin e tij “Fjalor shqip”

⁵⁸ Dhimitër Shuteriqi dhe të tjerë, *Historia e letërsisë shqipe I-II* (Prishtinë, Universiteti i Prishtinës), f. 124.

⁵⁹ Mustafa Ibrahim, *Interpretime dhe studime gjuhësore* (Shkup, Pakung, 2003), f. 135.

nuk përmend orientalizma; Juli Balovi në fjalorin e tij të vitit 1693 “Fjalor italisht-kroatisht-greqisht-shqip-turqisht” shënon 77 orientalizma;

- (XVIII) Në vitin 1702, Francesco Maria në fjalorin e tij “Fjalor italisht-shqip” shkruan 350 orientalizma; gjithashtu, në vitin 1710 evidentohet një fjalor anonim, i cili nga 929 fjalë, 19 ka orientalizma; në “Fjalorin italisht-shqip” të vitit 1716, të Bonaventura Prucher, janë hetuar shumë orientalizma; Nezim Frakulla në vitin 1760, në librin “Fjalorth shqip-turqisht”, ka shënuar 7 persizma nga 78 fjalët e theksuara; Teodor Kavalioti në vitet 1770-1774 ka shkruar fjalorin greqisht-arumanisht-shqip-latinisht, ku jepen 27 turqizma dhe 7 persizma; në vitin 1789 Simon Pallas ka përpiluar fjalorin e quajtur “Fjalor i Perandoreshës Katerina”, ku në mesin e 270 fjalëve theksohet edhe një numër i konsiderueshëm i orientalizmeve; në fundin e shekullit XVIII Myslim Hoxha përktheu në shqip veprën “Tuhfe-i-Shahidi”, ku bëri një fjalor të mirë, në të cilin kishte shumë orientalizma; gjithashtu, edhe Konstadin Berati përpiloi një fjalor greqisht-shqip, ku në mesin e 1.533 fjalëve përmendi shumë orientalizma;⁶⁰
- (XIX) Në vitin 1802 Zani Adam Haxhi Voskopojari shkroi veprën “Fjalor greqishte e re-armenisht-bullgarisht-shqip”, ku përmend një numër të konsiderueshëm orientalizmesh; pas shtatë vjetëve Mark Boçari e Not Boçari dhe Kristaq Kallogjiri shkruan veprën “Fjalor i greqishtes së re dhe i shqipes së thjeshtë”, ku ndër 1.494 fjalët që kanë tubuar 187 janë orientalizma; në vitin 1862 Giulio Buffoli përpiloi fjalorin italisht-shqip, ku theksoi një numër të mirëfilltë orientalizmesh; Georg von Hann në vitet 1853-1854 shkroi fjalorin gjermanisht-shqip, i cili në mesin e 6.216 fjalëve 140 i nxori huazime turke dhe perse; në vitin 1875 Francesco Rossi shkruan fjalorin shqip-italisht prej 25.000 fjalëve, prej të cilave dhe shumë orientalizma; në vitin 1891 Gustav Mayer përpilon fjalorin e parë etimologjik të gjuhës shqipe, i cili ndër të tjera përmban 1.180 orientalizma, por disa i ka lënë të paidentifikuara⁶¹; Ali Ulqinaku në vitin 1899 përpiloi fjalorin turqisht-shqip dhe përmendi shumë

⁶⁰ Senad Mičijević, “Orientalizmi u rječnicima albanskog jezika” në: Zbornik radova – IV (Zenici, Pedagogskog Fakulteta u Zenici, 2006), f. 320-321.

⁶¹ E.Çabej, vep. e cit. f. 112.

orientalizma;⁶² është ky shekulli kur shqiptarët fillojnë të mendojnë për etimologjinë e fjalës shqipe. Në dallim prej shekujve të mëhershëm, ky shekull ishte shumë më i bollshëm në studimet etimologjike, sepse shqiptarët filluan të mendonin për kombin dhe gjuhën shqipe, me ç'rast dëshironin të dallonin fjalën shqipe nga fjalët e huazuara.

- (XX) Shoqëria “Bashkimi” në vitin 1908 botoi fjalorin “Fjalor i ri i shqypes”, i cili mbante 11.000 fjalë, prej të cilave 1.300 turqizma dhe persizma;⁶³

Në këtë shekull orientalisti i njohur Tahir Dizdari - hiq periudhën e keqe të komunizmit - arriti të nxirrte në dritë një fjalor madhështor, me një përfshirje të gjerë të orientalizmeve në gjuhën tonë, gjë që nuk ishte bërë deri atëherë. Ai në fjalorin e tij trajton afërsisht 4.406 fjalë, kronologjinë dhe shtrirjen e mundshme semantike nëpër krahinat dhe të folmet e ndryshme ku ka shqiptarë. Si e tillë, kjo vepër është konsultuar edhe për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980).⁶⁴

Kur jemi në këtë shekull, ia vlen të tregojmë edhe një pasqyrë të shtrirjes së orientalizmeve në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”. Në botimin e vitit 1954 janë 1.455 orientalizma, përkatësisht 5.8 % e glosarit të përgjithshëm, kurse në botimin e vitit 1980 ato arrijnë në 2.027 dhe zënë 4.9 % të glosarit të përgjithshëm.⁶⁵

Këto janë orientalizmat e evidentuar nëpër fjalorët e ndryshëm të gjuhës shqipe, qofshin njëgjuhësor, dygjuhësorë ose edhe më shumë. Edhe pse fjalorët dhe gjuha e shkruar ka bërë një reduktim të fjalëve të gurrës orientale, ajo ende është shumë e theksuar në mesin e popullit, veçanërisht te gegët. Sot orientalizmat kanë një shtrirje më të madhe të folmet e shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë.

Orientalizmat strofullën dhe jetëgjatësinë më të madhe çdoherë e kanë pasur në mesin e popullit, jo në gjuhën e shkruar. Studiuesi i njohur Androkli Kostallari thotë se pjesa më e madhe, rreth dy të tretat, e turqizmave (ka për qëllim orientalizmat) të huazuara nuk depërtoi asnjëherë në fondin e gjuhës sonë, ndërsa pjesa më e vogël e tyre

⁶² S.Mičijević, vep. e cit. f. 321-325.

⁶³ S.Mičijević, po aty. f. 325.

⁶⁴ Tahir Dizdari, *Fjalori i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, parathënie nga Miço Samara (Tiranë, AICT, 2005), f. v.

⁶⁵ M.Ibrahimi, vep. e cit. f. 137.

hyri më thellë në përdorimin popullor dhe zuri vend pak a shumë në sistemin leksikor të shqipes.⁶⁶

Koha në të cilën orientalizmat kishin shtrirje më të madhe në gjuhën e shkruar shqipe ishte ajo e bejtexhinjve. Në atë kohë pothuajse mbi 90 % e orientalizmave përdreshin në gjuhën e shkruar.

Është tjetër punë se a kanë qenë të rrënjosura mirë në fondin e gjuhës shqipe ose jo, apo siç mendojnë disa studiues se janë përdorur pa nevojë dhe me qëllime tendencioze. Për shtrirjen e orientalizmave në gjuhën shqipe në periudhën e bejtexhinjve do të ndalemi më gjerësisht në disa kapituj të tjerë.

Pavarësisht të gjithave, me rëndësi është të thuhet se orientalizmat kanë qenë të pranishëm gjatë gjithë historisë së leksikografisë së gjuhës shqipe, madje që në fillim të saj.

⁶⁶ Androkli Kostallari, “Rreth depërtimit të turqizimeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII”, në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III (Tiranë, 1989), f. 94.

7. ETAPAT NËPËR TË CILAT DEPËRTUAN ORIENTALIZMAT NË GJUHËN SHQIPE

Gjuha shqipe është një ndër gjuhët më të vjetra. Si e tillë, edhe kontaktet dhe huazimet me gjuhët tjera të vjetra duhet të jenë shumë të hershme. Përderisa një gjuhe nuk mund t'i gjendet filli, atëherë është shumë vështirë dhe shumë e gabuar të flitet për kohën fikse të depërtimit të huazimeve, ngase çdo gjuhë në fillësën e vet ka huazuar nga ndonjë simotër e saj. Asnjë gjuhë dhe qytetërim nuk është formuar nga asgjëja, por çdoherë është trashëguar prej asaj që ka qenë më parë. Kur është fjala për huazimet orientale, përafërsisht dihet koha kur ato kanë filluar të depërtojnë në gjuhën shqipe, sepse ato janë huazime që ndërlidhen me faktorë të veçantë dhe me raste historike.

Nëse do ta kishim ndarë në disa faza depërtimin e orientalizmave në gjuhën tonë, atëherë do të gjenim tri periudha: periudha paraosmane, periudha nën Perandorinë Osmane dhe periudha pas Perandorisë Osmane.⁶⁷

7.1. Periudha paraosmane

Historia e depërtimit të huazimeve orientale në gjuhën shqipe fillon shumë herët, madje edhe para se të dokumentohet gjuha jonë dhe para se Shqipëria të pushtohet nga Perandoria Osmane. Kjo e vërtetë argumentohet me dy fakte:

- në marrëveshjen e Skënderbeut me mbretin e Napolit, Alfonsin e Aragonës, në vitin 1451, është përdorur fjala *haraç*, që mendohet të jetë orientalizmi i parë në gjuhën shqipe.⁶⁸ Kjo marrëveshje është realizuar para “Formulës së pagëzimit – 1462”;

- Orientalizmi i parë në gjuhën shqipe i dokumentuar është fjala *këmishë*, të cilin e paraqet kalorësi, udhëtari dhe shkrintari gjerman Arnold fon Harff në fjalorthin e tij shqip-gjermanisht të vitit 1497, ku shënon dhjetëra fjalë shqipe, ndër to edhe huazimin

⁶⁷ Në kategorizimin e këtyre periudhave, si bosht kam marrë Perandorinë Osmane, sepse historia dhe fati i orientalizmave lidhet, pothuaj tërësisht, me qenien e kësaj perandorie.

⁶⁸ Emil Lafe, “Fondi i persizmave në shqipen e sotme dhe në zhvillimin historik të shqipes prej mesjetës e këndeje” në: Perla XIV 1-52 (Tiranë, fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2009), f. 38.

oriental *këmishë*.⁶⁹ Nëse kemi parasysh se edhe në njërin prej dokumenteve të para të gjuhës shqipe ekzistojnë orientalizma, atëherë apriori kuptohet se ato kanë qenë të pranishme edhe më herët.

Pra, dukuria e huazimeve orientale në gjuhën shqipe qenkësh aq e vjetër sa është edhe vetë gjuha e dokumentuar, madje edhe më herët. Që një fjalë të mbërrijë të jetë e shkruar në një gjuhë, do të thotë se ajo ka pasur një shtrirje të gjerë në gjuhën e folur të atij populli. Përderisa orientalizmat zënë vend në dokumentet e para shqipe (edhe pse ato figurojnë pas pushtimit osman), atëherë kuptohet që populli shqiptar i paska përdorur shumë më përpara se Shqipëria të pushtohej nga osmanlinjtë.

Marrëdhëniet tregtare shqiptaro-osmane mundësuan që gjuha jonë të huazojë, pjesërisht, terminologjinë e atij malli që merrej, sepse shteti osman në atë kohë ishte tepër i zhvilluar dhe ishte qendër në të cilën frekuentoheshin tregtitë botërore, duke pasur parasysh se edhe Persia e famshme dhe e qytetëruar ishte nën ombrellën e tyre. Krahas kësaj, shqiptarët përsëri dinin ta ruanin gjuhën e tyre, duke u përpjekur që huazimet të ishin sa më të pakëta. Pra, kjo (tregtia) ishte shtegu më i volitshëm për depërtimin e orientalizmave para se Shqipëria të pushtohej nga osmanët. Edhe pse më të hershme ishin huazimet arabe nga Sicilia, përsëri ato mbetën më të pakëta, sepse tregtia u bë shkak që orientalizmat të kishin një dyndje më të madhe në gjuhën tonë. Thënë shkurt, ato orientalizma që depërtuan para pushtimit osman, pjesa më e madhe e tyre, ose afro 90 %, depërtuan përmes tregtisë.

Huazimet si: *top, xhep, byrek, bakër, hallvë, bakllava, çorbë, rast* etj. janë rrënjësor tashmë në gjuhën letrare dhe kanë një kronologji qindvjeçare përdorimi në shqipe dhe përhapje të gjerë e të përgjithshme pothuaj në tërë truallin gjuhësor të shqipes, edhe në Kosovë e Maqedoni, madje ndonjë prej tyre edhe në gjuhë të Ballkanit. Ato janë bërë pjesë përbërëse e fondit të shqipes dhe asnjëherë nuk është shtruar, por as nuk mund të shtrohet për diskutim largimi apo zëvendësimi i tyre; ato datohen me shqipen, siç pohon edhe E.Çabej, “para nguljes së osmanëve në Shqipëri”.

Huazimet arabe që depërtuan përmes tregtisë atë kohë ishin pothuaj të padukshme në gjuhën tonë, sepse asokohe vetë gjuha osmane ishte gjuhë në ndërtim e sipër.

⁶⁹ Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare* (Tiranë, Dukagjini, 1997), f. 26.

Shkurthënë, ishte koha kur vetë osmanishtja pasurohej me arabizma. Kështu që, nuk ka si të huazonte shqipja arabizma nga osmanishtja, edhe pse pastaj numri më i madh i arabizmave hyn përmes gjuhës osmane.

Është realitet se arabizmat në atë kohë ishin shumë pak, por jo të paqenë, siç pohojnë disa studiues. Akademiku boshnjak Enes Kariq në një punim të vet thotë: “Ndikimi arabo-islam në Gadishullin Ballkanik mbërriti para çlirimeve osmane në Evropën Lindore, në (fillim) të shekullit XV. Nëpër disa muze të vendeve të Ballkanit sot gjejmë elemente historia e të cilave u kthehet kontakteve të para që patën popujt e Ballkanit me arabët e Sicilisë, me arabët e Italisë Jugore dhe me ata të Andaluzisë (Spanja e sotme). Prej enëve që sot i kemi nëpër muze, dhe që lidhen me atë kohë, kemi *ibrikun, tenxheren*, gjithashtu kemi edhe disa fjalë tjera, si p.sh.: *hendek, hallvë*, të cilat edhe sot e kësaj dite emërtohen kështu në vendet e Ballkanit.”⁷⁰

Prof. Enes Kariq për gazetën “Zëri arab” vazhdon: “Në shekullin XIV, në Ballkan, fjalët, terminologjitë, shprehjet, letërsia dhe librat arabë u përhapën me një shpejtësi të madhe...”⁷¹

Vlen të përmendet që një pjesë të fjalëve që dikush i konsideron persizma paraosmane, të cilat në të vërtetë nuk janë, janë fjalë të përbashkëta që i ka gjuha shqipe dhe persishtja i kanë të përbashkëta si fjalë të trashëguara nga fondi i lashtë indoevropian, sepse të dyja janë gjuhë të familjes indoevropiane. Këto fjalë, pra, nuk quhen persizma. Të tilla fjalë janë p.sh. shqip *ujk* (forma e vjetër *ulk*) – persishte e vjetër *vYrka* (persishte e sotme *gurg*); shqip *pesë* (forma e vjetër *pensë*) – persisht *panxh* (por emri *panxhë* “putra me pesë gishta e disa shtazëve” është persizëm, sepse ka hyrë në perandorinë osmane); po kështu numërorët *gjashtë, shtatë, tetë* – persisht *shesh, haft, hasht* etj.⁷² Këto dhe shumë fjalë të tjera nuk janë persizma paraosmane, por janë fjalë të përbashkëta të shqipes dhe të persishtes si dy gjuhë indoevropiane.

Ajo që vihet në dukje në këtë periudhë është se gjuha shqipe para pushtimit osman ka huazuar nga dy shtigje: përmes tregtisë, ku më shumë janë huazuar turqizma dhe

⁷⁰ Enes Karic, “The Arabic Cultural Influence on the Balkans: An Outline”, në: The American Journal of Islamic Social Sciences 20:1 (2003), f. 107.

⁷¹ E.Karic, vep. e cit. f. 108.

⁷² N. Zoto, vep. e cit. f. 13-14.

persizma (arabizma më pak) dhe përmes Sicilisë, nga ku huazuan më shumë arabizma, sepse asokohe Sicilia administrohej nga arabët dhe gjuhë zyrtare ishte arabishtja. Madje kjo e fundit është edhe më e hershme, sepse në vitin 878 Sicilia ra në duart e arabëve dhe prej këtij viti arabishtja ishte gjuhë zyrtare, kurse Perandoria Osmane u formua në vitin 1299.

Pas kësaj konstatojmë se orientalizmat më të hershëm janë arabizmat. Këtë e hetojmë në argumentet që i sollëm më parë, se edhe fjala *haraç*, edhe fjala *këmishë* janë arabizma. Të paktën kështu na flet gjuha e dokumentuar.

7.2. Periudha nën Perandorinë Osmane

Faza e dytë e depërtimit të orientalizmave, në masë më të madhe, ndodhi kur Shqipëria u pushtua nga Perandoria Osmane. Me depërtimin e Perandorisë Osmane në Shqipëri, kuptohet që fenomeni i huazimeve orientale u bë i pashmangshëm.

Hyrja e orientalizmave në gjuhën shqipe dhe karakteri i përgjithshëm i tyre janë të lidhura ngushtë me mënyrën e organizimit të Perandorisë Osmane dhe të qeverisjes së tokave që u përfshinë në kufijtë e saj. Sunduesit këtë radhë vinin nga një kontinent tjetër dhe sillnin një tjetër kulturë e një tjetër fe. Pushteti osman nuk pati si qëllim kolonizimin e trevave të pushtuara me një popullsi të re (siç kishin bërë p.sh. dikur romakët e më pas sllavët), por sundimin politik të tyre dhe përhapjen e besimit të ri islam, me qëllim që t'i afronin popujt e perandorisë me pushtetin qendror, duke i kthyer në një fe të përbashkët.⁷³ Këtu ishte fillimi i një epoke të re për popullin shqiptar, sepse qëkur u vendos Perandoria Osmane, për shqiptarët nisën të ndryshonin shumë gjëra. Filloi islamizimi i shqiptarëve, rritja ekonomike (sepse u mbulua nga superfuqia e asaj kohe), ndryshimi i mentalitetit të popullit (filluan të shkolloheshin me të madhe nëpër vendet lindore) dhe, detyrimisht, pas ndryshimeve të mëparshme, filloi ndryshimi edhe i leksikut të gjuhës. Huazuan terminologjinë tregtare, ekonomike, ushtarake, shkencore, fetare, administrative, politike etj. Pjesa dërrmuese e këtyre fjalëve ishin të panjohura për botën shqiptare të asaj kohe, andaj u mbeti që t'i merrnin ashtu siç janë. P.sh. fjalëve: *namaz*, *tapi*, *kanun*, *divan*, *zeqat*,

⁷³ Emil Lafe, "Fondi i persizmave në shqipen e sotme dhe në zhvillimin historik të shqipes prej mesjetës e këndej" në: Perla XIV 1-52 (Tiranë, fondacioni kulturor "Saadi Shirazi", 2009), f. 38.

fistik, avdes, sexhade, haram, tabut, tenxhere etj. Nuk kishe si i thua në gjuhën shqipe, pos të përvetësoheshin ashtu siç ishin.

Megjithatë, edhe pse osmanlinjtë hynë në Shqipëri, shqiptarët për një kohë të gjatë mundën ta mbronin shqipen nga huazimet e tepruara, por jo dhe siç mendojnë disa të tjerë se historiku i depërtimit të orientalizmeve fillon me letërsinë e bejtexhinjve. Në veprat e bejtexhinjve gjejmë një dyndje të orientalizmeve dhe kulmin e huazimeve orientale në gjuhën shqipe, jo nismën e tyre.

Këtë të vërtetë e vërteton fakti se te Buzuku kemi, edhe pse pak, fjalë turke (orientale) si: *dollma, cohë, kallauz, tepsi*; te Budi: *cohë, pazar, shend, raki, terezi etj.*; te Bardhi, e sidomos në veprat e Bogdanit kemi më shumë fjalë turke (orientale), si: *ibrik, kazan, haçi, odë, hambar, konak, hajar, okë, top, kadi, kasap, bahçe, haraç, pasha, sanxhak etj.*⁷⁴ Nga fjalët e mësipërme, arabizma janë: *hajar, kadi, kasap, haraç etj.*

Kjo ishte periudha e letërsisë së vjetër, kurse në epokën e bejtexhinjve arabizmat kishin marrë hovin e depërtimit në gjuhën shqipe. Madje, sipas disa filologëve të njohur, thuhet se orientalizmat në periudhën e bejtexhinjve janë përdorur vend e pa vend.

Shekujt XV-XVII janë quajtur periudha e hyrjes së turqizmeve në shqipe.⁷⁵

Të mos harrojmë të përmendim që kulmi i huazimeve orientale u arrit te bejtexhinjtë. Ndër to janë: *ajet, insan, amin, tevequr (tevekul), xhahil, tenxhere, miras, xhaiz, bez, bostan, xhuma, gjunah, bulug, xhevap, çorap, bina, bela, xhins, xhunub, hafiz, hall (gjendje), haxh, haram, harf, hesap, hatme, hizmet, hata, hafëjff (hafif), hasret, hise, hazret, hazër, hendek, hajr, daire, duhan, ders, def, hak, hiqaje, hiqmet, hallall, hallkë, hallvë, deqik, dyqan, dunja, devam, devlet, din etj.*

Pas kësaj, orientalizmat, duke përfshirë këtu edhe arabizmat dhe persizmat, morën tatëpjetën, sepse filloi të paraqitej fryma rilindëse, motoja e të cilëve ishte: kombi shqiptar, gjuha e pastër dhe shkëputja nga Perandoria Osmane.

⁷⁴ J.Thomai, vep. e cit. f. 222.

⁷⁵ Anton Krajni, "Hyrja e turqizmeve në shqipe dhe përpjekja për zëvendësimin e tyre", në: Studime Filologjike nr.1 (Tiranë, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1965), f. 144-145.

7.3. Periudha pas Perandorisë Osmane

Në fund të shekullit XIX Perandoria Osmane filloi epokën e dobësimit të saj. Shqiptarët dhe vendet e Ballkanit filluan të shikonin kah Evropa. Shkollimi i shqiptarëve nëpër kryeqendrat osmane filloi të binte . Ashtu që, edhe depërtimi i huazimeve orientale në gjuhën shqipe filloi të binte.

Dobësimi dhe rënia e Perandorisë Osmane nuk nënkupton se depërtimi i huazimeve orientale mori fund tërësisht. Gjuhët orientale, prej të cilave ka huazuar gjuha shqipe, janë gjuhë që kanë pasur një shtrirje më të gjerë nëpër botë. Prej tyre kanë huazuar edhe gjuhët e popujve më të zhvilluar, si p.sh. gjuha angleze, franceze, gjermane, spanjolle, italiane etj. Pra, kur shqiptarët filluan të ktheheshin drejt Perëndimit, atëherë prej tyre huazuan shumë fjalë, ndër to edhe disa orientalizma.

Këtë rrugë të depërtimit të orientalizmeve në gjuhën shqipe e përmend tërthorazi edhe leksikologu i njohur i gjuhës shqipe, Emil Lafe, i cili në një intervistë të për revistën “Perla” thotë: “Rrethanat politike e kulturore të hyrjes së persizmave (që vlen edhe për tërë orientalizmat) në shqipe lidhen me kohën kur trojet shqiptare ishin nën administrimin e Portës së Lartë. Qëkur Shqipëria u bë shtet, ato rrethana nuk janë më dhe për këtë arsye edhe orientalizmat e rinj janë të rrallë, madje vijnë jo drejtpërdrejt nga gjuhët përkatëse, po nga gjuhë të Evropës, ku kanë hyrë, më parë, p.sh. *doner* (mish që piqet duke u rrotulluar – turqisht *döner*, që ka hyrë në gjithë gjuhët e Perëndimit).”⁷⁶ Këtu profesor Emil Lafe përmend një turqizëm, ndër të rrallët që depërtuan në gjuhën shqipe pas pavarësimit të shtetit shqiptar nga gjuhët evropiane.

Gjithashtu, këtë rrugë e përmend edhe arabologu boshnjak Teufik Muftic, i cili ndër të tjera thotë: “Rruga e tretë nga ku kanë depërtuar arabizmat në leksikun e gjuhës sonë janë edhe disa gjuhë evropiane (gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja, spanjishtja etj.), gjuhë të cilat në shekujt e mesjetës pranuan shumë arabizma (nga lëmenj të ndryshëm: astronomi, matematikë, kimi, medicinë etj.).”⁷⁷

⁷⁶ N.Zoto, vep. e cit. f. 11.

⁷⁷ Teufik Muftic, “O arabizmima u srpskohrvatskom jeziku”, në: Prilozi za orientalni filologiju X-XI 61 (Sarajevo, Orijentalni Institut u Sarajevu, 1960), f. 5.

Gjuhët orientale prej të cilave huazuan gjuhët perëndimore janë arabishtja, persishtja dhe turqishtja. Fjalët që patën dyndje më të madhe në Perëndim ishin arabizmat, pastaj persizmat dhe më pak turqizmat, në dallim prej gjuhëve ballkanike që huazuan më shumë turqizma. Ky dallim vjen si rezultat i rrugëve dhe i faktorëve që ndikuan në depërtimin e orientalizmeve në gjuhët evropiane.

Qytetërimi arabo-islam pati një ndikim të fuqishëm në rilindjen evropiane. Ky ndikim ndodhi përmes dy rrugëve:

- Revolucionit italian, i cili fillin e vet e kishte nga Sicilia muslimane, që ishte edhe shkëndija e parë e rilindjes evropiane. Për ndikimin e tillë të kulturës dhe të civilizimit islam (arab dhe persian) në gjuhësinë dhe letërsinë italiane një përshkrim shumë mirë jep Dr. Abdulhakim Hassan: “Italia përfitoi shumë nga qytetërimi islam. Gjë e cila u realizua përmes dy rrugëve: përmes Spanjës dhe Sicilisë, ku lulëzoi qytetërimi islam. Ky ndikim është i dukshëm në ‘Komendinë hyjnore’ të Dante Alighierit, në poezinë italiane të njohur si ‘Canzone’, pastaj në gjininë poetike evropiane të quajtur ‘Sonet’ etj. E gjithë kjo përmes rapsodëve sicilianë.”⁷⁸
- Shkollimit të evropianëve në shkollat islame të Andaluzisë (Spanjës së sotme), ku lindën dhe u zhvilluan shumë shkencë humane dhe ekzakte. Prej aty, më pastaj, në shekullin XV, shpërtheu Revolucioni francez, që ishte i ndërtuar mbi shumë parime andaluziane, sepse atje u shkolluan udhëheqësit e tij.

Evropa përmes këtyre dy rrugëve arriti të ndërtonte qytetërimin modern. Shumë shkencë bashkëkohore nismën dhe bazat i kanë te muslimanët arabishtfolës të atyre trevave. Ata e ringjallën filozofinë greke, e shpikën matematikën, e cila sot është baza e shumë shkencave etj. Pra, meqë ndikimi oriental ishte i pranishëm edhe në filozofi, matematikë, kimi, letërsi etj., atëherë për ndikimin e orientalizmeve në leksikun e gjuhëve evropiane nuk bëhet fjalë.

Kur kemi parasysh se shkencat më të rëndësishme bashkëkohore e kanë fillin nga disa arabishtfolës, atëherë terminologjia e asaj shkence patjetër që me vete do të merrte edhe terminologjinë e parë që është përdorur. Më pastaj, shkencat dhe terminologjitë e tyre filluan të zhvilloheshin prej evropianëve edhe më shumë, por esenca çdoherë mbeti e

⁷⁸ Jasin el-Ejubi, *Medhahib el-edebi-Drejtimet letrare* (Bejrut, Darul ilmi lilmelajin, 1984), f. 21-22.

njëjtë edhe sot e kësaj dite. Me zhvillimin e atyre shkencave edhe në viset shqiptare terminologjia duhej të huazohej si e tillë, sepse nuk ishte e njohur më parë.

Në vazhdim do të përmendim disa ndërkombëtarizma që burojnë prej gjuhëve orientale, të cilat u përkasin fushave të ndryshme shkencore, por që kanë gjetur vendin e tyre edhe në gjuhën shqipe:

- *Admiral*: (emirul-bahr - أَمِيرُ الْبَحْرِ). Edhe pse ka pësuar ndryshime të ndjeshme fonetike, asaj përsëri mund t'i kuptohet esenca. Kjo rrjedh prej fjalës arabe *amir-al-bahr*, “udhëheqës në det”. Fjala e parë është huazuar nga fjala frënge *amiral*, e cila pastaj në anglisht është ndryshuar dhe është bërë *admiral*,⁷⁹ pastaj prej anglishtes ka kaluar dhe është përvetësuar prej gjuhëve të tjera të botës, ndër to edhe në gjuhën shqipe.

D.m.th. gradë e lartë në flotën detare ushtarake të një shteti, e cila i përgjigjet gradës së gjeneralit të armatës në forcat tokësore; ushtaraku që mban këtë gradë (në ushtritë që kanë grada).⁸⁰

- *Algoritëm*: (al-Havarizëm – الخوارزمي). Algoritëm është fjalë e përfitur nga emri i shpikësit të algoritmit (sistem arabik i numërimit) Muhamed bin Musa al-Havarizmi. Fillimisht, nga arabishtja është përvetësuar në gjuhën latine, pastaj në ato evropiane dhe më vonë edhe në gjuhën shqipe. Bartja e fjalës nga gjuha në gjuhë ka bërë që të pësojë disa ndryshime fonetike.⁸¹
- *Algjebër*: (alxheber - الجبر) Kjo shprehje është me prejardhje arabe. Emërtimin e tillë e ka përfitur nga libri i parë që ka shkruar themeluesi i kësaj disipline, Muhamed ibn Musa el-Havarizmi, në shekullin IX, përkatësisht nga një pjesë e titullit. Libri titullohet *al-Xheber vel Mukabele*. Pra, fjala *al-xheber*, ashtu siç e ka përdorur autori, e ka kuptimin e ekuacioneve, që në origjinal, në arabisht, do të thotë “ribashkim i pjesëve të ndara”. Në vitin 1135, me përkthimin e librit të Havarizmit në gjuhën latine, algjebra zu vend edhe në latinisht. Në gjuhën angleze, për herë të parë, me kuptimin e disiplinës së algjebërës është përdorur në fund të shekullit XVI,⁸² kurse në

⁷⁹ Dhirendra Verma, *Enrich your grammar: Word origins* (New Delhi, Sterling Paperbacks, 2008), f. 6.

⁸⁰ A.Kostallari dhe të tjerë, vep. e cit. f. 6.

⁸¹ Y.Ayto, vep. e cit. f.16-17.

⁸² Y.Ayto, po aty. f.16.

gjuhën shqipe përvetësohet nga gjuha latine (data e depërtimit nuk dihet saktë, por lidhet me depërtimin e shkencës së matematikës). Kjo fjalë sot përdoret edhe në gjuhën standarde shqipe, madje e gjejmë edhe në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe:

- *Alidade*: (alidadeh - العضاة). Mjet për matjen e këndeve. Është term ndërkombëtar që, pothuaj, të gjithë popujt përdoret njësoj;
- *Alkal*: (elkalij - القلي). Kjo shprehje, e cila i përket fushës së kimisë, vjen prej gjuhës arabe, përkatësisht nga folja *kala*, që do të thotë “të fërgosh në tavë”.
- *Alkimi*: (el-himija - الخيمياء). Huazim arab, që figuron edhe në Fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe: shkenca e rreme e mesjetës, që synonte të zbulonte të ashtuquajturin «gur filozofik» çudibërës, me anën e të cilit kujtonte se do t'i shndërronte metalet e tjera në ar e argjend, se do të shëronte sëmundjet, do të ripërtërinte e do të zgjaste jetën etj.; periudha parashkencore e kimisë.⁸³
- *Almanak* (المنّاخ). D.m.th. kalendar që përmbante shënime për ditët e vitit, për festat, për kohën, këshilla për punët e stinës etj.⁸⁴ Është fjalë e burimit arab, do të thotë: kohë, kalendar etj.⁸⁵ Të cilat, në të kaluarën, tek arabët kanë qenë vetëm disa tablo në të cilat kanë pasë shënuar kohën përmes figurave të ndryshme.
- *Amalgamë* (الملغم). Është term i kimisë, që tregon përzierje të zhivës me një metal tjetër; përzierje e disa metaleve të shkrira në zhivë.⁸⁶ Gjithashtu, edhe kjo është një arabizëm, të cilën e gjejmë me të njëjtin kuptim edhe në fjalorët klasikë arabë dhe është fjalë që zberthehet gjuhësisht. Rrënja e fjalës *amalgamë* është *legame* dhe prej saj fitohet edhe fjala *lugam*, d.m.th. pështymë, jargë etj., kështu që të gjitha fjalët e prejardhura nga rrënja *legame* tregojnë përzierje.
- *Anilinë* (النيلة). Lëng i helmët i pangjyrë dhe me erë të keqe, që nxirret nga katrani dhe që përdoret për përgatitjen e bojërave, të barnave etj.⁸⁷ Kjo fjalë është e burimit arab dhe atë nga fjala *an-nile*, që do të thotë ngjyrë llullaqi (blu e errët).

⁸³ A.Kostallari dhe të tjerë, vep. e cit. f. 25.

⁸⁴ A.Kostallari dhe të tjerë, po aty. f. 25.

⁸⁵ Eric Partridge, *Origins – a short etymological dictionary of modern english* (London and New York, Routledge, 2006), f. 99.

⁸⁶ A.Kostallari dhe të tjerë, vep. e cit. f. 26.

⁸⁷ A.Kostallari dhe të tjerë, po aty. f. 37.

- *Arsenal* (دَارُ الصَّنَاعَةِ): Fjala arsenal është një arabizëm, e cila rrjedh prej kompozitës arabe *dāras-sinā‘ah*, që, fjalë për fjalë, do të thotë “shtëpia e prodhimit”. Prej formës burimore deri në formën e sotme ka pësuar ndryshime të dukshme fonetike. Këto ndryshime i ka arritur në gjuhën italiane të Venedikut, sepse mendohet se kjo fjalë në gjuhët perëndimore depërtoi përmes Italisë.⁸⁸
- *Azimut* (السُّمُوت): Këndi që formohet në pikën e vrojtimit ndërmjet rrafshit të meridianit dhe rrafshit pingul të trupit qiellor ose të sendit që vrojtohet.⁸⁹ Fjala *azimut* vjen prej fjalës arabe *semt*, shumësi i së cilës është *sumut*.⁹⁰ Deri te fjala *azimut* ka ardhur duke pësuar disa ndryshime fonetike, parashtesën *a-* e ka marrë nga shquarsia që marrin emrat në gjuhën arabe.⁹¹
- *Boraks*: (بُورَاق): Arabizëm, që mbulon një lëndë kimike kristalore, e cila del nga bashkimi i acidit borik me sodë dhe që përdoret për të ngjitur metalet, për të prodhuar qelqin, për t'i dhënë shkëlqim porcelanit, në mjekësi etj. (FGJSSH)
- *Dragoman*: (دَرَجْمَان): Arabizëm, d.m.th. përkthyes që zakonisht bënte përkthime me gojë. (FGJSSH)
- *Gamile*: (camel) جَمَل: Arabizëm, i huazuar nga gjuhët perëndimore dhe ka kuptimin e devesë, pra në shqip llogariten sinonime.
- *Garzë* – (غَزْرَة): Pëlhurë e hollë dhe e bardhë prej fijesh pambuku të thurura rrallë, napë; copë prej kësaj pëlhure, që vihet mbi plagë kur mjekohet (FGJSSH). Pra, është një arabizëm të cilën e kemi huazuar prej gjuhëve perëndimore, por gjenezën e ka prej emrit të qytetit palestinez *Gaza*, sepse ata ishin të njohur për prodhimin e garzës.⁹²
- *Guvë*: (cave – كَهْف): Vrimë e madhe a gropë brenda në një shkëmb ose në tokë; shpellë (FGJSSH). Fjalë e burimit arab.

⁸⁸ Y.Ayto, vep. e cit. f. 36.

⁸⁹ A.Kostallari dhe të tjerë, vep. e cit. f. 78.

⁹⁰ Y.Ayto, vep. e cit. f. 554.

⁹¹ Shquarsia e emrave në gjuhën arabe, në dallim të gjuhës shqipe, bëhet me parashtesa, zakonisht me parashtesën *el*, e cila në gjuhët perëndimore transkriptohet *al*.

⁹² Y.Ayto, po aty. f. 240.

- *Kalibër*: قَالِب: Kjo fjalë është e burimit arab, përkatësisht nga fjala *kalib*, ose nga rrënja *galebe*, që do të thotë *të përmbysësh*.⁹³
- *Lahutë, udë, llautë*: Kjo fjalë është huazuar nga fjala arabe *aude* – عَوْد, që në gjuhën shqipe nënkupton një nga instrumentet më të rëndësishme të shqiptarëve.
- *Lambik*: اللَّامْبِيْق: Fjalë e burimit arab, e cila d.m.th. “kazan prej llamarine a prej bakri, që përshkohet në mes nga një gyp, ngrohet nga poshtë dhe shërben për të larë rroba” (FGJSSH).
- *Magazinë*: مَخَازِن: Kuptimi parësor i fjalës *magazinë* sot përfshin një ndërtesë ku ruhen mallra. Kjo fjalë është e burimit arab dhe është shumësi i fjalës *mahzen* – مَخْزَن. Si e tillë përdoret edhe në gjuhën italiane, franceze dhe angleze.⁹⁴
- *Mumie*: (mummy) مُومِيَا: Huazim arab, i cili në gjuhën tonë ka depërtuar nga një prej gjuhëve perëndimore, e ato e kanë huazuar nga arabishtja, përkatësisht nga fjala *mumija* – مُومِيَا.⁹⁵
- *Nadir*: astr. نَظِير: Pikë e përfytyruar në kupën e qiellit nga ana e kundërt e gjysmërruzullit ku ndodhemi, e cila del po të hiqet një vijë kulmore nëpër qendrën e Tokës (FGJSSH). Fjalë e huazuar nga gjuha arabe, nga fjala *nadhir* – نَظِير.⁹⁶
- *Reket*: (racquet) رَاحَةَ الْيَدِ: “Pallaskë e rrumbullakët prej druri me një bisht të shkurtër, që përdoret për të qëlluar topin në lojën e pingpongut” (FGJSSH). Kjo fjalë gjithashtu është e gurrës arabe. Është fjalë që burimin e ka në një kompozitë arabe, nga fjala *rahat-jedu*, d.m.th. “rehati e dorës”.⁹⁷
- *Shafran*: (Saffran) زَعْفَرَان: Kjo është një fjalë e huazuar nga gjuha arabe, *za'feran*, megjithatë nuk përputhet me sistemin e fjalëve arabe, pra është me prejardhje nga një gjuhë tjetër, por nuk dihet se nga cila.⁹⁸

Në grupin e fjalëve të lartpërmendura janë edhe fjalët: *gazelë, gjirafë, jasemin, kimi, këna, karçof, lilak, lilë, liman, lofatë, mafia, antimon, zenit, zirkon, talisman, spanjel,*

⁹³ E.Partridge, vep. e cit. f. 388.

⁹⁴ Y.Ayto, vep. e cit. f. 318.

⁹⁵ E.Partridge, vep. e cit. f. 2068.

⁹⁶ E.Partridge, po aty. f. 2088.

⁹⁷ Y.Ayto, vep. e cit. f. 410.

⁹⁸ Y.Ayto, po aty. f. 433

sinus, skarlatinë, majmun, mandarinë, muson, nukal, saten, shifër, shqeme, sodë, sofa, talk, tambur, tarifë, tarë, xherba (gjeo), zero etj.

Nga fjalët e sqaruara më lart, të cilat një pjesë e madhe fillojnë me një shquese *el*, por ne shikojmë se e-ja e tyre është shndërruar në *a*, që do të thotë se këto fjalë në gjuhën tonë kanë depërtuar përmes gjuhëve perëndimore, sepse cilësi e gjuhëve perëndimore (anglishtes, italishtes, frëngjishtes) është që fjalët e huazuara nga gjuha arabe një shquese *el* ta përshtatin me sistemin e tyre fonetik, duke e kthyer në *al*.

8. FUSHAT E SHTRIRJES SË ORIENTALIZMAVE

Në historikun e depërtimit të orientalizmave tregohet se ato kanë pasur qasje në të gjitha fushat e jetës njerëzore dhe në të gjitha veprimtaritë e mundshme, sepse bëhet fjalë për bashkëjetesë të gjuhës shqipe me gjuhët orientale, përkatësisht me osmanishten, për mbi 500 vjet me radhë. Për t'u bërë një qasje më serioze fushave ku patën shtrirje orientalizmat do të nevojitej një punim i tërë, madje ndoshta edhe një punim doktrate, por këtu do t'i përmendim shkurtimisht fushat më kryesore me disa shembuj.

8.1. Orientalizmat në fushat njerëzore⁹⁹

a) terminologjia e jetës familjare: *aga, ane, ablla, abi, evlad, baxhanak, dajë, teze, hallë, mixhë, balldëskë, kabile, zirijet* etj;

b) terminologjia e kuzhinës: *ajvar, biftek, birjan, qebap, doner, ajran, kadaif, sulqash, jani, revani, çorbë, dollma, pilaf, tenxhere, ibrik, sahan* etj;

c) terminologjia e veshmbathjes dhe stolive: *stof, bez, çorap, këmishë, xhybe, çallmë, perçe, byzyluk, duvak, këna, myhyr* etj;

ç) emërtime të mjeshtrive dhe të veprimtarive: *kasap, kafexhi, kujunxhi, nallban, samarxhi, kallajxhi, xhamxhi* etj;

d) banesa dhe inventari i saj: *bina, hayat, hale, hatlla, dollap, divan, peshkir, minder, hamam, ibrik, tenxhere, bunar, sobë, sired, kapixhik* etj;

dh) trupi i njeriu: *kalb, fiqir, bel, vuxhut, kull, kiçmë* etj;

e) ekonomi dhe tregti: *derhem, grosh, kurush, dyqan, çarshi, këst, xhambaz* etj;

ë) drejtësi dhe administratë: *xheza, tapi, vakufname, ferman, haps, haraç, avokat, adalet, kadi, shahit, delil* etj;

f) ushtri: *zabit, asqer, jeniçer, fishek, xhyle, këllëf, top, huxhum, istikame, çifte* etj;

⁹⁹ Për ndarjen në vazhim, më gjerësisht shih: Mehdi Polisi, "Klasifikimi i huazimeve orientale të gjuhës shqipe sipas fushave të veprimtarisë njerëzore", në: Filologjia 15 (Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2007), f. 46-57.

g) bujqësi, pylltari dhe blegtori: *argat, mera, sinur, çoban, jogurt, çam, jeshil, jeshillëk, livadh, bereqet* etj;

gj) ngjyra dhe lojëra: *pembe, jeshil, mavi, saritë, kumar, kumarxhi, bixhoz, shah, jorgovan, kafe* etj;

h) arsim dhe edukim: *alim, ixhazet, mualim, medrese, mejtep, sibjan-mejtep, qitap, kalem, supare, edebsiz, ahlak* etj.

8.2. Orientalizmat në onomastikën shqiptare

Shprehjet dhe fjalët orientale në gjuhën shqipe, siç e pamë, janë të shumta, madje kanë pasur aq shtrirje në viset e populluara me shqiptarë, saqë i kanë bërë pjesë të pandashme të leksikut të gjuhës shqipe. Kjo më e dukshme është në onomastikën shqiptare, sepse kur një popull pranon elemente onomastike nga një gjuhë tjetër, do të thotë se marrëdhënia e atyre ka qenë shumë e thellë.

Shtytësi që e bëri të dukshëm onomastikën orientale (veçanërisht antroponimet dhe patronimet) në gjuhën shqipe është islamizimi i shqiptarëve. Kur një popull kalon prej një feje në tjetrën, atëherë ndryshohen shumë gjëra; ndër punët më të rëndësishme që ndryshon janë emërtimet, madje islamikisht është obligim prindëror që fëmijës t'i japë një emër të bukur islam¹⁰⁰. Gjithashtu, këtë të vërtetë e pranon edhe studiuesi i njohur Gjovalin Shkurtaç, i cili thotë se antroponimet me burim të huaj kryesisht janë me burim fetar.¹⁰¹

Antroponimet dhe patronimet kanë gjetur shtrirje më të gjerë në mesin e shqiptarëve, kurse toponimet janë më pak të theksuara. Në vazhdim do të përmendim shembuj të natyrave të ndryshme:

- antroponime: *Isa, Musa, Ali, Hasan, Halil, Reshat, Mazllum, Xhelal, Jusuf, Sead, Miftar, Jashar, Ziber, Rustem, Ali, Zeqir; Ajshe, Hatixhe, Merjeme, Fatime, Habibe, Hajrije, Asije, Semije, Jusra, Bushra* etj;

¹⁰⁰ Me "emër të bukur islam" kuptojmë që fëmija të mos emërtohet me emër ofendues, qesharak, që ka kuptim të keq dhe të vijë ndesh me parimet fetare islame, por kjo nuk do të thotë se emrat duhet të jenë patjetër orientale, jo, përkundrazi, ata mund të jenë emra të bukur nga gurra shqipe, si p.sh. Besnik, Arjeta, Lavdërim, Lavdërimë, Guxim, Jeton, Atdhe, Vegim, Besim, Besa etj.

¹⁰¹ Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë* (Tiranë, SHBLU, 2001), f. 24.

- patronimet: *Bexheti, Abdullahu, Bastriaga, Bunarliu, Serdari, Selmani, Sulejmani, Islami, Bajrami, Koxhaxhiku, Ahmeti, Ramadani, Lata, Rexhepi, Hasani, Ismaili, Demiraj, Kadriu, Sinani* etj;¹⁰²

- toponimet: *Karadak, Has*¹⁰³, *Çair, Gazi Baba, Bajram Beg, Bit Pazar, Myslim Shyri, Konjarë, Ali Demi* etj.

Më të përhapura në viset shqiptare janë mikrotoponimitë orientale (emrat e rrugëve, lagjeve, shesheve, livadheve, fushave etj.), kurse makrotoponimia është më pak e theksuar, sepse emrat e shteteve, qyteteve dhe fshatrave, në pjesën dërrmuese të rasteve, janë të gurrës shqipe, latine etj.

Toponimia (apo mikrotoponimia) orientale ka pasur një shtrirje të dalluar në ndërtimet osmane, të cilat janë bërë gjatë qeverisjes osmane në vendin tonë, por edhe pas osmanëve: emrat e xhamive, teqeve, tyrbeve, medreseve, mejtepeve, pazareve, haneve, bezisteneve, hamameve etj. Zakonisht, emërtimet e këtyre institucioneve janë bërë në disa mënyra: me emra të dijetarëve, të evlijave (njerëzve të mirë), të pashallarëve e bejlerëve (që i kanë ndërtuar), të rasteve dhe ndodhive historike të rëndësishme islame; me emra të fshatrave, lagjeve, familjeve etj., p.sh. xhamitë: “Jahjapashë” (Shkup), “Et’hem Beu (Tiranë), “Sulltan Mehmet Fatih” (Prishtinë), “Bajrambeg” (Dibër), “Xhamia e Pashës” (Tetovë) etj; tyrbet: “Tyrbja e Sulltan Muratit” (Prishtinë), “Tyrbja e Allaxhës” (Shkup); medreseja “Isa Beu”; hamami i “Daut Pashës”; “Kapan-Han” etj. Të gjitha këto emërtime janë huazime orientale. Këtu përmendëm vetëm një pjesë të tyre; për një përfshirje më të gjerë do të nevojitej një punë shumë më e madhe.

Veç emërtimeve orientale, sot kemi edhe ndërtime të reja, kryesisht xhami, që mbajnë emërtime të gurrës shqiptare ose, të paktën, joorientale. Kjo zakonisht ndodh te xhamitë e fshatrave dhe të lagjeve, të cilat marrin emrin e fshatit ose të lagjes, p.sh.: “Xhamia e Re” (Dibër), “Xhamia e Dizhonit” (Shkup), “Xhamia e Plumbit” (Shkodër), “Xhamia e Madhe” (Gjilan) etj.

¹⁰² Në viset e populluara me shqiptarë në Maqedoni, zona e Karadakut dhe e Pollogut, i përdorin më shumë patronimet orientale, kurse më pak Dibra. Në Dibër ka edhe patronime ilire, si p.sh. Duka, Marku etj., të cilat përbëjnë ¼ e tërësisë.

¹⁰³ Begzat Baliu, *Onomastika e Kosovës – ndërmjet miteve dhe identiteteve* (Prishtinë, Era, 2008), f. 44.

Nga lëvrimi i mësipërm kuptojmë se më e përhapur në gjuhën shqipe është onomastika arabe dhe turke, kurse ajo persiane më pak. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se elementet onomastike perse nuk janë të pranishme. Nga onomastika perse kemi p.sh. Pekmezi, Çardaku, Qosja, Xhani, Xhemerti, Gonxhe¹⁰⁴ etj.

8.3. Islamizmat¹⁰⁵ në gjuhën shqipe

Dukuria e depërtimit të leksikut islam nëpër gjuhë është një e vërtetë dhe ajo la pa prekur asnjë popull që brenda vetes ka muslimanë. Madje, nga kjo dukuri nuk shpëtuan as gjuhët më të zhvilluara të botës, mirëpo secila këtë e pranoi në formën e vet, duke përshtatur sistemin fonetik të asaj gjuhe. P.sh. thirrjes që bëhet për namaz në anglisht i thonë *adhan*, në shqip *ezan*; ose, përqindjes që japin nga pasuria e tyre për çdo vit në shqip i thonë *zeqat*, kurse në anglisht *zakat*.

Qëkur shqiptarët pranuan fenë islame, leksiku islam filloi të depërtonte në gjuhën shqipe. Rrugët e depërtimit të islamizmave janë po ato rrugë që u shfrytëzuan nga orientalizmat, mirëpo ajo që veçohet është shkollimi i shqiptarëve nëpër universitetet islame të asaj kohe dhe hapja e institucioneve arsimore islame në vendin tonë. Pra, në universitetet dhe shkollat që cituam u përvetësua terminologjia islam dhe pastaj u përhap edhe në mesin tonë.

Pjesa më e madhe e islamizmave në gjuhën tonë janë të burimit arab, kurse një pjesë e vogël e terminologjisë islame janë të burimit pers dhe turk. Islamizmat me burim nga persishtja dhe turqishtja, kryesisht, depërtuan në gjuhën tonë nga gjuha osmane, p.sh.: *namaz, avdes, yle* (në Dibër), *iqindi, jaci, aksham* etj.

Gjuhët tjera të botës, përveç gjuhëve ballkanike, nuk patën mundësinë të kenë një terminologji islame nga të tri gjuhët orientale. Huazimet islame ndër gjuhët botërore, pothuaj tërësisht, janë nga arabishtja, ose, me raste, kanë sajuar fjalë nga gurra e gjuhëve të tyre.

¹⁰⁴ Jusuf Shpuza, “Ndikime perse në fondin onomastik të gjuhës shqipe”, në: Perla, viti XIV nr. 1-52 (Tiranë, fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2009), f. 49.

¹⁰⁵ Fjalën orientale (arabe, perse, turke, hebraike etj.) që mbulon një emërtim të lidhur me mësimet e fesë islame e quajmë *islamizëm*.

Në vazhdim do të paraqesim ndarjet më kryesore të islamizmave në leksikun e gjuhës shqipe:

- *Allah*, është emri i përveçëm i Krijuesit të gjithësisë dhe Zoti i vetëm, të Cilin e adhurojnë muslimanët pa i përshkruar shok. Emri *Allah* te shqiptarët ka një shtrirje shumë të gjerë, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë letrare. Me këtë emër janë formuar shumë kompozita gjuhësore, shprehje frazeologjike dhe stile letrare, si p.sh.: “*Mashallah!*”, “*Emrullah*”, “*Allahile*”, “*Allahu i ardhhtë hakut!*”, “*Allahu ia shkrettë!*”, “*Alleshkën!*”, “*Evallah*” etj;
- Emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm të pejgamberëve, librave, melaqeve, vendeve të shenjta etj., si p.sh.: *pejgamber*, *nebij*, *resulallah*, *Muhamed*, *Isa*, *Musa*, *Adem*; *melaqe*, *xhind*, *shejtan*, *Xhebrail*, *Azrail*, *Mikail*, *Asrafil*, *Iblis*; *qitap*, *mus'haf*, *sajfe*, *Kuran*, *Teurat*, *Zebur*, *Inxhil*; *kible*, *xhami* (*mafil*, *qursij*, *hutbe*, *kube*, *minber*), *minare*, *sherife*, *Qabe*, *tavaf*, *saj*, *ihram* etj;
- Emërtimet e obligimeve, veprimeve dhe titujve islamë, si p.sh.: *ezan*, *ikamet*, *namaz* (*tekbir*, *ruku*, *sexhde*, *selam*), *zeqat*, *haxh*, *Ramazan*, *sadaka*, *avdes*, *sabah*, *ile*, *itikaf* (*drekë*), *iqindi*, *aksham*, *jaci*, *nisab*, *xhuma*, *taravi*, *bajram*, *iftar*, *syfyr*, *imsak*; *hoxhë*, *myfti*, *sheh*, *imam*, *myezin*, *halife*, *kadi*, *hatip*, *xhemat*, *mulla*, *reis*, *alim*, *hafëz*, *haxhi*, *efendi* etj.;
- Emërtime të arsimit islam dhe të tjera, p.sh.: *qitap*, *alim*, *ilm*, *ders*, *vaz*, *vazi-nasih*, *nasihat*, *ilmihal*, *ezber*, *hifz*, *ahlak*, *dersane*; *as'hab*, *tabiin*, *sevap*, *gjynah*, *hajr/hair*, *sherr*, *haram*, *hallall*, *xhaiz*, *mekruh*, *idet*, *kaza*, *mubareq/mubarek*, *gibet*, *hajz*, *dua*, *salavat*, *ajet*, *sure*, *tespi*, *selam* etj.¹⁰⁶

¹⁰⁶ Shih: Mehdi Polisi, “Klasifikimi i huazimeve orientale të gjuhës shqipe sipas fushave të veprimtarisë njerëzore”, në: Filologjia 15 (Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2007), f. 59.

9. RRUGËT DHE FAKTORËT QË MUNDËSUAN DEPËRTIMIN E ORIENTALIZMAVE NË LEKSIKUN E GJUHËS SHQIPE

Një dukuri bëhet realitet, e arrin efektin e vet, vetëm atëherë kur i paraprijnë disa faktorë dhe kur i kalon disa rrugë. Pra, që orientalizmat të jenë efektivë dhe të përdorshëm në gjuhën shqipe, ndihmuan disa rrugë dhe faktorë.

9.1. Rrugët e depërtimit të orientalizmave në gjuhën shqipe

Depërtimi i orientalizmave në gjuhën shqipe ka ngjarë në disa rrugë. Edhe pse rrugëtimi i huazimeve orientale në gjuhën shqipe lidhet ngushtë me faktorët, ai nuk ka qenë i njëjtë. Përderisa gjuha nga ku kemi huazuar orientalizma nuk është e njëjtë, atëherë edhe shtegu nga ku depërtuan ato nuk mund të jetë i njëjtë. Andaj, orientalizmat për të ardhur në gjuhën shqipe kaluan këto rrugë:

- *Huazimi i drejtpërdrejtë*. Këtë rrugë e ndoqi pjesa më e madhe e turqizimave, sepse ato kishin lidhje të drejtpërdrejta, më gjatë kohë, me shqiptarët, kurse më pak këtë rrugë e shfrytëzuan arabizmat dhe persizmat. Megjithatë, nuk do të thotë se në gjuhën tonë nuk depërtuan arabizma dhe persizma drejtpërdrejt nga arabishtja dhe persishtja. C.Letueux thotë: “Nuk përjashtohet mundësia që ato (arabizmat dhe persizmat) të jenë huazuar drejtpërdrejt nga persishtja dhe arabishtja.”¹⁰⁷

Ato pak arabizma që i takojnë kësaj rruge, pjesa më e madhe e tyre janë të fushës së islamistikës. Me përqaftimin e Islamit nga shqiptarët, u paraqit nevoja e përgatitjes së kuadrit fetar, andaj një pjesë e shqiptarëve filloi të shkollohej nëpër universitetet më të njohura islame në botën arabe. Kuptohet, atyre iu duhej ta mësonin atë gjuhë dhe pastaj, kur u kthyen nëpër vendet e tyre, njerëzve ua mësonin të njëjtat gjëra, me ç’rast hasën në vështirësi shqipërimi, prandaj dhe i përdorën ato si të tilla. Ndër to janë: *meskin, fukara, myfti, xhemat, imam, qefin, qitap, kalem, ruqu/ruku, selam, bereqet, rahmet, Allah, zeqat, sadaka, mulla, xhami, medrese, minare, sixhade* etj.

¹⁰⁷ Miço Samara, “Rreth huazimeve nga turqishtja në gjuhën shqipe”, në: Gjurmime albanologjike - seria e shkencave filologjike 25-1995 (Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1996), f. 64.

- *Huazimi i tërthortë*. Gjuha shqipe, në raport me gjuhët orientale, kishte edhe huazim të tërthortë, pra kur fjalët e një gjuhe orientale huazoheshin përmes një gjuhe të tretë. Tërthorazi, shqipja nga gjuhët orientale më shumë ka huazuar nga arabishtja dhe persishtja, më pak nga turqishtja. Në vazhdim do të përmendim disa arabizma që kanë depërtuar tërthorazi (indirekt) në gjuhën tonë, pjesa më e madhe përmes turqishtes: *merkat, meram, mystesna, qefaret, qefil, qeder, surat, hallku, beqar, ferk, fodull, garib, daulle, dahël, hak, hakikat, hakaret, kalama, këmishë, kanun, millet* etj.

Përveç fakteve historike, këtë rrugë e tregojnë vetë dallimet fonetike të fjalëve të huazuara. P.sh. fjala *ezan* në gjuhën prej së cilës e kemi huazuar, në arabisht, shqiptohet *edhan*, kurse në gjuhën turke, në mungesë të tingullit *dh*, është zëvendësuar me tingullin *z*. Po ta kishim huazuar drejtpërdrejt nga arabishtja, do ta kishim shqiptuar si *edhan*, sepse gjuha jonë e njeh këtë tingull. Të tilla janë edhe shumë fjalë të tjera, p.sh.: *kefaret – qefaret, kefil – qefil, keder - qeder, bekar – beqar* etj. Këto dhe disa ndryshime të tjera fonetike argumentojnë rrjedhshmërinë dhe vërtetësinë e kësaj rruge.

Huazimi i tërthortë në gjuhën shqipe nga arabishtja dhe persishtja ka ndodhur si rezultat i asaj se shqipja nuk ka pasur lidhje të drejtpërdrejta me popujt e këtyre gjuhëve, aq më pak me persianët, pos në raste të rralla, si p.sh. në tregti, arsimim etj.

Orientalizmat që më pak ndoqën këtë rrugëtim janë turqizmat, sepse, siç thamë më parë, ato depërtuan drejtpërdrejt. Turqizmat që depërtuan tërthorazi në gjuhën shqipe i shfrytëzuan gjuhët ballkanike. Pra, fillimisht depërtuan në ndonjë gjuhë ballkanike, pastaj në gjuhën shqipe. Megjithatë, është vështirë të bëhet qartësimi se në cilën gjuhë ballkanike ka depërtuar më herët një turqizëm.

Në rastet e këtilla, kur shumica e gjuhëve të Ballkanit kanë huazuar orientalizma, duke mos ditur se cila më parë e cila më vonë, cila nga osmanët e cila nga ndonjë gjuhë tjetër fqinje ballkanike, atëherë këto orientalizma mund t'i quajmë si *orientalizma ballkanike*.

Vlen të theksohet se rruga e tërthortë, madje edhe ajo e drejtpërdrejtë, pothuaj është ndërprerë sot nga gjuhët orientale, pos nga arabishtja. Ka një numër arabizmesh që i kanë huazuar gjuhët perëndimore, të cilat ne sot i huazojmë si ndërkombëtarizma, p.sh.: *algoritëm, kimi, admiral* etj., për të cilat më gjerësisht folëm më parë. Kjo nuk do të thotë

se nga turqishtja dhe persishtja nuk ka asnjë fjalë përmes kësaj rruge. P.sh. prej turqishtes e kemi fjalën *doner*, të cilën e kanë huazuar të gjitha gjuhët perëndimore etj.

9.1.1. Huazimet dyrrugëshe

Duke i shikuar marrëdhëniet e huazimit në kompleksin e tyre: në përhapjen territoriale, qendrat e rrezatimit dhe degëzimit që kanë pasur, ndërthurjet e interferencave që kanë pësuar, arrihet në një kuptim më real të historisë së tyre. Aty kërkimi shkencor ndeshet veçanërisht me tri fakte. Së pari, te fjalët që në një gjuhë kanë depërtuar me dy rrugë dhe prandaj vijnë me dy forma të ndryshme. Së dyti, te fjalët për të cilat është vështirë përcaktimi i burimit të mosndërmjetëm. Së treti, te fjalët me etimologji të dyfishtë, nganjëherë edhe me të shumëfishtë.¹⁰⁸

Një numër i mirë fjalësh nuk kanë gjetur vetëm një shteg depërtimi në gjuhën shqipe, por ato shfrytëzuan më shumë se një rrugë. Ka një tufë fjalësh orientale, në të shumtën e rasteve janë arabizma dhe persizma, që në gjuhën tonë hynë edhe nga turqishtja, por edhe nga një shteg tjetër, qofshin gjuhët ballkanike, evropiane etj., apo ndonjë faktor tjetër. P.sh. fjala arabe *Ramazan*, emërtim për muajin e shenjtë në të cilin agjërohet, është huazim nga turqishtja. Megjithatë, në mesin tonë, veçanërisht për patronimet, përdoret edhe fjala arabe *Ramadan*, që është më e denjë me fjalën burimore arabe, e huazuar drejtpërdrejt nga arabishtja.

Gjithashtu, arabizma të këtij lloji janë: *hadis*, *Qerim*, *qitap*, *veqil*, *zeqat*, *Qabe*, *qefaret*, *ezan* etj., të cilat kanë depërtuar nga gjuha turke, sepse në to kemi ndërrimin e D-së dhe Dh-së në Z, kurse te disa e sajojmë qiellëzorizimin, shndërrimin e K-së në Q. Fjalët e lartpërmendura në gjuhën tonë kanë edhe një përdorim më ndryshe, që do të thotë se kanë shfrytëzuar një shteg tjetër dhe kanë depërtuar ashtu siç janë në origjinal. P.sh. *Qerim-Kerim*, *hadith-hadis*, *qitap-kitap*, *veqil-vekil*, *zeqat-zekat*, *Qabe-Kabe*, *qefaret-kefaret* etj.

Një pjesë e këtyre huazimeve janë arabizmat të cilat si rrugë të dytë shfrytëzuan gjuhët perëndimore. Pra, përveç turqishtes, studimit nëpër viset islame etj., ato u huazuan nga leksiku islam i gjuhëve perëndimore, të cilat zakonisht kanë huazuar pa ndryshimet

¹⁰⁸ E.Çabej, vep. e cit. f. 130.

fonetike të lartpërmendura, të cilat arabizmat i pësonin në gjuhën turke. Megjithatë, ato pësuan ndryshime të tjera fonetike, varësisht nga gjuha, ku ne nuk do të zgjerohemi.

9.2. Faktorët dhe shkaqet që u hapën rrugën orientalizmave

Përmendja e faktorëve që ndihmuan depërtimin e arabizmave në leksikun e gjuhës shqipe është shumë me rëndësi. Zakonisht gjuhët ndikohen nga gjuhët e të njëjtit grup që i takojnë apo nga gjuhët fqinje. Gjuha shqipe përbën një grup më vete në listën e gjuhëve indoevropiane. Jo vetëm që është e vetme në grup, por dhe nuk ka shumë fjalë që i kanë gjuhët tjera evropiane.

Në “Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe” (1891), G. Majeri nga 5.140 fjalë, 400 i nxori si të burimit të vjetër indoevropian, 730 fjalë i la të pazbërthyer, 1.180 orientalizma, kurse të tjerat i cilësoi si huazime nga greqishtja, latinishtja etj... Nga 730 fjalë që Majeri i la pa shpjegim, më pas u vërtetua se shumica janë të shtresës së trashëguar evropiane.¹⁰⁹

Prej paragrafit të lartpërmendur kuptojmë se gjuha shqipe paska shumë pak fjalë të huazuara nga gjuhët indoevropiane simotra. Atëherë, ekzistojnë disa faktorë tjerë që e bënë atë të huazojë nga gjuhët orientale. Ne këtu do të ndalemi vetëm te faktorët që mundësuan depërtimin e arabizmave:

9.2.1. Tregtia, zanafillë e huazimeve orientale

Perandoria Osmane, asokohe, ishte superfuqi ushtarake dhe ekonomike. Përveç kësaj, ata e kishin të zhvilluar edhe tregtinë. Kështu që, kontaktet e para që i patën shqiptarët me osmanlinjtë ishin marrëdhënie tregtare. Siç potencuam edhe më parë, ky ishte faktori i parë dhe fillimi i hyrjes së arabizmave në gjuhën shqipe.

Këtu duhet theksuar fakti se nuk ishin osmanlinjtë të vetmit që depërtonin nëpër Evropë përmes tregtisë, por ishin edhe arabët, të cilët përmes Sicilisë dhe Italisë Jugore arritën ta islamizonin gjithë atë vend, duke ndikuar edhe në vendet tjera përreth, e në veçanti në Ballkan.

¹⁰⁹ E.Çabej, po aty. f. 228.

Pra, osmanlinjtë dhe arabët (në Sicili) bënë ndryshime rrënjësore në shoqëritë dhe jetën shpirtërore të evropianëve. Prof. dr. Enes Kariqi thotë: “Ata sollën mallrat tregtare, pajisjet luftarake, librat, orenditë shtëpiake, veshjet, ushqimet e ndryshme, ilaçet etj. Shumica e këtyre gjërave me vete bartën edhe emrat e tyre, prandaj sot në gjuhët e Ballkanit gjejmë mijëra fjalë dhe shprehje në fushën e shkencës, të fesë, letërsisë, veshmbathjes, preparateve kozmetike, mjekësisë, gatimit etj.¹¹⁰ P.sh.: *mutfak, setre, këmishë, sahan, tanur, kajde* etj.

Nga shtjellimi i mësipërm na bëhet e qartë se ndikimet orientale në vendin tonë kanë qenë të pranishme edhe para rënies së Shqipërisë nën Perandorinë Osmane. Ky ndikim është bërë përmes dy rrugëve: përmes osmanlinjve të Anadollit dhe përmes arabëve të Sicilisë.

9.2.2. Rënia e Shqipërisë nën qeverisjen osmane

Si fazë e dytë që ndihmoi në depërtimin e arabizmave në gjuhën tonë është rënia e shtetit shqiptar nën qeverisjen otomane. Pa dashur që të ndalemi gjerësisht në rënien e Shqipërisë nën shtetin osman, duhet theksuar shkurtimisht se shteti ynë shqiptar njeh dy rënie nën Perandorinë Osmane: rënien e pjesshme dhe rënien e tërësishme.

Rënia e pjesshme ndodhi në shumë vende, por jo në gjithë Shqipërinë. Në betejën e Savrës, që u zhvillua më 18 shtator 1385, forcat ushtarake shqiptare u thyen dhe vetë Balsha II gjeti vdekjen. Fitorja e betejës i dha mundësi ushtrisë osmane që të pushtonte Beratin, Krujën etj., të cilat i mbajti përkohësisht... Në vitin 1386 osmanët pushtuan Nishin dhe pas një viti Selanikun.¹¹¹ Në vitin 1389 në luftën e Fushë-Kosovës, pas një lufte shumë të ashpër, me humbje të shumë viktimave, fitimtar dolën osmanlinjtë.¹¹² etj.

Pastaj, ndodhi grushti anti-osman, u bashkuan të gjithë shqiptarët nën komandën e Skënderbeut, i çliruan vendet që ishin nën Perandorinë Osmane në vitet 1444-47. Pastaj, në gjysmën e dytë të shekullit XV, Shqipëria tërësisht mbetet nën Perandorinë Osmane.

Këtu depërton një numër i konsiderueshëm arabizmash, p.sh.: *esir, isharet, izën, ezan, edeb, iftibar, tabut, tamin, takva, kader, evlad, beqar, xhins, xhemat, xherime*, etj.

¹¹⁰ E.Karic, vep. e cit. f. 109.

¹¹¹ Skënder Anamali dhe Kristaq Prifti, *Historia e popullit shqiptar* (Tiranë, Botimet Toena, 2002), f. 324.

¹¹² S.Anamali dhe K.Prifti, po aty. f. 324.

Ky është njëri ndër faktorët kryesor, sepse kur një popull hyn nën qeverisjen dhe pushtetin e një populli tjetër merr kulturën, gjuhën, traditat etj. të tij. Pra, mishërohen me njëri-tjetrin.

9.2.3. Feja; islamizimi i shqiptarëve

Strategji e shtetit osman ishte që përmes tregtarëve dërgonte edhe misionarë. Dërgimi i misionarëve islamë mundësoi që një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve ta pranonin Islamin para se osmanlinjtë ta merrnin kontrollin e plotë të Shqipërisë.

Konvertimi në islamizëm i shqiptarëve i shkëputi shumë prej tyre nga ndikimi i kishave ortodokse sllave e greke (të cilat liturgjinë e mbanin në gjuhën sllave dhe greke), duke ndërprerë kështu vrullin e procesit shekullor të sllavizimit e të greqizimit të shqiptarëve. Gjithashtu, islamizimi iu dha mundësi shqiptarëve që të integroheshin në jetën e Perandorisë Osmane dhe të ruanin, deri në njëfarë mase, pozitat e tyre ekonomike e politike.¹¹³ Duket qartë se islamizimi i shqiptarëve u dha atyre identitetin e duhur, në të kundërtën, sllavizmi dhe fryma greke do ta mbulonin Shqipërinë.

Me pranimin e fesë islame, të shqiptarët, në mesin e popullit, u panë ndryshime të dukshme. Islami iu ndryshoi shqiptarëve shumë gjëra në jetën shpirtërore dhe materiale. Në mesin e të gjitha ndryshimeve që pësuan shqiptarët ishte edhe ndryshimi i gjuhës, apo ndryshimi i elementeve gjuhësore. Me pranimin e islamit si fe, fillimisht filloi të ndryshonte antroponomia, toponimet, patronimet etj.

Pas pranimit, ata filluan ta mësonin fenë islame nga dijetarët islamë (osmanë), në gjuhën osmane dhe prej librave arabo-osmanë. Pastaj, pjesa e riteve fetare u mbush plot me terma arabë. Këtu (në fushën e riteve) terminologjia arabe ka qenë, fillimisht, më aktuale. Vlen të përmendim faktin se arabizmat edhe sot e kësaj dite më aktuale janë në fushën e islamistikës. P.sh.: *iman, islam, istigfa (istigfar), toubë, qitap (kitab, për Kuranin), hutbe, imam, muezin, minare, xhami, dovë (dua'), musaf, tespi, mihrab, qursij, zerre, xhenet, xhehenem, Allah* etj.

¹¹³ S.Anamali dhe K.Prifti, po aty. f. 325.

9.2.4. Përdorimi i osmanishtes si gjuhë zyrtare

Shteti osman me të marrë nën kontroll Shqipërinë instalon administratën e vet shtetërore. Kjo është faza në të cilën shqiptarët përvetësuan terminologjinë administrative osmane, në mesin e të cilave kishte arabizma, persizma dhe turqizma.

Dokumenti më i hershëm, i zbuluar deri tani, për të njohur sistemin agrar të cilin e vendosën pushtuesit osmanë në Shqipëri dhe në Ballkan është një regjistër kadastral i vitit 835 H (1431-1432), i emërtuar “Regjistër i Sanxhakut Shqiptar” (Defter-i Sancak-i Arvanid). Në të janë përfshirë një pjesë e viseve të Shqipërisë perëndimore, që shtrihej nga Çamëria deri në lumin Mat. Krahas pasqyrimit të shpërndarjes së timareve në çastin e hartimit të regjistrit, aty ka edhe shënime që u referohen periudhave më të hershme, kohës së sulltan Bajazitit I (1389-1402) dhe të sulltan Mehmetit I (1413-1421).¹¹⁴

Prania kaq e hershme e dokumenteve administrative osmane, edhe pse në masë të vogël, na jep të kuptojmë se edhe arabizmat administrativë në Shqipëri qenkan që moti.

Gjithashtu, ndihmë e madhe për depërtimin e arabizmave në gjuhën shqipe ishte edhe vetë alfabeti arab që përdornin osmanlinjtë. Ngase, osmanishtja është një gjuhë e përbërë prej tri gjuhëve: arabe, turke dhe persiane. Sistemin foljor dhe një pjesë të konsiderueshme të fjalëve i ka nga turqishtja; një mori emrash dhe alfabetin e ka nga arabishtja; ndërkaq, nga persishtja ka vetëm disa emra.

Duhet theksuar faktin se gjuha arabe nuk kishte kontakt të drejtpërdrejtë me gjuhën shqipe, por atë e bëri përmes gjuhës osmano-turke. Pra, bëri huazim të tërthortë.

Përvetësimi i alfabetit arab prej shqiptarëve, iu mundësoi atyre që ta kenë më lehtë kontaktin me literaturën arabe.

9.2.5. Shkollimi i shqiptarëve në Stamboll dhe Anadoli

Shqiptarët çdoherë kanë qenë dashamirës të dijes dhe të shkencës. Kështu që, me futjen e osmanlinjve në trevat tona, shqiptarëve iu hapen kufijtë dhe fillojnë shkollimin. Fillimisht këtë ua detyronte vetë shteti osman, sepse i merrte fëmijët që në vegjëli, i shkollonte dhe i klasifikonte, varësisht prej aftësive që ata kishin.

¹¹⁴ S.Anamali dhe K.Prifti, po aty. f. 327.

Përveç kësaj, ata kishin edhe universitete shumë të zhvilluara, prej ku dolën shumë shqiptarë të shkolluar, të cilët jo vetëm që ishin të dobishëm për Shqipërinë, por për tërë botën islame.

Në këtë periudhë, që shënon kulmin e fuqisë së Perandorisë Osmane, prania shqiptare në viset arabe është shprehur me praninë e bejlerëve (udhëheqësve) shqiptarë në krye të administratës osmane. Kështu, në këtë nënperiudhë kemi dhjetëra bejlerë (udhëheqës) shqiptarë, të cilët u afirmuan gjatë sundimit të tyre me vepra të mëdha si në Egjipt, Jemen, Siri, Irak etj.¹¹⁵

Po të ndaleshim dhe t'i përmendnim shqiptarët e arsimuar që kanë sunduar me vendet arabe, kjo do të na merrte shumë kohë, pastaj, nuk është dhe rendi i kësaj. Këtu vlen të përmendet se edhe një pjesë e rilindësve tanë u shkolluan dhe vepruan në Turqi e në botën arabe. Pastaj, kemi edhe koloninë e Misirit.

Pas gjithë kësaj, parashtrohet pyetja: A thua, vallë, gjithë kjo lidhje shqiptaro-arabe dhe vetë shkollimi e veprimi i shqiptarëve nëpër këto vende nuk qenka një faktor që ka ndihmuar hyrjen e arabizmave në vendin tonë?

Ashtu siç ndikohet nxënësi nga mësuesit e vet, ashtu u ndikuan edhe shqiptarët nga mësuesit e tyre orientale (arabë).

9.2.6. Mungesa e alfabetit të gjuhës shqipe apo përdorimi i alfabetit osman

Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm është edhe mungesa e alfabetit shqip, apo përdorimi i alfabetit osman në të gjitha sferat e jetës sonë.

Veç kësaj që përmendëm më parë, mungesa e alfabetit shqip, shkollimi dhe arsimimi i shqiptarëve në Orient, si rezultat i gjithë kësaj, pra, shqiptarët shkruanin me alfabet arab. Jo vetëm kaq, por ne kemi një periudhë të tërë të letërsisë sonë që është lëvruar me alfabet arab. Është kjo letërsia e bejtexhinjve, e përfaqësuar nga Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Kyçyku etj.¹¹⁶

Pra, pothuaj, është e pamundur që t'u iket arabizmave, kur dihet se një epokë e tërë e letërsisë është shkruar në atë alfabet. Madje, duhet të mos e harrojmë të vërtetën se

¹¹⁵ Muhamed Mufaku, *Shqiptarët në botën arabe* (Prishtinë, Rilindja, 1990), f. 25.

¹¹⁶ M.Hysa, vep. e cit. vëll.I. f. 12.

përveç bejtexhinjve, me alfabet arab shkruhej edhe para bejtexhinjve, para shekullit XVIII (pra, para se të fillonte letërsia e bejtexhinjve). Sa për shembull, ia vlen të përmendim: Dervish Hasani, Sulejman Ejub Dede, Haxhi Ymer Mustafa Kashari, Mulla Beqiri, Omer efendi Sadedini, Ibrahim Elbasani etj.

Përveç bejtexhinjve dhe atyre që përdornin para tyre alfabetin arab, kemi edhe në periudhën e mëvonshme, pas bejtexhinjve, që përdorën alfabetin arab në shkrimet e tyre. Këtu duhet theksuar se ata që më së shumti e përdorën alfabetin arab pas bejtexhinjve janë hoxhallarët dhe shehlerët: Said Najdeni, hoxhë Voka, Ali Elbasani etj.

Pastaj, edhe në fillim të periudhës së Rilindjes Kombëtare kishte shkrimtarë që shkruanin me alfabet arab. Me theks të veçantë, rilindësit që jetonin dhe vepronin në koloninë e Stambollit dhe të Misirit: Sami Frashëri, Naim Frashëri, hafëz Ali Korça etj. Këtë veçmas e thekson profesor Mahmud Hysa në veprën e tij *Alamiada Shqiptare*, ku për periudhën pas bejtexhinjve më gjerësisht flet në veprën e dytë.

- Nezim Frakulla:

“Ai m’i çeli katër dyer,
njonda osht ah *sheriat*
Osht e dyta *tarikat*
dera tret *hakikat*.”

- Tahir efendi Lluka:

"Gjithsa kavm me g(j)uh t’vet jon tuj knue hem tuj shkruie për *dynja* dit për dit kta
tuej fitue e tuj madhnue veç *kavmi yn pa fitue tuj voglue*."

- Hafiz Ali Korça: (nga Rubairat, e shkruar komplet arabisht)

“Para meje teje, kisht dit` e natë
Për pun`është sjellë rrot e qjellit gjatë
Hap sytë ngadalë të shkelç përmi tokët
Bebe-syri vajzash është pluhur`I thatë”.

10. MËNJANIMI I ORIENTALIZMAVE NGA GJUHA SHQIPE

Periudha e bejtexhinjve ishte kulmi i përdorimit të orientalizmave në gjuhën shqipe. Pas kësaj orientalizmat në gjuhën tonë filluan të marrin tatëpjetën. Këtu nuk do të ndalemi në atë se a bën apo nuk bën të hiqen orientalizmat nga gjuha jonë, sepse një gjë të tillë e sqaruar më parë; këtu do t'u qasemi shtytësve që ndihmuan largimin e orientalizmave.

10.1. Shkaqet që sollën në reduktimin e orientalizmave

- *Ngjallja e ndjenjës kombëtare shqiptare.* Meqë në tërë botën ndjenja e nacionalizmit kishte marrë dhenë, atëherë edhe te shqiptarët kjo ndjenjë, e pranishme që moti, filloi të forcohej mjaft. Kuptohet, kjo pastaj i sillte të gjitha ndryshimet dhe dëshirën për ta bërë çdo gjë shqiptare, ndër to edhe gjuhën. Këtu filluan të ndryshohen termat orientale, të përdorshëm aty-këtu në mesin e shqiptarëve; p.sh. fjala *axhëtis* u zëvendësua me fjalën *më vjen keq*; fjala *çallështis* u zëvendësua me barasvlerën e saj shqipe *punoj, përpiqem*; fjala *batile* me fjalën *e kotë* dhe *e padrejtë* etj.
- *Dobësimi i Perandorisë Osmane.* Kjo bëri që Shqipëria të sheh kah Perëndimi, andaj dhe kultura, qytetërimi, gjuha orientale etj. filluan të shuheshin ngadalë në trojet shqiptare, sepse tani ajo zbrazëtirë fillonte të plotësohej nga krahu tjetër, bota perëndimore. Prej këtu u hap shtegu i depërtimit të fjalëve oksidentale, sepse shqiptarët filluan të shkolloheshin në Perëndim dhe, kuptohet, të sillnin terminologjinë e tyre. Këtu depërtoi një numër i konsiderueshëm profesionalizmash dhe termash të përbashkët të gjuhëve perëndimore. Fjala *haxhet* u zëvendësua me fjalën *nevojë*; fjala *memleqet* me *sundim* etj.
- *Iniciativa rilindase për të formuar shtetin, gjuhën dhe kombin shqiptar.* Rilindësit ishin burra që mendonin për ardhmërinë e popullit shqiptar. Meqë Perandoria Osmane ishte në tatëpjetën e saj, atëherë shqiptarëve iu duhej të mendonin për ardhmërinë e tyre brenda botës perëndimore. Kështu që, ngjallja e kësaj ndjenje në vete ngërthente, në një mënyrë, edhe urrejtjen ndaj Perandorisë, gjë që i bëri

gjuhëtarët që të mendonin edhe për heqjen e një numri të orientalizmeve që përdorshin deri atëherë.

- *Lidhja e Prizrenit (1878-1880)*. Ngjarje më e madhe kombëtare e popullit shqiptar, në të cilën për herën e parë u tubuan rilindësit e pesë kolonive shqiptare: Stamboll, Misir, Sofje, Kalabri dhe Bukuresht. Këta burra u tubuan për ta shpëtuar Shqipërinë nga famëkëqijtë, të cilët nuk pushonin së thururi kurthe kundër shqiptarëve. Ky ishte grushti i parë që iu dha Perandorisë, sepse shqiptarët tashmë ishin të një mendjeje për formimin e shtetit shqiptar. Është e ditur se kur një popull formon shtet, atëherë do të ketë edhe gjuhën e tij të pavarur, andaj dhe orientalizmat do të pësonin.
- *Krijimi i alfabetit shqip në Kongresin e Manastirit (1908)*. Iu hapi rrugën shqiptarëve që të shkruanin dhe të lexonin në gjuhën e tyre. Aty u vendos që njëherë e përgjithmonë të hiqet dorë prej alfabetit arab. Heqje që me vete mori edhe një pjesë të orientalizmeve, fillimisht emërtimet e shkronjave arabe, të cilat deri atë kohë njiheshin edhe në mesin e popullit dhe kishin domethënie të veçanta fetare, p.sh. fjala *elifbaja* ose *ebxhedije* u zëvendësua me fjalën *alfabet* etj. Përveç kësaj, ata ia ngushtuan veprimtarinë gjuhës osmane dhe ia shtuan gjuhës turke. Në disa dokumente të Kongresit thuhet: *Gjuha turke do të mësohet së pari nga viti i katërt e tutje; kërkohet nga shteti që të ngrihet një universitet në Shqipëri; gjuha shqipe dhe kombësia shqiptare duhet të njihen zyrtarisht etj.*¹¹⁷ Këto vendime ishin shumë vendimtare kur është në pyetje dukuria *orientalizëm*.
- *Copëtimi i Shqipërisë*. Me theks të veçantë, copëtimi i trojeve ku banonin gegët, sepse gegët i kishin përvetësuar më shumë orientalizmat, ku shumica e tyre ishin muslimanë. Një ndarje e këtillë bëri që shprehjet orientale, meqë ishin më të përdorshme te gegët, të mbeten si dialektizma, sepse ka një numër orientalizmesh që njihen vetëm nga shqiptarët jashtë Shqipërisë londineze.
- *Ardhja e sistemit komunist, antifetar dhe antioriental*. Prej punëve të para që bëri ky sistem ishte zhdukja e shumë të shkolluarve që ishin arsimuar jashtë shtetit, e asokohe shumica e të shkolluarve kishin mbaruar studime në Stamboll e gjetiu, të

¹¹⁷ Shaban Demiraj dhe Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit* (Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, 2008), f. 153-154.

cilët ishin një burim i fortë i depërtimit dhe qëndresës së orientalizmave në trevat e banuara me shqiptarë.

- *Kongresi i drejtshkrimit 1972 në Tiranë.* Ky kongres, fillimisht, ishte shumë i dobishëm për shqiptarët, sepse e njësoi gjuhën e tyre. Gjithashtu, në këtë kongres gegëve iu bëhen disa padrejtësi, ngase elementet e gegërishtes në gjuhën e unifikuar shqipe ishin shumë më pak se ato të toskërishtes. Pra, kjo u dha edhe një shuplakë orientalizmave, sepse ato më të theksuara ishin në gegërisht.
- Dhe, ndër shkaqet e fundit që ndikoi në largimin e orientalizmave ishte huazimi i gjuhës shqipe nga gjuhët evropiane dhe perëndimore.

Orientalizmat në gjuhën shqipe ishin si një pjesë e pandarë e trupit të shqipes, por shkaqet që u përmendën më lart bënë që ai organ të rripet dalëngadalë dhe sot të duket shumë i dobët.

11. KUSH JANË BEJTEXHINJTË?

Gjatë gjithë historisë shqiptarët shfrytëzuan alfabetë të ndryshme për ta shkruar gjuhën e tyre, deri në vitin 1908, kur shqiptarët formuan alfabetin e tyre. Ata përdorën alfabetin latin, grek, arab etj., varësisht nga fuqia dominuese e kohës. Prandaj, edhe grafia arabe pati një jetë të gjatë në gjuhën shqipe dhe u bë pjesë e pandarë e kulturës dhe letërsisë shqiptare.

Në vazhdim do të shtjellohen disa mësimë rreth bejtexhinjve: kuptimi gjuhësor dhe përkufizimi i fjalës bejtexhi; zbërthimi i termit alamiadë; shkrimet e para dhe të fundit me grafi arabe dhe shkrimtarët e saj.

11.1. Zbërthimi i fjalës *bejtexhi* dhe i simotrave të saj

Fjala *bejtexhi* në zbërthim gjuhësor është një orientalizëm, rrënja e së cilës është *bejt* (arabizëm), që në gjuhën shqipe do të thotë varg, ose siç përkufizohet në leksikografinë arabe: “fjalë që përfundon me rimë, dhe zakonisht është e përbërë prej dy pjesëve, me raste mund të jetë edhe një”.¹¹⁸ Ndërkaq, prapashtesa *-xhi* është një morfemë ndajshesore turke me të cilën tregohet profesioni dhe si e tillë është huazuar edhe në gjuhën shqipe, pra me të njëjtin funksion,¹¹⁹ si p.sh.: *furrë/furraxhi*, *kafë/kafexhi*, *zorrë/zorraxhi*, *bozë/bozaxhi*, *hekur/hekuraxhi*, *çorbë/çorbaxhi*, *samar/samarxhi*, *bejt* / *bejtexhi* etj.

Llojit të fjalëve që u përmendën ndryshe u thonë edhe fjalë hibride, sepse janë fjalë të cilat në formimin e tyre kanë morfema të dy gjuhëve. Edhe fjala *bejtexhi* është fjalë hibride, sepse përbëhet prej dy morfemave: *bejt* si morfemë rrënjore arabe dhe prapashtesës *-xhi*, si morfemë ndajshesore turke, prej të cilave kemi fituar një temë jo të parme në gjuhën shqipe.

Pra, *bejtexhi* i thuhet personit që thur vargje me rimë.

¹¹⁸ Ahmed Muhtar Omer, *Muxhem el-lugatil arabije el-muasire – Fjalor bashkëkohor i gjuhës arabe* (Kajro, Alemul-Kutubi, 2008), f. 268.

¹¹⁹ Mehdi Polisi, *Gramatika e gjuhës turke – Fonetika dhe morfologjia* (Shkup, Logos-A, 2009) f. 114.

Në terminologjinë e letërsisë shqiptare fjala bejtexhi përfshin një pjesë të mirë të letërsisë së vjetër shqiptare, përkatësisht ata që veprat e tyre letrare i shkruan me alfabet arab. Por, për këtë emërtim ka edhe një mendim tjetër, kështu që me *bejtexhi* mendoheshin njerëzit e thjeshtë që herë pas here krijonin vargje që satirizojnë gjërat e ndryshme, pra aludohej te shkarravitësit, vargëzuesit dhe këto janë fjalë ironizuese për ata që mëtojnë të mbërrijnë te zeja dhe mjeshtria poetit. Ndërkaq, B.Gjini, duke mos u pajtuar me këtë, shkruan: Ata që e kanë përfaqësuar poezinë kombëtare për dy-tre shekuj me radhë kanë qenë ata që i kemi përgojuar me emrin bejtexhinj: Hasan Zyko Kamberi, Nezim Frakulla, Sulejman Naibi etj.¹²⁰

Edhe pse thelbi i fjalës bejtexhi përmbledh veprën letrare të shkruar në vargje, ajo gjithashtu përfshin gjithë ata që është shkruar me grafi arabe, qoftë në vargje, qoftë në prozë. Të gjithë këta quhen bejtexhinj, ngase pjesa më e madhe që u shkrua me alfabet arab ishte në vargje. Pra, me të përgjithshmen u emërtua tërësia.

Në shkrimet shqipe për shkrimtarët që lëvruan me alfabet arab shpesh e hasim edhe termin *alamiadë*.

Kjo fjalë sikur duket është huazuar prej letërsisë spanjolle, sepse populli spanjoll një kohë letërsinë dhe gjuhën e vet e shkroi me alfabet arab. Pra, nocioni i përshtatshëm për ta pasqyruar letërsinë spanjolle me alfabet arab është fjala *aljamiado*.¹²¹ Përafërsisht, një situatë të tillë ishte edhe në gjuhën shqipe - shkruhej me alfabet arab, andaj disa studiues të mëvonshëm, duke parë emërtimin e letërsisë spanjolle me emrin *aljamiado*, e emërtuan edhe letërsinë shqipe me këtë emër.

Fjala *alamiadë* në gjuhën tonë mbërriti prej fjalës spanjolle *aljamiado*, e kjo nga fjala arabe *alaxhamijeh* (العجمية), që do të thotë *i huaj*. Pra, çdo gjuhë e huaj që shkruhej me alfabet arab quhej *aljamiado*. Bashkëtingëllorja *xh* në fjalën *alaxhemijeh* në gjuhën spanjolle të mëvonshme u shkrua me *j* dhe rezultoi *alajamijeh*. Pastaj, zanorja *a*, shkronja e tretë, u mënjanua, sepse kishte shumë zanore të njëjta, kështu që kaloi në *aljamijeh*. Formën fundore *do* e mori si rezultat i përshtatshmërisë fonetike në gjuhën spanjolle.

¹²⁰ Abdullah Hamiti, *Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip* (Shkup-Prishtinë-Tiranë, Logos-A, 2008), f. 17.

¹²¹ Gerard Wieggers, *Islamic Literature in Spanish & Aljamiado* (Netherlands, E.J.Brill, 1994), f. 1.

Megjithatë, edhe gjatë huazimit të saj në gjuhën shqipe pati disa ndryshime fonetike. Prej *aljamiado*, që ishte në gjuhën spanjolle, u bë *alamiada* në gjuhën shqipe.

Prej gjithë kësaj mund të thuhet se shkrimtarët shqiptarë që shkruan me alfabet arab quhen bejtexhinj dhe alamiadistë. Shprehja bejtexhinj është më e përdorur në gjuhën shqipe, kurse shprehja alamiadë është më e përgjithshme, sepse përfshin gjithë atë që u shkrua me alfabet arab, ndërsa *bejtexhinj* mbulon vetëm letërsinë e shkruar në vargje. Megjithatë, përdorimi i të dyjave ka gjetur shtrirje të mjaftueshme në librin dhe letërsinë shqiptare, andaj përdorimi i secilës prej tyre nuk është i gabueshëm, pra mund të konsiderohen sinonime.

11.2. Shkrimet e para dhe të fundit me alfabet arab

Shkrimi i shqipes me alfabet arab, individualisht, filloi qëkur shqiptarët u takuan me botën orientale, kurse gjerësisht filloi në shek. XVIII, kur lulëzoi një letërsi që u quajt e bejtexhinjve, rrjedhojë e zhvillimit ekonomik, politik dhe kulturor në atë periudhë.¹²² Rëndësi të veçantë ka luajtur edhe faktori fe, veçanërisht kur shqiptarët pranuan fenë islame. Alfabeti arab mbeti i gjallë në mesin e shqiptarëve deri në Rilindjen Kombëtare, madje deri në daljen në dritë të alfabetit të gjuhës shqipe.

Finesat e përdorimit të alfabetit arab në viset tona janë në shekullin XV. La emër me një *divan* Mesih Prishtina, ndërsa në shekullin e ardhshëm Jahja bej Dukagjini. Në divanin e tij turqisht ky mburret me origjinën e vet shqiptare: “e sojit të shqiptarit është origjina ime”. Aty-këtu shpreh ndonjë shprehje mërie kundër turkut, pushtuesit të Shqipërisë... i merr një turku të egër vajzën. Po nga ajo familje në shekullin XVI shquhet me një *divan* edhe Ahmet bej Dukagjini.¹²³ Edhe pas këtyre kishte shkrimtarë që thurnin vepra të rëndësishme, madje edhe në shekullin XVII letërsia shqipe kishte vepra të rëndësishme me alfabet arab, megjithatë shumë pak mbërritën deri te ne, sepse rëndësi të veçantë i kushtonin predikimit, praktikës, pra shumë pak i kushtonin vëmendje shkrimit të tyre.

¹²² Tomor Osmani, *Udha e shkronjave shqipe – historia e alfabetit* (Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), f. 162.

¹²³ Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale* – Separat nga seminari i kulturës shqiptare për të huaj (Prishtinë, 1976), f. 151-152.

Skaji më i largët (si poezi e plotë dhe e dokumentuar) i dëshmisë së shkrimtarit të kësaj poezie, i njohur deri më sot, është viti 1725, vit kur është shkruar poezia “Imzot, mos më lerë pa kave” nga Muçi Zade.¹²⁴ Pastaj, pas këtij vjen me radhë bejtexhiu i dalluar i cili e shkroi divanin e parë në shqip, e pas tij të tjerë.

Kjo vazhdoi deri në sajimin e alfabetit shqip, 1908 në Manastir, ku gjithashtu kishte tendenca që alfabet i shqipes të mbetet alfabeti arab. Megjithatë, edhe pas Kongresit të Manastirit kishte shqiptarë që vazhduan ta përdornin ende grafinë arabe. Grafia arabe mbeti e gjallë nëpër institucionet që sadopak kishin një lidhshmëri me botën orientale, përkatësisht me disa teqe, xhami, mejtepe etj. Megjithatë, kjo nuk duhet keqkuptuar se hoxhallarët vepronin në kundërshtim me idenë e Rilindjes Kombëtare, sepse në të gjitha ngjarjet më të mëdha të popullit shqiptar hoxhallarët kanë pasur një rol kyç, madje kanë qenë ideatorë të lëvizjeve të tilla.

Skaji më i afërt i shkrimit të gjuhës shqipe me grafi arabe është viti 1947, kur Hysni Statovci e shkruan poezinë: “Ni e permenje n’gjuhen shqipe”. Del, pra, se kjo poezi, me të madhe, është shkruar në vazhdimësi për dy shekuj të plotë,¹²⁵ kurse aty-këtu ajo ishte e pranishme më shumë se tre shekuj, sepse një pjesë e saj mbeti e pashkruar, ngase aktivitetet e tyre ishin të kufizuara me punë praktike më shumë dhe nuk kishin kohë të merren me shkrime, madje edhe ajo që u shkrua, u shkrua nëpër mjete afatshkurtra, të cilat nuk mbërritën deri në ditët tona.

Karakteristikë tjetër e saj ishte se ajo shpejt përvetësohej nga populli dhe bëhej pjesë e folklorit, saqë vinte deri në atë shkallë që nuk i dihej emri i autorit të parë.

Poezia e bejtexhinjve do të ishte më e pranishme në mesin tonë po të mos kishte para vetes sisteme armiqësore të rrezikshme për të. Vite me radhë është punuar për shuarjen dhe shkëputjen e Shqipërisë nga çdo gjë që ishte orientale.

Sot nga veprat e gjalla të bejtexhinjve, dhe që vazhdojnë të përdoren, janë tekstet e mevludeve nëpër disa vise shqiptare. Përmbajtja e tekstit është shqip, kurse grafia është arabisht, ashtu siç janë shkruar edhe shumë vepra letrare në të kaluarën.

¹²⁴ Hajdar Salihu, *Poezia e bejtexhinjve* (Prishtinë, Rilindja, 1987), f. 13.

¹²⁵ H.Salihu, po aty. f. 13-14.

11.3. Bejtexhinjtë shkruan me grafi arabe pse e deshën gjuhën shqipe

Shqiptarët me grafi arabe filluan të shkruanin si nevojë e kohës. Meqë nuk kishin një grafi të veten, atëherë ishte nevoja të sajohej ndonjë grafi e huaj, që të mund t'i shkruanin idetë dhe mendimet e tyre. Struktura e arsimuar e popullatës atë kohë grafinë arabe e dinte shumë mirë, sepse ishte shkolluar me të, edhe popullata e dinte shumë mirë atë grafi, sepse ajo ishte grafia kur'anore, e Kur'anin populli e dinte shumë mirë ta lexonte, ngase Perandoria Osmane investonte për atë, madje u hapën mejtepe, medrese etj. Pra, shqiptarët kishin një gjuhë shumë të bukur, por jo dhe alfabetin e tyre. Meqë ata dinin një alfabet tjetër, atëherë filluan që gjuhën e tyre ta shkruanin me grafinë arabe dhe kështu gjuha shqipe për vite me radhë u shkrua dhe u lexua me atë grafi.

Të parët që e përdorën këtë grafi ishin njerëzit e shkolluar nëpër shkollat osmane. Ata, fillimisht, ishin njerëz që kishin shkruar në gjuhët orientale, pastaj edhe në gjuhën shqipe. Aq sa kontribuan në botën orientale, aq kanë shkruar edhe në gjuhën shqipe, madje kishte prej atyre që edhe në gjuhën arabe, perse dhe osmane shkruan shumë për shqiptarët. Ndër ta ishte Sami Frashëri dhe të tjerë.

Këta shkrimtarë ishin atdhetarë të denjë, sepse në kohën kur të gjithë shkruanin në gjuhën osmane dhe latine, ata shkruan në gjuhën shqipe, që edhe shqipfolësit të lexonin dhe të mësonin në gjuhën e tyre të bukur.

Kur kemi parasysh kohën në të cilën kanë jetuar, vërtet është për t'u lavdëruar puna që kanë bërë, sepse në një perandori të madhe siç ishte Perandoria Osmane, ata u mundësuan vëllezërve të tyre, edhe pse me grafi arabe, të lexonin artin, poezinë, letërsinë dhe fenë në gjuhën e tyre.

Për këtë profesor Mahmud Hysa thonë: *“Krahas faktit që pushteti aktual turk nuk e pranonte dhe nuk e lejonte përdorimin e gjuhës shqipe në komunikim të përditshëm, e aq më kategorik ishte kundër përdorimit në shërbimet fetare dhe në institucionet shkollore, predikuesit islamë të Shkodrës e kanë përdorur në të gjitha fushëveprimet e tyre që nga i pari, Jusuf Efendi Tabaku, që e përdorte edhe në shërbimet fetare, në medrese; Hoxha Hasan Alia në ligjëratat e së premtes, po indikativ është mendimi i Hafiz Adem Kazazit që thotë: “Nëpërmjet gjuhës shqipe që edhe kjo është gjuhë e Zotit (xh. sh.), mbi Profetin Muhamed (a. s.), mbi Kur'anin e bekuar e mbi të gjitha, mbi rregullat e detyrimet fetare*

islame".¹²⁶ Këtu duket qartë se bejtexhinjtë kanë qenë atdhetarë dhe dashamirës të gjuhës shqipe. Ata ishin burra që u arsimuan dhe që u edukuan në Stamboll, por që, krahas trysnisë, shkruan në gjuhën shqipe.

Përveç veprave origjinale, ata përkthyen edhe një pjesë të konsiderueshme të literaturës fetare dhe letrare. Ata kanë qenë aq të zellshëm, sa që kanë bërë përkthim të veprave shumë të rëndësishme në gjuhën shqipe, të cilat ende kanë mbetur me grafi arabe dhe nuk janë përshtatur me alfabetin dhe gjuhën letrare bashkëkohore shqipe. Pra, ka vepra të përkthyera në gjuhën shqipe me grafi arabe që presin për t'u rigjallëruar dhe përshtatur në shqipen dhe alfabetin e sotëm.

¹²⁶ M.Hysa, vep. e cit., vëll.II. f. 200.

12. LETËRSIA E BEJTEXHINJVE, DJEP I ORIENTALIZMAVE

Në shtjellimet e mësipërme u sqarua se dukuria e huazimeve orientale në gjuhën shqipe është shumë e pranishme. Gjithashtu, kulmi i depërtimit të tyre në gjuhën shqipe ishte në periudhën kur shqiptarët shkruan me alfabet arab. Bashkë me grafisë arabe që huazuan, huazuan edhe shumë fjalë orientale, madje ka një numër të konsiderueshëm të fjalëve që përdoren vetëm në këtë periudhë historike.

Letërsia e bejtexhinjve konsiston me versetet e kompozuar me germa arabe. Shkrimi arab, që ishte adoptuar nga osmanët, tashmë u adoptua edhe nga shqiptarët për t'u përshtatur në sistemin fonetik të shqipes, apo më saktë të dialekteve shqipe,¹²⁷ sepse shtrirje më të gjerë kjo letërsi pati në zonat e islamizuara, por më vonë me këtë u mbulua i gjithë territori shqiptar.

Meqë thamë se shqiptarët nuk kishin alfabetin e tyre dhe iu duhej të huazonin një të tillë, në të njëjtën kohë iu duhej që alfabetin arab t'ia përshtatnin gjuhës së tyre, ngase arabishtja ka 28 shkronja, kurse shqipja 36, kështu që iu nevojiteshin edhe forma të tjera përveç atyre që kishte grafia arabe. Këtë problematikë e zgjidhën në atë mënyrë që shkronjat që nuk i kishte gjuha arabe i huazuan nga gjuha osmane, sepse edhe ata e kishin huazuar grafisë e njëjtë dhe duhej ta kishin bërë atë punë para nesh.

Poezia e bejtexhinjve u influencua fuqishëm nga turqishtja, persishtja dhe arabishtja me modelet e tyre letrare që në atë kohë ishin në modë në Stamboll dhe në Lindjen e Mesme. Shumica e formave dhe rimave persiane dhe turke zunë vend edhe në literaturën shqipe. Këtë ne e gjejmë në poezi apo nëpër divane, si: murabba, (versete), ilahitë (këngë fetare), kasidet (poezi në stil arab) dhe në gazele (poezi të shkurtra, zakonisht lirika dashurie të pëlqyeshme mes turqve dhe persianëve).¹²⁸ Këto zhanre poetike i kemi edhe në poetikën shqiptare të bejtexhinjve. Pra, ajo ishte një periudhë ku, përveç ndikimit fetar dhe administrativ, ata zhvillonin edhe kulturë dhe traditë letrare të përbashkët. Kur të

¹²⁷ Robert Elsie, *Literatura shqipe në traditën islame – Gjuha shqipe me germa arabe gjatë shekullit të 18-të dhe 19-të* (Tiranë, prill 2001), f. 5.

¹²⁸ R.Elsie, po aty. f. 5.

merren parasysh gjithë këto gjëra të përbashkëta, është e pamundur që ndikimi apo marrëdhënia mes gjuhëve të mos jetë e theksuar.

12.1. Pasqyrimi i orientalizmeve në letërsinë e bejtexhinjve

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për numrin e orientalizmeve në poezinë e bejtexhinjve, në vijim do të bëjmë një llogaritje dhe kthimin e tyre në përqindje.

Nëse do ta vështronim me vëmendje situatën e orientalizmeve në letërsinë e bejtexhinjve, do të konstatojmë se edhe vetë kjo periudhë nuk ka pasur përdorim të njëjtë të orientalizmeve. Në periudhën fillestare dhe atë përfundimtare orientalizmat kanë qenë më pak të pranishme, kurse në mesin e zhvillimit të kësaj poezie orientalizmat kanë qenë shumë më të ngjeshura. P.sh. në njërin nga poezitë më të hershme të kësaj periudhe, “Imzot, mos na lerë pa kave” të Muçi Zades, prej tërësisë së fjalëve kuptimplota me 36.98 % gjejmë orientalizma; te Nezim Frakulla orientalizmat zënë 36.7 % të glosarit të përgjithshëm; te Sulejman Naibi 20 % etj. Gjithashtu, numri i orientalizmeve është paksa i reduktuar edhe në fundin e kësaj periudhe letrare, kurse në mesin e kësaj periudhe ato kanë një ngjeshje shumë të madhe, saqë ai që nuk i njeh gjuhët orientale nuk mund t’i kuptojë.

Nga llogaritjet e bëra, rezulton se autori bejtexhi që ka përqindje më të vogël të orientalizmeve në poezitë e veta është Sulejman Naibi me 20 %, kurse shtrirje më të gjerë u ka dhënë Sheh Emini i Sadive, tek i cili orientalizmat zënë 66.6 % të leksikut të përgjithshëm të tij.

Poezia më pak e pasur me orientalizma është “Kumria këndon në kafast” e Sulejman Naibit, e cila ka vetëm 12.5 % orientalizma, kurse poezia më e pasur është “Bajramije” e Tahir Efendi Boshnjakut me 68.6 % të fjalëve orientale.

Fjalët orientale në leksikun e bejtexhinjve zënë 37.3 % të glosarit të përgjithshëm. Në këtë llogaritje janë marrë shumica e autorëve që shkruan poezi me alfabet arab. Këtu janë përfshirë një pjesë e mirë e poezive, por jo të gjitha. Megjithatë, numri i poezive të shqyrtuara është i mjaftueshëm për të kuptuar vetitë e përgjithshme të tyre.

<i>Autori</i>	<i>Poezia</i>	<i>Tërë fjalët kuptimplota</i>	<i>Orientalizmat</i>	<i>Orientalizmat me përqindje</i>	<i>Përqindja për autor</i>
Muçi Zade	“Imzot, mos na lerë pa kave”	73	27	36.9%	
Nezim Frakulla	“O Nezim, fjalë xhevahir”	69	25	36.2%	36.7%
	“Divan, kush pat folurë shqip”	50	18	36%	
	“Bejtetë derdhi inxhi”	51	19	37.2%	
Sulejman Naibi	“Mahmudeja e stolisurë”	35	12	34.2%	20%
	“Kumria këndon në kafast”	40	5	12.5%	
	“Bandilli i djegurë”	45	7	15.5%	
Hasan Zyko Kamberi	“Ty bota zili të kanë”	147	37	25.1%	30.9%
	“Paraja”	165	81	49%	
	“Trahani”	154	26	16.8%	
Dervish Hasani	“Ah, un i mjeri kesh tu fjet”	97	27	27.8%	
Anonimi Gjirokastrës	“Lufta e Gjirokastrës me A.Pashën”	309	127	41.1%	
Muhamet Kyçyku	“Nga Gurbetlitë”	51	16	31.3%	28.2%
	“Erveheja” - 35 vargjet e para	417	105	25.1%	
Mulla Beqiri	“Shka osht kishtu qi je habit”	136	32	23.5%	
Mulla Dervishi	“Medet emni na harrohet”	102	43	42.1%	
Tahir Efendi Boshnjaku	“I dekni tuk e she vorrin e vet thot”	88	17	19.3%	40.6%
	“Bajramije”	67	46	68.6%	
Muharem Mahzun Babai	“Zot’ në t’ on’ e njofmë”	72	30	41.6%	47.6%
	“Në xhihan që erdha”	75	32	42.6%	
	“Më mori delili”	86	49	56.9%	
Baba Abdullah Melçani	“Do bëhem dervish me aba”	152	70	46.0%	
Dervish Salihu	“Dymdhet vllazen na qi jemi”	88	37	42%	41.9%
	“Nurin tand kur ta pashë”	191	86	45%	
	“Mos e bon vehten gjithkush”	122	55	45%	
	“Shtatë ditë kemi n’ ket dynja”	140	49	35%	
Sheh Emini i Sadive	“Thirr me zemër”	78	52	66.6%	
Sheh Kadria	“Mos flini ju dervishë”	104	32	30.7%	

Baba Abedin Leskoviku	“Ja durballi”	80	43	53.7%	52.1%
	“Erdhi zati paq hunqar”	81	41	50.6%	
Nesibeja e Gjirokastrës	“Gjyftei Nesibe”	401	143	35.6%	
Abdulhamid Gjirokastra	“Kaside”	80	18	22.5%	
Hoxhë Dobi	“Gjyftei Hoxhë Dob (I)”	151	67	44.3%	44.1%
	“Gjyftei Hoxhë Dob (II)”	99	45	45.4%	
	“Gjyftei Hoxhë Dob (III)”	149	64	42.9%	
Sheh Jonuzi	“Per mej kajtun fushë e male”	102	36	35.2%	31.1%
	“Nur Muhamed Mustafaja”	276	82	29.7%	
	“Nuri qielles edhe i tokës”	223	66	29.5%	
	“Kush o le gjith dom me dek”	230	60	26%	
	“Kush di nefsin aj din Zotin”	198	77	38.8%	
Dalip Frashëri	“Për riza të Hakut”	66	33	50%	34.2%
	“Nga hadikaja”	74	15	20.2%	
Gjithsej:		5232	1952	37.3%	

PËRFUNDIM

Nga puna e sipërme, lirisht mund të kuptojmë se orientalizmat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në gjuhën tonë, sepse përveç fjalëve që kemi huazuar nga gjuhët orientale, ne kemi të shkruar një epokë të tërë të letërsisë sonë me alfabetin arab.

Fillimisht, kam filluar me përkufizimet e termave: arabizëm, orientalizëm, persizëm dhe turqizëm, duke bërë edhe dallimin që ato kanë mes vete, në mënyrë që të mos keqkuptohen, sepse ka shumë njerëz që nuk mund t'i dallojnë, ose, thjesht, i ngatërrojnë. Duhet kuptuar se orientalizmat nuk njihen pa u mësuar gjuhët nga ku janë huazuar ato, prandaj le t'i mësojmë më mirë.

Pastaj, i jam qasur problemit të marrëdhënieve të gjuhëve. Asnjë gjuhë nuk mund të jetojë e pavarur nga simotrat e saj, por patjetër të marrë ose të japë diçka. Fund i fundit, ky është edhe sistemi jetësor - çdo gjë të ketë nevojë për tjetrën. Kam sqaruar dukurinë e marrëdhënies së shqipes me gjuhët orientale, me arabishten, persishten dhe me turqishten. Çka ndihmoi që ato të kenë allishverishe mes vete? Si nisi kjo lidhje? Cilat ishin rrugët më të rëndësishme? etj.

Këtu kam potencuar dukurinë “globalizëm”, të mirat dhe të këqijat që u solli ajo gjuhëve. Gjithashtu, kam treguar se çka iu bëri globalizmi huazimeve orientale. Nuk është lënë pa punuar dhe këndi i raportit të gjuhës shqipe me gjuhët tjera orientale, si: hebraishtja, urdishtja, abramishtja etj.

Në vazhdim janë përpunuar fazat e depërtimit të orientalizmave në gjuhën shqipe. Cilët ishin faktorët e depërtimit të tyre, duke shpjeguar secilin një nga një. Pastaj u jam qasur fazave që ndoqën orientalizmat për të ardhur në gjuhën shqipe. Pra, faza para ardhjes së osmanlinjve, gjatë qeverisjes osmane dhe pas tyre. Për të tri fazat e depërtimit të tyre në gjuhën shqipe kam sjellë fakte shkencore dhe të vërteta historike. Në formë të detajuar janë punuar edhe faktet gjuhësore që i vërtetojnë këto tri faza, pa qenë i njëanshëm.

Gjithashtu, kam theksuar shtytësit që ndihmuan depërtimin e termave dhe shprehjeve orientale në mesin tonë: duke nisur prej faktorit tregtar, islamizimit të shqiptarëve, rënies

së Shqipërisë nën qeverisjen osmane, mosekzistimit të alfabetit shqip, shkollimit të shqiptarëve në botën islame etj.

Gjatë shtjellimit në fjalë është bërë një studim edhe për qëndrimet e gjuhëtarëve dhe shkencëtarëve shqiptarë në periudhat e ndryshme historike dhe letrare.

Është trajtuar edhe ajo që në gjuhësi njihet si purizëm gjuhësor, pra tendenca për pastrimin e tërësishëm të gjuhës shqipe nga fjalët orientale, sepse kishte, dhe ka, prej atyre që kanë qëndrime të këtilla. Pastaj është treguar dëmi që i vihet shqipes nëse pastrohet tërësisht prej huazimeve orientale.

Nuk është lënë pasdore edhe thirrja që fjalët orientale që kanë përgjegjëset e tyre në shqip të largohen dhe të merren ato të gurrës shqipe, kuptohet pa e dëmtuar shqipen dhe duke treguar se çka dëmton e çka jo (mos)ekzistenca e tyre.

Gjithashtu, jam munduar që t'i përmend shkaqet që ndihmuan në largimin e arabizmave. Siç janë: dobësimi i Perandorisë Osmane, lëvizja rilindëse, themelimi i alfabetit shqip, depërtimi i komunizmit në Shqipëri, dhënia përparësi toskërishtes në Kongresin e Drejtshkrimit, huazimet perëndimore etj.

Në pjesën e dytë të këtij punimi është lëvruar fusha më e mbjellë me farë orientale, letërsia e bejtexhinjve. Këtu janë trajtuar shkrimet e para shqipe me grafi arabe dhe autorët e tyre. Po ashtu, janë shtjelluar edhe punimet e fundit me grafi arabe në trojet shqiptare.

Pika më e rëndësishme që është hulumtuar në këtë lëmë është llogaritja e pranisë së orientalizmeve në gjuhën shqipe: Sa ato ishin në fillim të kësaj faze? Sa ishin në mes të letërsisë së bejtexhinjve? Dhe sa në fund të jetës së saj?

Saktësisht janë treguar edhe përqindjet e orientalizmeve në leksikun e autorëve bejtexhinj. Cila ishte poezia më e pasur me orientalizma dhe cila më e varfër? Cili autor ishte për to dhe cili kundër?

Puna në këtë fushë sigurisht që mund të shtjellohet edhe më gjerësisht, ndërsa kjo duhet të merret vetëm si një nismë në rrugën e gjatë të orientalizmeve.

Kjo është një lëmë që nuk duhet neglizhuar nga të tjerët, se vërtet shqipja ka pasur një sasi të madhe orientalizmesh në leksikun e vet, madje vazhdon të ketë një pjesë të madhe të tyre. Kështu që, të studiosh etimologjinë e fjalës shqipe, pa iu qasur edhe orientalizmeve, do të thotë se ke ende një pjesë të madhe të leksikut pa prekur fare.

I kisha lutur të gjithë ata që zotërojnë gjuhët orientale që të merren më seriozisht me këtë punë, se vërtet ka edhe shumë për t'u bërë në këtë drejtim, sepse vetëm kur do ta kuptojmë mirë burimin e fjalës, fjalët do t'i kemi më të matura.

Unë personalisht jam në rrjedha të kësaj pune dhe vazhdoj të merrem me këtë. Shpresoj që në të ardhmen e afërt, në një punim tjetër, t'i shtjelloj edhe fushat tjera të paprekura në këtë lëmë.

Çdokush që flet shqip përdor një orientalizëm, andaj le të mësohemi që ta kuptojmë atë që flasim!

LITERATURA

1. Ajeti, Idriz. *Studime gjuhësore në fushë të shqipes*. Prishtinë: Rilindja, 1982. Vëll.I;
2. Anamali, Skënder dhe Kristaq Prifti. *Historia e popullit shqiptar*. Tiranë: Botimet Toena, 2002;
3. Ayto, John. *Word origins*. London: A&C Black, 2005;
4. Baliu, Begzat. *Onomastika e Kosovës – ndërmjet miteve dhe identiteteve*. Prishtinë: Era, 2008;
5. Berani, Shaqir dhe Haxhi Birinxhiu. *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës sociale autonome të Kosovës, 1989;
6. Berani, Shaqir; Birinxhiu, Haxhi. *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës.
7. Bullo, Jorgo. *Magjia dhe magjistarët e fjalës*. Tiranë: Dituria, 1998;
8. Çabej, Eqrem. “Për pastërtinë e gjuhës”, në: *Gjuha shqipe III*. Prishtinë: Akademia Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1984;
9. Çabej, Eqrem. *Studime etimologjike në fushë shqipes*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1982. Vëll. I
10. Çabej, Eqrem. *Studime gjuhësore*. Prishtinë: Rilindja, 1986. vëll. I;
11. Demiraj, Shaban dhe Kristaq Prifti. *Kongresi i Manastirit*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, 2008;
12. Demiraj, Shaban. “Rreth fjalorit të orientalizmeve në gjuhën shqipe të Tahir N. Dizdari” në: *Gjuha jonë*, XXVI 1-4. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006;
13. Demiraj, Shaban. *Gjuha shqipe – probleme dhe disa figura të shquara të saj*. Tiranë: Globus R, 2003;
14. Dizdari, Tahir. “Disa vëzhgime mbi turqizmat në shqipe”, në: “*Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Tiranë*”, 15 – 21 nëntor 1962. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965;
15. Dizdari, Tahir. *Fjalor I orientalizmanve në gjuhën shqipe*. Tiranë: AIITC, 2005;

16. El-Ejubi, Jasin. *Medhahib el-edebi-Drejtimitet letrare*. Bejrut: Darul ilmi lilmelajin, 1984;
17. Elsie, Robert. *Historia e letërsisë shqiptare*. Tiranë: Dukagjini, 1997;
18. Elsie, Robert. *Literatura shqipe në traditën islame – Gjuha shqipe me germa arabe gjatë shekullit të 18-të dhe 19-të*. Tiranë: prill 2001;
19. Fetahu, Petrit. *Epika historike dibrane*. Dibër: 2004;
20. Frashëri, Naim. *Vepra*. Prishtinë: Rilindja, 1986. Vëll. II;
21. Frashëri, Sami. *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë*. Shkup: Logos-A, 2004;
22. G.Thomason, Sarah. *Language contact – an introduction*. Edinburgh: Edinburgh University Press, 1988;
23. Hamiti, Abdullah. *Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip*. Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, 2008;
24. Hamiti, Asllan. “Ndihma e profesor Eqrem Çabejt në studimin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët sllave”. në: “Eqrem Çabej, figura që shkëlqeu në studimet albanologjike” – Konferenca IV Ndërkombëtare për Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, 19-20 dhjetor. Tetovë: 2008;
25. Hoxha, Safet. *Elementet leksikore të gjuhës shqipe në gjuhët sllave ballkanike*. Tiranë: Tiranë, 2003;
26. Hysa, Enver. “Elemente turke në strukturën e fjalës në gjuhën shqipe”, në: Studime filologjike 3-4. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 1998);
27. Hysa, Mahmut. *Alamiada shqiptare*. Shkup: Logos-A, 2000. Vëll. I;
28. Hysa, Mahmut. *Alamiada shqiptare*. Shkup: Logos-A, 2000. Vëll. II;
29. Ibrahim, Mustafa. *Interpretime dhe studime gjuhësore*. Shkup: Pakung, 2003;
30. Iliadhë e Omirit, Këngë e parë, kthyerë prej Naim Frashërit, :Bukuresht, 1896;
31. Islamaj, Shefkije. “Rreth ‘Fjalorit të orientalizmeve në gjuhën shqipe’ të Tahir Dizdarit”, në: Gjuha Jonë, XXVI 1-4. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2006;
32. Jashar-Nasteva, Olivera. *Turskite leksicki elementi vo makedonskiot jazik*. Shkup: Krste Misirkov, 2001;

33. Kaleshi, Hasan. *Roli i shqiptarëve në letërsinë orientale* – Separat nga seminari i kulturës shqiptare për të huaj. Prishtinë: 1976;
34. Kalesi, Hasan. “Albanska Aljamiado Knjizevnost”, në: Prilozi za orientalni filologiju, XVI-XVII/1966-67. Sarajevo: Orijentalni Institut u Sarajevu, 1970;
35. Karic, Enes. “The Arabic Cultural Influence on the Balkans: An Outline” në: The American Journal of Islamic Social Sciences 20:1. (2003);
36. Kastrati, Jup. *Faik Konica – Monografi*. New York: Gjonlekaj Publishing Company, 1995;
37. Konica, Faik. *Vepra*. Tiranë: 2001. vëll. 3.
38. Kostallari, Androkli. “Rreth depërtimit të turqizmave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII”, në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III. Tiranë: 1989;
39. Kostallari, Androkli. *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1980;
40. Krajni, Anton. “Hyrja e turqizmave në shqipen dhe përpjekja për zëvendësimin e tyre” në: Studime Filologjike. nr.1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1965;
41. Lafe, Emil. “Fondi i persizmave në shqipen e sotme dhe në zhvillimin historik të shqipes prej mesjetës e këndej” në: Perla. XIV, 1-52. Tiranë: fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2009;
42. Lafe, Emil. “Orientalizmat si verb poetik te Sadiu shqip” në: Perla XII, 1-44. Tiranë: fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2007;
43. Lafe, Emil. “Persizmat në gjuhën shqipe - Trajtimi i tyre në veprën e Tahir N. Dizdarit “Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe”” në: Perla, XII 1-44. Tiranë: fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2007;
44. Mehdiu, Feti. “Zëvendësimi i disa fjalëve arabe me fjalë shqipe”, në: Gjuha Shqipe nr.1. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1988;
45. Mičijević, Senad. “Orientalizmi u rječnicima albanskog jezika”, në: Zbornik radova, IV. Zenici: Pedagogskog Fakulteta u Zenici, 2006;
46. Mufaku, Muhamed. *Shqiptarët në botën arabe*. Prishtinë: Rilindja, 1990;

47. Muftic, Teufik. “O arabizmima u srpskohrvatskom jeziku”, në: Prilozi za orientalnu filologiju, X-XI. Sarajevo: Orijentalni Institut u Sarajevu, 1960-61;
48. Muftic, Teufik. “Prilog semantickom izučavanju arabizma u srpsko-hrvatskom jeziku”, në: Prilozi za orientalnu filologiju, XVIII-XIX/1968-69. Sarajevo: Orijentalni Institut u Sarajevu, 1973;
49. Muhamed, Muhatir. *Globalizmi dhe realitetet e reja*. Shkup: Furkan ISM, 2010;
50. Murati, Qemal. “Probleme të historisë së gjuhës shqipe në dritën e studimeve ballkanologjike” në: *Gjurmime albanologjike*, XX-1990. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1990;
51. Murati, Qemal. *Për shqipen standarde: Përmase komunikuese dhe kombëtare*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2009;
52. Omer, Ahmed Muhtar. *Muxhem el-lugatil arabije el-muasire – Fjalor bashkëkohor i gjuhës arabe*. Kajro: Alemul-Kutubi, 2008;
53. Orel, Vladimir. *Albanian Etymological Dictionary*. Leiden: Brill, 1998;
54. Osmani, Tomor. *Udha e shkronjave shqipe – historia e alfabetit*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008.
55. Partridge, Eric. *Origins – a short etymological dictionary of modern english*. London and New York: Routledge, 2006;
56. Pasho, Hëna. “Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe” në: Studime filologjike, nr. 1-2. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1999;
57. Polisi, Mehdi. “Klasifikimi i huazimeve orientale të gjuhës shqipe sipas fushave të veprimtarisë njerëzore”, në: Filologjia 15. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Filologjisë, 2007;
58. Polisi, Mehdi. “Leksiku islam, pjesë përbërëse e leksikut të shqipes” në: Edukata islame, nr. 78. Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2005;
59. Polisi, Mehdi. “Rreth disa orientalizmeve në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, në: Gjuha Shqipe nr. 1. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1990;
60. Polisi, Mehdi. *Gramatika e gjuhës turke – Fonetika dhe morfologjia*. Shkup: Logos-A, 2009;
61. Qosja, Rexhep. *Historia e letërsisë shqipe*. Prishtinë: Rilindja, 1984. Vëll.I;

62. Qosja, Rexhep. *Nocione të reja albanologjike*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1983;
63. Salihu, Hajdar. *Poezia e bejtexhinjve*. Prishtinë: Rilindja, 1987;
64. Samara, Miço. “Fjalori i orientalizmave në gjuhën shqipe – Parathënie”. Tiranë: AIICT, 2005;
65. Samara, Miço. “Rreth huazimeve nga turqishtja në gjuhën shqipe”, në: Gjurmime albanologjike - seria e shkencave filologjike, 25-1995. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1996;
66. Sapir, Edvard. *Le langage*. Paris, 1970;
67. Sapir, Edward. *Language – an introduction to the study of speech*. New York: Brace and Company, 1921;
68. Shkurtaj, Gjovalin. *Kahë dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*. Tiranë: Kristalina-KH, 2003;
69. Shkurtaj, Gjovalin. *Onomanstikë dhe etnolingistikë*. Tiranë: SHBLU, 2001;
70. Shpuza, Jusuf. “Ndikime perse në fondin onomastik të gjuhës shqipe” në: Perla, viti XIV nr. 1-52. Tiranë: fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2009;
71. Shuteriqi, Dhimitër dhe të tjerë, *Historia e letërsisë shqipe I-II*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës - Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1971;
72. Skajliç, Abdulla. *Turcizmi u srbskohrvatskom jeziku*. Sarajevo: “Svjetlost” izdavacko preduzece, 1966;
73. Stefi, Jani. *Leksikologjia shqipe*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, 1970;
74. Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Libri Universitar, 2002;
75. Verma, Dhirenda. *Enrich your grammar: Word origins*. New Delhi: Sterling Paperbacks, 2008;
76. Weinreich, Uriel. *Languages in contact*. New York: Publications of the Linguistic Circle of New York, 1953;
77. Wieggers, Gerard. *Islamic Literature in Spanish & Aljamiado*. Netherlands: E.J.Brill, 1994;

78. Ymeri, Haki. “Elemente leksikore shqipe në fjalorin e gjuhës maqedonase I, II, III”, në: Leksikografia shqipe-trashëgimi dhe perspektivë - konferencë shkencore. Tiranë: 2005;
79. Zoto, Naim. “Persizmat në gjuhën shqipe në një fjalor të ri – intervistë me prof. Emil Lafe” në: Perla, XIV 3-54. Tiranë: fondacioni kulturor “Saadi Shirazi”, 2009;